

RAPORT VJETOR

2019

PËRMBAJTJA

Mesazhi i Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv	4
Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare	6
Bordi i Autoritetit	7
Ecuria e Tregjeve nën Mbikëqyrje, 2019	8

I. MBIKËQYRJA E INTEGRUAR E TREGJEVE FINANCIARE JOBANKARE

Kapitulli 1

Mbikëqyrja e Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve të Investimeve	13
1.1. Tregu i Fondeve të Investimeve	13
1.1.1. Struktura e Tregut	13
1.1.2. Pozicioni Financiar dhe Mbikëqyrja e Tregut	14
1.1.3. Inspektime	17
1.2. Tregu i Kapitaleve	18
1.2.1. Tregu me Pakicë i Titujve të Qeverisë	18
1.2.2 Tregu i Obligacioneve të Shoqërive Aksionare (Obligacionet e Emetuara me Ofertë Private)	20
1.2.3. Tregu i Rregulluar	20
1.2.4. Zhvillime në Përmirësimin e Infrastrukturës së Tregut	22
1.3 Aktiviteti i Licencimit	23
1.4. Qeverisja	24
1.5. Zbatueshmëria dhe Kuadri Ligjor	25
1.6. Masat Korrigjuese dhe Administrative	26

Kapitulli 2

Mbikëqyrja e Tregut të Sigurimeve	27
2.1. Struktura e Tregut	27
2.2. Pozicioni Financiar	30
2.3. Inspektime në Shoqëritë e Sigurimit	35
2.4. Mbikëqyrja e Grupeve	37
2.5. Provigjoni Teknik	38
2.6. Risigurimet	42
2.7. Qeverisja e Shoqërive të Sigurimit	44
2.8. Aktiviteti Licencues	45
2.9. Byroja Shqiptare e Sigurimit (BSHS)	49
2.10. Zbatueshmëria dhe Kuadri Ligjor	51
2.11. Masat Korrigjuese dhe Administrative	54

Kapitulli 3

Mbikëqyrja e Tregut të Pensioneve Private Vullnetare	56
3.1. Struktura e Tregut	56
3.2. Pozicioni Financiar	56
3.3. Mbikëqyrja dhe Analiza e Rreziqeve të Tregut	61
3.4. Inspektime	61
3.5. Kuadri Ligjor	62
3.6. Masat Korrigjuese dhe Administrative	62

Kapitulli 4

Mbrojtja e Konsumatorit dhe Transparenca	63
4.1. Mbrojtja e Konsumatorit dhe Investitorit	63
4.2. Edukimi Financiar	64
4.3. Transparenca dhe Marrëdhëniet me Publikun	65

Kapitulli 5

Bashkëpunimi Institucional dhe Projektet	68
5.1. Bashkëpunimi me Institucionet e Vendit	68
5.2. Bashkëpunim Rajonal dhe Ndërkombëtar	68
5.3. Proceset Integruese për Tregjet nën Mbikëqyrje	75
5.4. Projekte	76

II. Organizimi Institucional i AMF-së

II. 1 Kuadri Ligjor dhe Rregullator i AMF-së	80
II. 2. Politika e Burimeve Njerëzore	82
II. 3. Sistemet e Teknologjisë së Informacionit	85
II. 4. Auditimi i Brendshëm	87

III. Strategji dhe objektiva të Autoritetit

SHTOJCA

A. Struktura Organizative e AMF-së	91
B. Ngjarjet kryesore të vitit 2019, në renditje kohore	93

Mesazhi i Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv

Raporti Vjetor 2019 për veprimtarinë e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare hartohet në rrethana shumë të ndryshme nga ato të një viti më parë. Sfida kryesore që prej shpërthimit të pandemisë COVID-19 ishte përshtatja me realitetin e ri dhe adresimi i efekteve në tregjet nën mbikëqyrje, situatë në të cilën Autoriteti mori disa masa për të garantuar vazhdimësinë e aktivitetit, mirëfunksionimin e tregjeve dhe mbrojtjen e personave të siguruar dhe investitorëve.

Edhe viti 2019 u mbyll me dy ngjarje që vunë në provë aftësinë e tregut të sigurimeve ndaj katastrofave natyrore, tërmetet e shtatorit dhe nëntorit. Pas procedurave të vlerësimit, shoqëritë po përmbyllin procesin e pagesave të dëmeve. Bordi i Autoritetit vendosi rritjen me 34.4% të provigjoneve teknike, krahasuar me vitin 2018, që përbën rritjen më të madhe të realizuar ndonjëherë ndër vite, në funksion të shëndetshmërisë së tregut të sigurimeve. Por, këto ngjarje nxorën në pah dhe domosdoshmërinë e zgjerimit të mbulimit të sigurimit të pronës, duke qenë se afro 2.5% e banesave kanë një mbulim të tillë.

Në tërësi, gjatë vitit 2019 tregjet financiare nën mbikëqyrjen e Autoritetit vijuan rritjen. Totali i aktiveve në tregun e fondeve të investimeve, sigurimeve dhe fondeve të pensioneve private vullnetare u rrit me 6.7%, duke arritur në 108.8 miliardë lekë, ose 6.5% e PBB-së.

Tregu i sigurimeve u rrit me 4.1% gjatë vitit 2019, duke arritur nivelin 17.6 miliardë lekë prime të shkruara bruto. Tregu vazhdon të dominohet nga sigurimet e Jo-Jetës dhe sigurimi i detyrueshëm. Gjatë vitit 2019 u paguan rreth 604 milionë lekë dëmshpërblime me objekt Fondin e Kompensimit. Byroja Shqiptare e Sigurimit bën raportime mujore në AMF për të gjitha pagesat e kryera, për të shmangur vonesat e tyre.

Tregu i pensioneve private vullnetare u rrit me 27% gjatë vitit 2019. Totali i aseteve neto arriti në 2.9 miliardë lekë. Edhe numri i anëtarëve shënoi rritje. Megjithatë ky treg mbetet modest, me mundësi për t'u zgjeruar më tej.

Tregu i fondeve të investimeve u rrit me 1% në vitin 2019. Vlera neto e aseteve arriti në rreth 66.8 miliardë lekë, ose 4% të PBB-së. Tregu i kapitaleve përbëhet nga tregu i letrave me vlerë të Qeverisë dhe tregu i obligacioneve private. Ende mbeten për t'u emetuar instrumentet e tjera financiare, si obligacionet korporative apo aksionet. Listimi dhe tregtimi i këtyre instrumenteve financiare tashmë mund të realizohet nëpërmjet Bursës Shqiptare të Titujve. Zhvillimi i tregut të kapitaleve në Shqipëri mbetet një nga sfidat kryesore të Autoritetit.

Për këtë qëllim, gjatë vitit 2019 u hartuan dy ligje të rëndësishme, “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive” dhe “Për Tregjet e Kapitalit”, me asistencën teknike të ekspertëve të huaj në kuadër të projekteve me mbështetjen e Bankës Botërore. Ligjet u miratuan në maj, ndërkohë që është në proces hartimi i akteve nënligjore dhe rregulloreve përkatëse. Këto ligje forcojnë më tej kuadrin mbikëqyrës të Autoritetit, si edhe modernizojnë dhe zhvillojnë tregun e kapitaleve në Shqipëri.

Po ashtu, në bashkëpunim me një sërë institucionesh, u hartua ligji “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”, miratuar në maj 2020. Ligji rregullon kushtet për emetimin dhe tregtimin e tokenëve digjitalë dhe monedhave virtuale dhe autorizimin nga autoritetet kompetente. Ai parashikon gjithashtu kushtet për licencimin, ushtrimin e aktivitetit të operatorëve dhe bursave si edhe mbikëqyrjen e tyre.

Gjatë vitit 2019 u shtuan dhe u rinovuan platformat dhe aplikacionet *online* në ndihmë të qytetarëve. Tani konsumatorët mund të marrin tre shërbime në kohë reale: verifikimi i policës TPL në faqen web të AMF-së, akses në regjistrin e dëmeve për ndjekjen e ecurisë së trajtimit të dosjes së dëmit, si edhe hyrje në platformën *online* të ankesave. Për ndërgjegjësimin e publikut dhe mbrojtjen e investitorit, në faqen online të AMF-së u publikuan paralajmërime lidhur me rrezikun e disa produkteve financiare dhe aktivitetit të shoqërive të palicencuara në tregun e kapitaleve.

Viti 2020 pritet të jetë një vit sfidues për tregjet financiare. Autoriteti mbetet i angazhuar për zgjerimin dhe forcimin e tregjeve nën mbikëqyrje. Disa nga prioritetet në drejtimin e AMF janë kalimi në një mbikëqyrje të plotë me bazë rreziku, arritja e një përputhshmërie të lartë me standardet ndërkombëtare të sigurimeve dhe tregjeve të kapitalit, digjitalizimi si një domosdoshmëri e situatës që po kalojmë dhe aftësia e Autoritetit për të realizuar ndërhyrje të jashtëzakonshme në tregjet nën mbikëqyrje.

Ervin METE

Drejtore i Përgjithshëm Ekzekutiv

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) u krijua në bazë të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si institucion juridik publik, i pavarur në ushtrimin e kompetencave të tij, që raporton në Kuvendin e Shqipërisë.

Ai licencon, rregullon dhe mbikëqyr aktivitetin e tregut të sigurimeve dhe operatorëve të tij, aktivitetin e tregut të letrave me vlerë dhe operatorëve të tij, aktivitetin e tregut të fondeve të pensioneve vullnetare dhe operatorëve të tij, si dhe veprimtari të tjera financiare jobankare.

Misioni themelor i Autoritetit është të sigurojë funksionimin efektiv të tregjeve financiare jobankare nën mbikëqyrje, si dhe stabilitetin, promovimin dhe zhvillimin e tyre. Përmbushjen e misionit të tij, Autoriteti e ushtron me anë të funksionit rregullativ dhe mbikëqyrës. Objektivi parësor i Autoritetit, i cili udhëheq këto dy funksione është Mbrojtja e Interesave të Konsumatorit dhe Investitorit. Në ushtrimin e funksionit rregullativ dhe mbikëqyrës, AMF udhëhiqet nga parimet dhe normat e pavarësisë, transparencës dhe integritetit. Rritja e pavarësisë institucionale dhe pavarësia financiare, të parashikuara në Ligjin nr. 54, datë 29.05.2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9572, datë 3.7.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” synojnë forcimin e rolit mbikëqyrës dhe rregullator të AMF-së.

BORDI I AUTORITETIT

Në vitin 2019, Bordi i Autoritetit përbëhej nga:

Kryetar: Z. Ervin Mete¹/ Z. Pajtim Melani²
Anëtarë: Z. Ervin Koçi, Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv
 Znj. Mimoza Kaçi³, Nëndrejtor Ekzekutiv
 Z. Ildir Gjata, Anëtar Joekzekutiv
 Z. Deniz Deralla/Z. Klodion Shehu⁴/ Anëtar Joekzekutiv

Bordi i Autoritetit, gjatë vitit 2019, ka zhvilluar 16 mbledhje dhe ka marrë 258 vendime, në funksion të përmbushjes së objektivave kryesorë të Autoritetit. Nga tregjet e mbikëqyrura nga Autoriteti, numri më i madh i vendimeve, vazhdon të jetë i lidhur me tregun e sigurimeve. Vendime të rëndësishme janë marrë për shoqëritë që veprojnë në tregun e pensioneve private vullnetare dhe sipërmarrjet e investimeve kolektive edhe për arsye të licencimeve të reja në këto tregje. Vendime janë marrë edhe për marrëveshje me institucione brenda dhe jashtë vendit në funksion të forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional në funksion të një mbikëqyrje efektive.

Me synim përmirësimin dhe plotësimin e kuadrit ligjor dhe rregullator që rregullon veprimtarinë e tregjeve të mbikëqyrura, Bordi i Autoritetit ka miratuar 11 rregullore, 2 udhëzime, si dhe ka ndryshuar 17 rregullore ekzistuese.

Tabelë 1: Ndarja e vendimeve të Bordit të AMF-së sipas llojit të vendimit

<i>Llojet e vendimeve</i>	<i>Numër</i>
Vendime për shoqëritë që veprojnë në tregun e sigurimeve	132
Vendime për Bursën dhe shoqëritë që veprojnë në tregun e letrave me vlerë	27
Vendime për shoqëritë që veprojnë në tregun e pensioneve private vullnetare dhe SIK	20
Vendime për bashkëpunimin institucional	2
Vendime për masa administrative e korrigjuese ndaj subjekteve të mbikëqyrura	33
Vendime për kuadrin rregullues të AMF-së dhe tregjeve të mbikëqyrura	44
<i>Vendime në tërësi</i>	258

¹ Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në seancën plenare të datës 12.09.2019 emëroi Z. Ervin Mete në detyrën e Kryetarit të Bordit të AMF-së.

² Mandati i Z. Pajtim Melani, i emëruar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë përfundoi në datë 12 qershor 2019.

³ Mandati i Znj. Mimoza Kaçi, e emëruar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë përfundoi në datë 24 mars 2019.

⁴ Në përfundim të mandatit të Z. Klodion Shehu, në seancën plenare të datës 03.04.2019, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, emëroi Z. Deniz Deralla në detyrën e Anëtarit të Bordit të AMF-së.

ECURIA E TREGJEVE NËN MBIKËQYRJE, 2019

Gjatë vitit 2019 tregjet financiare të mbikëqyrura nga Autoriteti vijuan rritjen. Totali i aseteve në këto tregje arriti në 108.8 miliardë lekë, me një rritje prej 6.7% kundrejt vitit 2018. Totali i aseteve në raport me PBB-në rezultoi të jetë 6.5%. Tregu më i madh për t'u mbikëqyrur nga pikëpamja e aseteve mbetet tregu i fondeve të investimeve.

Tregu i Sigurimeve

Tregu i sigurimeve shënoi rritje në vitin 2019. Raporti i aseteve të tregut të sigurimeve ndaj PBB-së për vitin 2019 arriti në 2.3%, ndërsa në vitin 2018 kjo shifër ishte 1.9%. E shprehur në vlerë monetare, totali i aseteve në këtë treg, në periudhën 31.12.2019, arriti në 38.6 miliardë lekë me një rritje 22.9% (7.2 miliardë lekë) krahasuar me vitin 2018. Kjo rritje ka ardhur kryesisht nga sektori i Jo-Jetës si rezultat i rritjes së pjesës së risiguruesve në provigjonet teknike të dëmeve, për dëmet e shkaktuara nga dy tërmetet e ndodhura gjatë vitit 2019. Totali i aseteve në tregun e Jetës u rrit me 778 milionë ose 23.4% më shumë krahasuar me vitin 2018. Licencimi në shtator 2019 i një shoqërie të re në tregun e Jetës, ka ndikuar në rritjen e investimeve nga shoqëritë pjesëmarrëse në këtë treg.

Vëllimi i Primeve të Shkruara Bruto arriti në rreth 17.6 miliardë lekë, ose rreth 4.1% më shumë se në vitin 2018, ndërsa numri i kontratave të sigurimit të lidhura në total tregu në vitin 2019 arriti në 1.3 milionë, me një rritje prej rreth 3.2% krahasuar me vitin 2018.

Nevoja për zhvillimin e tregut të sigurimeve gjen reflektim edhe në strukturën e tregut të sigurimeve, e cila vijon të mbetet e orientuar tek Sigurimet e Jo-Jetës, me 92.73% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, ku Sigurimi i Detyrueshëm Motorik dominon me 68.7% të tregut të Jo-Jetës. Pësia e primeve të shkruara bruto nga aktiviteti i Jetës dhe veprimtaria e risigurimit për vitin 2019 ishin përkatësisht 6.91% dhe 0.37%. Sigurimi i Jetës, edhe pse me 3.9% rritje në vitin 2019, ka një vëllim të ulët primesh, ku pjesën më të madhe e zë portofoli “Jetë Debitori”.

Totali i dëmeve të paguara bruto, në vitin 2019, arriti në 6.38 miliardë lekë ose rreth 8.6% më pak se në vitin 2018. Raporti dëme/prime neto në sigurimin (Jetë dhe Jo-Jetë) arriti në masën 37.1%, ndërsa raporti agregat i dëmeve të tregut (Jetë, Jo-Jetë dhe Dëme Fond Kompensimi) arriti nivelin 41.4%. Sipas ecuresave të dëmeve bruto në vite rezulton se ulja e dëmeve vjen për shkak të një dëmi të paguar në portofolin e zjarrit në vitin 2018, rreth 1.1 miliardë lekë, si dhe i dëmeve të paguara për Fondin e Kompensimit, të akumuluar në vite, të paguara më së shumti në vitin 2018. Për vitin 2019 pagesat për dëmet e Fondit të Kompensimit janë në vlerën rreth 604 milionë lekë. Përveç dy inspektimeve të plota sipas metodologjisë së mbikëqyrjes me fokus rrezikun, disa inspektime tematike, apo dhe inspektimeve të përbashkëta, Autoriteti gjatë vitit 2019, ka kryer edhe disa inspektime pranë Byrosë Shqiptare të Sigurimeve (BSHS) dhe 8 shoqërive të sigurimit të Jo-Jetës, lidhur me ndjekjen e ecuresave të dëmeve, objekt i Fondit të Kompensimit. Gjatë këtij viti u kryen përmirësime në Regjistrin Elektronik të Dëmeve të Sigurimeve të Detyrueshme Motorike, si dhe u realizua integrimi në kohë reale i këtij regjistri me sistemet e dëmeve të shoqërive të sigurimit.

Gjatë vitit 2019 tregu i sigurimeve u përball me 2 ngjarje të katastrofave natyrore, tërmetet e 21 shtatorit dhe 26 nëntorit. AMF, me qëllim mbrojtjen e interesave të të siguruarve, dhe atë të shëndetit financiar të tregut të sigurimeve, ka monitoruar me kujdes ecurinë e procesit të vlerësimit dhe dëmshpërblimit të dëmeve të shkaktuara nga këto ngjarje duke qenë në komunikim të vazhdueshëm me tregun e sigurimeve. Vlerësimet paraprake tregojnë se vlera e kërkesave për dëmshpërblim deri në 31.12.2019, arriti rreth 487 milionë lekë, për ngjarjen e 21 shtatorit dhe 3.8 miliardë lekë për ngjarjen e 26 nëntorit. Tregu i sigurimeve e përballoi faturën financiare të dëmeve të ndodhura nga dy ngjarjet e tërmetit duke e ndarë edhe me shoqëritë e risigurimit. Bazuar në kontratat e risigurimit në fuqi për vitin 2019, për secilën ngjarje, vlera e dëmeve që pritet të paguhet nga tregu i sigurimeve arrin deri në 220 milionë lekë, ndërsa diferenca pritet të paguhet nga shoqëritë e risigurimit. Cilësia e risiguruesve kryesues të marrëveshjeve që mbulojnë aktualisht shoqëritë e sigurimit është A+ e lart, sipas klasifikimit të Standard & Poors, AM Best, Fitch, etj.

Ecuria në nivel tregu e provigjoneve teknike ndër vite shfaq një tendencë në rritje, duke ruajtur dhe strukturën e aktivitetit Jetë dhe Jo-Jetë. Për vitin 2019, provigjonet teknike bruto, në total për aktivitetet Jetë dhe Jo-Jetë, janë rreth 22.04 miliardë lekë. Për ngjarjet e tërmetit, duke qenë ngjarje me probabilitet të ulët, por me ndikim të lartë në rast ndodhjeje, AMF ka miratuar rritjen më të madhe të provigjoneve teknike të vitit 2019 në nivelin 34.43%, rritje e cila merr në konsideratë edhe përfshirjen e dëmeve të këtyre dy ngjarjeve. Të dy këto ngjarje evidentuan gjithashtu nevojën e një shtrirje më të gjerë të tregut të sigurimeve dhe ndërgjegjësimit më të mirë të popullsisë dhe bizneseve për sigurimin e pasurive nga fatkeqësitë natyrore. Paralelisht me masat e ndërmarra nga Autoriteti, u sigurua mbështetje me asistencë teknike nga Banka Botërore dhe ka vazhduar menjëherë puna me konsulentët dhe grupin e punës në Autoritet për hartimin teknik të ligjit për përballimin e situatave nga katastrofat natyrore sikurse është tërmeti.

Ecuria financiare e tregut të sigurimeve ka qenë pozitive, duke rezultuar në vlerën 861 milionë lekë. Për tregun e sigurimit Jo-Jetë rezultati financiar neto paraqitet në vlerën 697 milionë lekë dhe për tregun e sigurimit të Jetës në vlerën 165 milionë lekë.

Me qëllim forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse në funksion të një mbikëqyrjeje efektive të këtij tregu, sipas metodologjisë me bazë rrezikun dhe përmirësimit të zbatimit të kuadrit ligjor dhe rregullator, Autoriteti, përgjatë viteve në vijim, me asistencën teknike të Bankës Botërore do të zhvillojë projektin e ri (SECO II), të aprovuar në vitin 2019 me titull: “Përmirësimi i Kapaciteteve Mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare”, i cili do të ketë si fokus edhe tregun e sigurimeve.

Tregu i Fondeve të Investimit dhe Fondeve të Pensionit

Totali i aseteve neto nën administrim në tregun e fondeve të investimit arriti në 66.79 miliardë lekë, duke zënë një peshë ndaj PBB-së prej rreth 4%⁵. Krahasuar me vitin 2018 asetet neto të fondeve të investimit gjatë vitit 2019 u rritën me 1.06%. Numri i anëtarëve në fondet e investimeve është 29,243.

⁵ Referuar të dhënave për PBB sipas INSTAT

Gjatë vitit 2019 asetet e pesë fondeve të investimit të këtij tregu, u administruan nga tri shoqëri administruese, dy prej të cilave kryejnë veprimtarinë e administrimit si për fondet e investimit, ashtu edhe për fondet e pensionit vullnetar. Ky treg dominohet kryesisht nga investimet në obligacione qeveritare brenda dhe jashtë R.SH., të cilat përbëjnë 66.82% të aseteve të këtij tregu. Në kuadër të respektimit të kërkesave të rregullores së likuiditetit shoqëritë administruese kujdesen që fondet e investimit të cilat investojnë në tregje jo aktive të mbajnë likuiditet deri në 1 muaj minimalisht 10%.

Në vitin 2019 përfundoi procesit i hartimit të projektligjit “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”, i cili synoi përshtatshmërinë e kuadrit ligjor me direktivën UCITS apo direktiva të tjera të BE-së. Ky projektligj pritet t’i jap hov zhvillimit të mëtejshëm të këtij tregu dhe merr në konsideratë një mbikëqyrje më efektive dhe vendosjen e standardeve më të larta për një treg transparent dhe të mirëregulluar.

Asetet neto në tregun e fondeve të pensionit vullnetar u rritën me 27.14%, krahasuar me vitin 2018, ndërsa numri i anëtarëve arriti në 28,273, duke u rritur me 11.76% krahasuar me fundin e vitit 2018. Vlera neto e aseteve prej 2.9 miliardë lekë përbën vetëm 0.2% të PPB-së, gjë që tregon domosdoshmërinë e zhvillimit të këtij tregu.

Edhe gjatë vitit 2019, në tregun e pensioneve private vullnetare ushtruan aktivitetin e tyre 3 fonde pensioni vullnetar të administruar nga tre shoqëri administruese, dy prej të cilave kryejnë veprimtarinë e administrimit si për fondet e investimit ashtu edhe për fondet e pensionit vullnetar.

Investimet e tregut të pensioneve në vitin 2019 arritën në 2.7 miliardë lekë duke shënuar një rritje me 25.37% krahasuar me vitin 2018. Këto investime janë bërë kryesisht në obligacione të thesarit të Republikës së Shqipërisë me 94.84% ndaj totalit të aseteve. Megjithatë ecurinë pozitive, rritja e pjesëmarrjes në fondet private të pensionit përbën sfidë për zhvillimin e këtij tregu. Në këtë kuadër, gjatë vitit 2019 Autoriteti ndërmori disa aktivitete me synim edukimin financiar të publikut në funksion të informimit mbi tregun e pensioneve dhe tregjet e tjera nën mbikëqyrje si dhe në funksion të rritjes së besueshmërisë në këto tregje. Për tregun e pensioneve në vitin 2019, AMF organizoi Forumin Global mbi Pensionet Private, në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Pensioneve (IOPS) dhe Organizatën për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD).

Futja e shoqërive të reja si në tregun e fondeve të investimit ashtu edhe në tregun e fondeve të pensionit vullnetar ka rritur mundësinë për zgjerimin e mëtejshëm të këtyre tregjeve. Gjatë vitit 2019, Autoriteti me Vendim Bordi nr. 210, datë 22.11.2019 licençoi shoqërinë “Albsig Invest” sh.a., si shoqëri administruese e fondeve të pensionit dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe miratoi krijimin e “Fondit të Pensionit Vullnetar Albsig”, ndërsa me Vendimin e Bordit nr. 255, datë 30.12.2019 u miratua krijimi i fondit të investimit “Albsig Standard”, i administruar nga kjo shoqëri administruese.

Gjatë vitit 2019 u rrit edhe numrin i depozitarëve në tregun e fondeve. Kështu, Autoriteti me Vendim Bordi nr. 108, datë 06.06.2019 licençoi shoqërinë “Banka Credins” sh.a., për ushtrimin e veprimtarisë së depozitarit të fondeve të pensioneve vullnetare dhe fondeve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive. Gjithashtu, me Vendim Bordi nr. 121, datë 06.06.2019 u miratua zgjerimi i licencës së depozitarit të

shoqërisë “Tirana Bank” sh.a., për të vepruar si depozitar i fondeve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive.

Në funksion të digjitalizimit dhe lehtësimit të kryerjes së funksionit mbikëqyrës, në vitin 2019 u realizua krijimi i sistemit të raportimit *online* për tregun e fondeve të pensioneve dhe të investimeve.

Tregu i Kapitaleve

Tregu i kapitaleve përbëhet nga tregu i letrave me vlerë të Qeverisë dhe tregu i obligacioneve private. Ende mbeten për t’u emetuar instrumentet e tjera financiare, si obligacionet korporative, derivatët apo aksionet. Listimi dhe tregtimi i këtyre instrumenteve financiare tashmë mund të realizohet nëpërmjet Bursës Shqiptare të Titujve.

Zgjerimi i tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë është një domosdoshmëri për zhvillimin e mëtejshëm të tregut të kapitaleve, pasi ky treg përbën edhe bazën e vlerësimit të instrumenteve të tjera financiare joqeveritare që mund të tregtohen në tregun e kapitaleve.

Letrat me vlerë të Qeverisë Shqiptare ishin të vetmit tituj, të tregtuar gjatë vitit 2019 në Bursën Shqiptare të Titujve - ALSE. Që prej muajit shkurt 2019 nuk ka asnjë kufizim për tregtimin në Bursë të instrumenteve të tjera financiare nga ana e kompanive shqiptare.

Vlera totale e tregimit në Bursën Shqiptare të Titujve - ALSE, për periudhën janar-dhjetor 2019 arriti në rreth 1.47 miliardë lekë, ku kanë dominuar transaksionet e kryera midis bankave për llogari të tyre dhe për llogari të investitorëve institucionalë. Vëllimet modeste të tregimit janë shoqëruar me një numër të kufizuar prej 4 anëtarësh. Sfidë është rritja e mëtejshme e numrit të anëtarëve, si një element kryesor dhe i domosdoshëm për mirëfunksionimin e veprimtarisë së Bursës dhe zbatimin e parimit të ekzekutimit më të mirë të urdhrave të klientit, apo reflektimin sa më real të çmimit të tregut.

AMF ndjek në kohë reale transaksionet e Bursës në çdo seancë tregtimi. Baza e ulët e investitorëve si dhe ndërgjegjësimi i ulët për përparësitë e listimit apo niveli i ulët i edukimit financiar të investitorit shqiptar janë faktorë që pengojnë tregtimin e titujve nëpërmjet Bursës. Organizimi nga Autoriteti gjatë vitit 2019 i aktiviteteve dhe leksioneve të hapura në kuadër të javës globale të investitorit synoi informimin dhe edukimin financiar të publikut për tregjet e fondeve dhe tregjet e kapitalit me qëllim zhvillimin e tyre.

Autoriteti licençoi shoqërinë aksionare “Regjistri Shqiptar i Titujve ALREG” sh.a., si Regjistrar për ushtrimin e veprimtarisë së organizimit dhe administrimit të të dhënave për titujt e transferueshëm të borxhit me ofertë private dhe ofertë publike dhe titujt e transferueshëm të kapitalit që listohen/tregtohen në “Bursën Shqiptare të Titujve ALSE” sh.a. Në dhjetor 2019 Autoriteti miratoi ushtrimin e veprimtarisë së klerimit dhe shlyerjes të titujve në “Bursën Shqiptare të Titujve ALSE” sh.a. dhe përfshirjen e veprimtarisë së klerimit dhe shlyerjes së titujve në licencën e shoqërisë “Regjistri Shqiptar i Titujve ALREG” sh.a. Në këtë mënyrë kjo shoqëri ka marrë kompetencat e një depozitari qendror, krijimi i të

cilit është shumë i rëndësishëm në promovimin e interesit publik, stabilitetit financiar, zhvillimit të tregut si dhe mbrojtjen e investitorit.

Gjatë vitit 2019 u përmbyll edhe procesi i hartimit të projektligjit “Për Tregjet e Kapitalit” i cili pas konsultimit me palët e interesit iu dërgua Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave. Projektligji i miratuar në vitin 2020 nga Kuvendi, ka për qëllim përshtatjen e kuadrit ligjor me direktivat e BE-së në fushën e tregut të kapitaleve MIFID dhe synon nxitjen e zhvillimit të mëtejshëm të tregut të kapitaleve, rritjen e transparencës dhe sigurimin e integritetit të këtij tregu.

Gjatë vitit 2019, u hartua ligji “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”, i cili u miratua në maj 2020. Ligji rregullon kushtet për emetimin dhe tregtimin e tokenëve digjitalë dhe monedhave virtuale dhe autorizimin nga autoritetet kompetente. Ai parashikon gjithashtu kushtet për licencimin, ushtrimin e aktivitetit të operatorëve dhe bursave si edhe mbikëqyrjen e tyre.

Zhvillimi i tregut të kapitaleve dhe forcimi i kuadrit rregullator e mbikëqyrës i këtyre tregjeve do të jetë edhe në fokus të projektit të aprovuar në vitin 2019 me mbështetjen e Bankës Botërore dhe financiar nga Sekretariati Zviceran Për Çështjet Ekonomike (SECO), si vijim i projektit të mëparshëm: “Forcimi i Kapaciteteve Mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare: Fokusi tek Zhvillimi i Tregut të Kapitaleve”.

I. MBIKËQYRJA E INTEGRUAR E TREGJEVE FINANCIARE JOBANKARE

Kapitulli 1

MBIKËQYRJA E TREGUT TË KAPITALEVE DHE FONDEVE TË INVESTIMEVE

1.1. Tregu i Fondeve të Investimeve


Industria e fondeve të investimeve në Shqipëri nisi aktivitetin në fillim të vitit 2012. Gjatë këtyre viteve ky sektor ka kaluar përmes ndryshimeve të rëndësishme strukturore, duke përbërë kështu një hap pozitiv drejt zhvillimit të tregut të kapitaleve në Shqipëri dhe mbështetjes së tregut financiar në përgjithësi.

Në këto kushte, në fokusin e punës mbikëqyrëse gjatë vitit 2019 ka qenë forcimi i mëtijshëm i mbikëqyrjes së tregut të fondeve të investimeve nëpërmjet përmirësimit të kuadrit ligjor e rregullator si dhe administrimit të rrezeve, me të cilat përballen këto fonde si dhe nëpërmjet rritjes së transparencës së tyre.

1.1.1. Struktura e Tregut

Gjatë vitit 2019, në tregun e fondeve të investimit ushtruan aktivitetin e tyre pesë fonde investimi të administruara nga katër shoqëri administrimi. Këto fonde investimesh administrohen nga shoqëritë administruese Raiffeisen Invest sh.a., Credins Invest sh.a. dhe WVP Fund Management Tirana. Shoqëritë Raiffeisen Invest sh.a. dhe Credins Invest sh.a. kryejnë veprimtarinë e administrimit si për fondet e investimit ashtu edhe për fondet e pensionit vullnetar, ndërkohë që shoqëria WVP Fund Management Tirana kryen veprimtarinë e administrimit vetëm për fondet e investimit. Në nëntor të vitit 2019 është licencuar shoqëria administruese Albsig Invest sh.a. e cila do të kryejë veprimtarinë e administrimit si për fondet e investimit ashtu edhe për fondet e pensionit vullnetar. Fondi i investimit që administrohet nga shoqëria Albsig Invest sh.a. është licencuar në dhjetor 2019 dhe ka nisur aktivitetin në shkurt 2020.

Grafik 1: Pesha që zënë asetet neto të secilit Fond Investimi në treg 31.12.2019 (Në %)



1.1.2. Pozicioni Financiar dhe Mbikëqyrja e Tregut

Që nga fillimi i veprimtarisë së fondit të parë të investimeve në vitin 2012, tregu i fondeve të investimeve është rritur në mënyrë të konsiderueshme dhe përfaqëson tashmë një pjesë të rëndësishme të sektorit financiar në Shqipëri. Gjatë këtyre viteve, asetet neto të tregut të fondeve të investimeve arritën në 66.79 miliardë lekë. Krahasuar me vitin 2018 asetet neto të fondeve të investimit gjatë vitit 2019 pësuan një rritje me 702 milionë lekë ose 1.06%. Numri i anëtarëve në fondet e investimeve është 29,243, nga të cilët 99.94% janë investitorë individualë.

Investimet e tregut të fondeve të investimit konsistojnë në Obligacione Qeveritare brenda dhe jashtë R.Sh., Bono thesari të Qeverisë së R.Sh., Obligacione të shoqërive jashtë vendit, kuota në fonde investimi si dhe aksione në shoqëri të huaja. Ky treg dominohet kryesisht nga investimet në obligacione qeveritare brenda dhe jashtë R.Sh., të cilat përbëjnë 66.82% të aseteve të këtij tregu.

Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet vlera fillestare e kuotës për secilin fond investimi si dhe vlera e saj në fund të viteve 2018 dhe 2019.

Tabelë 2: Vlera e kuotës së fondeve të investimeve më 31.12.2018 dhe 31.12.2019 (Në monedhën origjinale)⁶

Përshkrimi	Vlera fillestare e vlerës neto të aseteve për kuotë	Vlera neto e aseteve për kuotë 31.12.2018	Vlera neto e aseteve për kuotë 31.12.2019
Raiffeisen Prestigj	1,000	1,496	1,524
Raiffeisen Invest EURO	100	115.03	119.61
Credins Premium	1,000	1,219	1,282
WVP Top Invest	1,000	898	1,083
Raiffeisen Vizion	1,000	1,018	1,057

Në tabelën e mëposhtme është pasqyruar ecuria e portofolit të tregut të fondeve të investimit gjatë tremujorëve të vitit 2019.

Tabelë 3: Portofoli i fondeve të investimeve, sipas periudhave tremujore të vitit 2019

Përshkrimi	Vlera (në mln. lekë)			
Periudha	31.03.2019	30.06.2019	30.09.2019	31.12.2019
Asetet neto të fondeve	69,477	69,192	66,684	66,788

⁶ Vlerat e fondit Raiffeisen Invest EURO janë në monedhën Euro ndërkohë që vlerat e fondeve të tjera janë në monedhën Lekë.


Totali i aseteve të фондеве	69,816	69,423	67,006	67,173
<i>nga të cilët:</i>	-	-	-	-
Obligacione Qeveritare	44,860	42,926	40,502	44,884
Obligacione të Shoqërive	2,164	1,897	2,033	2,136
Bono Thesari	11,774	13,163	10,948	9,568
Investime në kuota të фондеве të investimit	2,560	2,668	2,817	2,807
Aksione në shoqëri të huaja	93	97	99	118
Mjete Monetare	7,669	7,970	9,909	6,949
Asete të tjera	696	702	698	711
Totali i Detyrimeve të Фондеве	339	231	322	385

Në tabelën e mëposhtme është pasqyruar ndryshimi i portofolit të tregut të фондеве të investimit të vitit 2019 kundrejt vitit 2018 si dhe pesha që zë secili nga përbërësit e portofolit në totalin e aktiveve si në vitin 2018 ashtu dhe në vitin 2019.


Tabelë 4: Ndryshimi në përbërjen e portofolit të фондеве të investimeve, 31.12.2018-31.12.2019

Përshkrimi	Vlera (në mln. lekë)		Ndryshimi (në %)	Pjesa ndaj totalit (në %)	
Periudha	31.12.'18	31.12.'19	31.12.'18 - 31.12.'19	31.12.'18	31.12.'19
Asetet neto të fondit	66,087	66,788	1.06	97.01	99.43
Totali i aseteve të фондеве	68,124	67,173	(1.40)	100	100
<i>nga të cilët:</i>	-	-	-		
Obligacione Qeveritare (të R.SH. dhe të huaja)	41,725	44,884	7.57	61.25	66.82
Obligacione të Shoqërive	2,060	2,136	3.69	3.02	3.18
Bono Thesari	11,912	9,568	(19.68)	17.49	14.24
Investime në kuota të фондеве të investimit	2,686	2,807	4.50	3.94	4.18
Aksione në shoqëri të huaja	78	118	51.28	0.11	0.18
Mjete Monetare	8,937	6,949	(22.24)	13.12	10.34
Asete të tjera	726	711	(2.07)	1.07	1.06
Totali i Detyrimeve të Фондеве	2037	385	(81.10)	2.99	0.57

Grafik 2: Struktura e aseteve të fondeve të investimeve 31.12.2019 (në %)




Grafik 3: Struktura e aseteve të fondeve të investimeve 31.12.2018 (në %)



Në kuadër të respektimit të kërkesave të rregullores së likuiditetit shoqëritë administruese kujdesen që fondet e investimit të cilat investojnë në tregje jo aktive të mbajnë likuiditet deri në 1 muaj minimalisht 10%. Si shihet në grafikun e mësipërm investimet e tregut të fondeve të investimit me maturim deri në një muaj janë 17.28%.

Grafik 4: Profili i Investimit të tregut të fondeve të investimit 31.12.2019 (në %)



1.1.3. Inspektime

Gjatë vitit 2019, Autoriteti ka pasur në fokus vlerësimin e elementëve të veçantë të transparencës me klientët e fondeve të investimeve në kuadrin e informimit të mjaftueshëm të investitorëve në lidhje me kontratën dhe marrëdhënien juridike në të cilën ata po investojnë. Në këtë kuadër AMF ka kryer inspektim pranë të gjitha shoqërive administruese të cilat administrojnë fonde investimi. Inspektimet tematike pranë këtyre shoqërive kanë konsistuar në kryerjen e intervistave me punonjës të shoqërive si dhe agjentët e autorizuar prej tyre për shitjen e kuotave të fondeve të investimit. Gjithashtu këto inspektime janë fokusuar dhe në shqyrtimin e procedurave të ngritura nga shoqëritë administruese në mënyrë që të sigurohet që çdo punonjës i shoqërisë apo agjentët e tyre të respektojnë bazën ligjore në fuqi në mënyrë që investitorëve potencialë të fondeve të investimit t'i jepet i gjithë informacioni i nevojshëm përpara investimit të tyre.

Në përfundim të këtyre inspektimeve AMF nëpërmjet raporteve të inspektimit i ka komunikuar gjetjet shoqërive administruese si dhe rekomandimet përkatëse dhe është në ndjekje të plotësimit të tyre nga ana e shoqërive administruese.

1.2 Tregu i Kapitaleve

Edhe gjatë vitit 2019 tregu i kapitaleve në vend konsistoi në dy segmente kryesore: atë të titujve të Qeverisë Shqiptare dhe tregun e Obligacioneve të Emetuara me Ofertë Private. Tregu i titujve të tjerë, si ai i obligacioneve të shoqërive aksionare, apo tregu i aksioneve vazhduan të mbeten joekzistent dhe pse listimi dhe tregtimi i këtyre titujve tashmë mund të realizohet nëpërmjet Bursës Shqiptare të Titujve.

Parë në këndvështrimin e madhësisë së tregut, aksesit në treg, likuiditetit apo elasticitetit rezulton që tregu i kapitaleve në Shqipëri është ende modest në zhvillimin e tij, por me potencial të lartë për të luajtur një rol të rëndësishëm në rritjen ekonomike të vendit.

Në fund të vitit 2019, në tregun e titujve rezultojnë subjektet si më poshtë:



- 14 shoqëri komisionere, nga të cilat: 9 banka, 2 shoqëri këshillimi në titujt (njëra prej të cilave e licencuar edhe për veprimtari brokerimi), 2 shoqëri me aktivitet brokerimi dhe Posta Shqiptare;
- 3 agjentë të shoqërive të brokerimit në tituj (një prej të cilave mbylli kontratën me shoqërinë e brokerimit në dhjetor);
- 20 të punësuar në rolin e brokerave;
- 3 këshilltarë individë të punësuar;
- 9 banka kujdestare titujsh të qeverisë (3 prej të cilave kujdestare për obligacionet e shoqërive).

1.2.1. Tregu me Pakicë i Titujve të Qeverisë

Segmenti më i madh dhe aktiv që mbizotëron në tregun e kapitaleve, mbetet ende tregu i titujve të Qeverisë Shqiptare. Titujt shtetërorë emetohen në monedhë kombëtare dhe të huaj në formën e Bonove të Thesarit me maturim 3, 6 dhe 12 mujore si dhe obligacione me maturitet 2, 3, 5, 7 dhe 10 vjeçar.

Autoriteti, gjatë vitit 2019, ka monitoruar rregullisht veprimtarinë e subjekteve të licencuara në tregun me pakicë të titujve të Qeverisë, ku përfshihen tregtimet ndërmjet shoqërive komisionere të licencuara për të kryer transaksione në tregun me pakicë të titujve të Qeverisë (kryesisht Banka) dhe investitorëve individualë apo investitorëve - persona juridikë.

Të dhënat statistikore të Autoritetit për tregun me pakicë të titujve të Qeverisë për vitin 2019 tregojnë se ka vijuar të dominojë transaksioni “Blerje në tregun primar” me 42.69% kundrejt vëllimit të përgjithshëm të transaksioneve. Përsa i përket aktivitetit në tregun sekondar ai mbetet ende i ulët. Vëllimi i tregut sekondar të titujve të Qeverisë për vitin 2019 u dominua në masën 53.92% në tituj afatshkurtër (bono thesari) dhe 46.08% nga transaksionet në instrumente afatgjatë (obligacione). Transaksioni i llojit “Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar” në vitin 2019 është rritur me 8.85% krahasuar me vitin 2018, ndërsa transaksioni i llojit “Blerje para afatit të maturimit” për vitin 2019 ka rezultuar me një ulje prej 22.52% krahasuar me një vit më parë. Në vitin 2019 transaksionet “Blerje para afatit të maturimit” dhe “Shitje nga Portofoli” kanë zënë 15.97% të totalit të transaksioneve përkundrejt vlerës 18.06% që zinin ato një vit më parë.

Grafik 5: Transaksione në Tregun me Pakicë të Titujve të Qeverisë (Në %)**Grafik 6: Vlera e Tregtimit në tregun Sekondar sipas llojit të Titujve (2019) (Në %)**

Pjesëmarrja në tregun sekondar të titujve të Qeverisë, për vitin 2019 vijoi të dominohet nga investorët individualë, të cilët për këtë periudhë kryen 98.2% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.

Që prej gjysmës së dytë të vitit 2018 në tregun primar janë emetuar 3 obligacione reference (2 obligacione me maturim 5-vjeçar dhe 1 obligacion me maturim 3-vjeçar) që tregtohen nëpërmjet sistemit të Zhvilluesve të Tregut.

Zgjerimi i tregut të titujve të Qeverisë është një domosdoshmëri për zhvillimin e mëtejshëm të tregut të kapitaleve, pasi ky treg përbën edhe bazën e vlerësimit të titujve dhe instrumenteve të tjera financiare joqeveritare që mund të tregtohen në tregun e kapitaleve në vend.

Me qëllim ruajtjen e integritetit të tregut dhe mbrojtjen e interesave të investitorit, Autoriteti, pas monitorimit të subjekteve të licencuara, ka vijuar gjatë 2019 me monitorimin *off-site* të shoqërive të brokerimit, si dhe ka ndjekur raportimet financiare dhe statistikore të këtyre subjekteve.

1.2.2. Tregu i Obligacioneve të Shoqërive Aksionare (Obligacionet e Emetuara me Ofertë Private)

Deri tani në tregun shqiptar të kapitaleve emetimi i obligacioneve ka qenë me ofertë private. Edhe gjatë vitit 2019 ka vijuar emetimi i obligacioneve të shoqërive aksionare nëpërmjet ofertave private, me një bazë investitorësh të përbërë nga investitorë institucionalë dhe individë (deri në 100 individë). Në vitin 2019, Autoriteti ka miratuar 5 prospekte lidhur me emetimet e obligacioneve me ofertë private për 4 emetues (2 banka dhe dy institucione mikrokredie).


Shuma e pashlyer e obligacioneve të emetuara nëpërmjet ofertave private në fund të vitit 2019 është afërsisht 7.45 miliardë lekë, nga të cilat 38% janë në Euro dhe 8.8% në USD. Me gjithë zhvillimet e këtij tregu, kjo shumë është ende e papërfillshme në raport me Prodhimin e Brendshëm Bruto (PBB), me një vlerë prej vetëm 0.3% të PBB. Për shkak të natyrës që kanë këto tituj, ata nuk krijojnë likuiditet në treg.

1.2.3. Tregu i Rregulluar

Bursa Shqiptare e Titujve -ALSE

Edhe gjatë vitit 2019 Bursa Shqiptare e Titujve - ALSE vijoi me tregtimin e titujve të Qeverisë Shqiptare, edhe pse që prej muajit shkurt 2019 nuk ka asnjë kufizim për tregtimin e titujve të tjerë nga ana e shoqërive shqiptare.

Vlera totale e tregtimit në Bursën Shqiptare të Titujve, ALSE për periudhën janar-dhjetor 2019 arriti në rreth 1.47 miliardë lekë, ku kanë dominuar transaksionet e kryera midis bankave për llogari të tyre dhe për llogari të investitorëve institucionalë. Vëllimet modeste të tregtimit janë shoqëruar me një numër të kufizuar prej 4 anëtarësh. Në këtë drejtim sfidë është rritja e mëtejshme e numrit të anëtarëve, si një element kryesor dhe i domosdoshëm për mirëfunksionimin e veprimtarisë së Bursës dhe zbatimin e parimit të ekzekutimit më të mirë të urdhrave të klientit, apo reflektimin sa më real të çmimit të tregut.

Grafik 7: Vëllimi i Tregtimit në Bursë (Në milionë lekë)

AMF, në statusin e vëzhguesit të sistemit të tregtimit, ka ndjekur në kohë reale transaksionet e Bursës në çdo seancë tregtimi. Në një analizë të përgjithshme të karakteristikave të zhvillimit të tregtimit, në Bursën Shqiptare të Titujve (*on-exchange*) për periudhën janar–dhjetor 2019, kanë dominuar:

- Transaksionet midis bankave për llogari të investitorëve institucionalë;
- Transaksionet në obligacione thesari;
- Transaksionet në valutën lekë.

Vlera e tregtuar e obligacioneve të thesarit është 78.51% përkundrejt vlerës 21.49% të bonove të thesarit.

Në tabelën më poshtë jepet informacioni mbi transaksionet e kryera në Bursë midis Bankave dhe ato të kryera për llogari të klientëve, ku vihet re se dominojnë transaksionet e kryera nga bankat për llogari të portofolit të klientëve, në veçanti personave juridikë.

Tabela 5: Raporti i transaksioneve të kryera në Bursë midis Bankave për llogari të portofolit të vet ndaj transaksioneve të kryera për llogari të klientëve, 2019 (në % ndaj totalit)

Lloji i Transaksionit	Nr. i Transaksioneve	Vlera e Tregtimit
Ndërbankare	29.55	21.63
për Klientët	70.45	78.37
<i>Individë</i>	27.27	0.42
<i>Pers. Juridik</i>	43.18	77.95

Në gjendjen e tanishme me një numër të kufizuar anëtarësh dhe vëllim të ulët tregtimi Bursa Shqiptare e Titujve ende nuk luan rolin e saj thelbësor në financimin e shoqërive shqiptare, ku këto shoqëri janë ende të varura kryesisht nga financimi nëpërmjet fitimeve të mbajtura apo nëpërmjet huave bankare. Baza e ulët e investitorëve si dhe ndërgjegjësimi i ulët për përfitimet e listimit apo niveli i ulët i edukimit financiar të investitorit shqiptar janë ndër faktorët kryesorë që pengojnë zhvillimin e tregtimit nëpërmjet Bursës.

1.2.4. Zhvillime në përmirësimin e Infrastrukturës së Tregut

Klerimi dhe Shlyerja e Titujve të Qeverisë Shqiptare realizohet nëpërmjet sistemit të shlyerjes dhe regjistrimit të titujve - AFISAR, që administrohet nga Banka e Shqipërisë. Ndërkohë Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare licençoi në janar 2019 shoqërinë “Regjistri Shqiptar i Titujve - ALREG” për të vepruar si regjistar i obligacioneve dhe aksioneve që do të tregtohen në bursë. Në nëntor 2019 ALREG njoftoi Autoritetin për regjistrimin e parë me sukses të emetimit të Obligacioneve me ofertë private të një shoqërie për monedhat ALL, EUR dhe USD. Njëkohësisht, shoqëria ALREG do të kryejë edhe funksionet e klerimit dhe shlyerjes (transferimi i titullit kundrejt pagesës) për tituj jostetërorë që do të tregtohen në Bursë. Në nëntor 2019 ALREG u licencua nga Banka e Shqipërisë për të kryer funksionin e klerimit dhe shlyerjes dhe në dhjetor 2019 mori edhe aprovimin nga AMF lidhur me këtë funksion, duke marrë kështu kompetencat e një depozitari qendror. Krijimi i një Depozitari Qendror për Titujt është shumë i rëndësishëm në promovimin e interesit publik, stabilitetit financiar, zhvillimit të tregut si dhe për mbrojtjen e investitorit.

Inspektimi i Shoqërive të Mbikëqyrura

Autoriteti zhvilloi inspektimin në vend pranë një shoqërie komisionere me objekt kryesor veprimtarinë e brokerimit të shoqërisë pas anëtarësimit të saj në Bursën Shqiptare të Titujve – ALSE. Inspektimi u fokusua tek: transaksionet e kryera në emër dhe për llogari të klientëve nga momenti i anëtarësimit në Bursë; Çështje të qeverisjes së shoqërisë; Rregullat dhe procedurat e brendshme për njohjen e klientit; Rregullat dhe procedurat e brendshme për komunikimin, marrjen dhe transmetimin e urdhrat të klientit si dhe tarifat, komisionet e shërbimit të brokerimit, transparenca me klientët. Në fund të procesit të inspektimit, gjetjet dhe rekomandimet e propozuara nga Autoriteti iu komunikuan shoqërisë dhe zbatueshmëria e tyre po ndiqet nga Autoriteti në përputhje me afatet kohore të lëna në raportin e inspektimit. Shoqëria mori masa të menjëhershme për zbatimin e rekomandimeve dhe zbatimi i tyre po monitorohet në vijim nga AMF.

Në muajin nëntor 2019 Autoriteti realizoi gjithashtu një inspektim në vend pranë një shoqërie (bankë) me objekt kryesor veprimtarinë e shërbimit të kujdestarisë për titujt e Qeverisë dhe obligacionet e shoqërive aksionare për periudhën janar 2018 deri 31 tetor 2019 si dhe respektimin e rregullave në lidhje me parandalimin e pastrimit të parave dhe luftën kundër terrorizmit. Inspektimi u fokusua tek: Struktura organizative e njësisë së kujdestarisë; Procedurat/manualët në lidhje me shërbimin e kujdestarisë; Procedura të menaxhimit të rrezikut për shërbimin e kujdestarisë; Procedura të njohjes së klientit dhe të parandalimit të pastrimit të parave e luftës kundër terrorizmit; Sistemi që përdoret për shërbimin e kujdestarisë; Tarifat/komisionet e shërbimit të kujdestarisë (transparenca me klientët, ankesa në lidhje me tarifat/komisionet); Auditimi i veprimtarisë së kujdestarisë; Marrëveshje me nënkujdestarë, Plan i Rimëkëmbjes dhe Vazhdimësisë së Biznesit për veprimtarinë e kujdestarisë. Në fund të procesit të inspektimit, gjetjet dhe rekomandimet e propozuara nga Autoriteti iu komunikuan shoqërisë dhe zbatueshmëria e tyre po ndiqet nga Autoriteti në përputhje me afatet kohore të lëna në raportin e inspektimit.

1.3. Aktiviteti i Licencimit

Gjatë vitit 2019, AMF licenoi:

- Shoqëri administruese të fondeve të pensionit dhe të investimeve kolektive;
- Regjistrar të titujve;
- Shoqëri të brokerimit në tituj/ brokerit fizik.

Në veprimtarinë e licencimit Autoriteti ka mbajtur parasysh kërkesat ligjore dhe procedurat për licencimin e subjekteve të mësipërme dhe i ka përmirësuar ato sidomos në drejtim të kërkesave lidhur me burimin e kapitalit dhe aksionarët e shoqërive për të qenë të duhur dhe të përshtatshëm, kryesisht nëpërmjet hartimit të Rregullores nr.124, datë 21.6.2019 “Për disa kërkesa shtesë për aksionarët themelues, aksionarët ndikues si dhe anëtarin ekzekutiv të këshillit të administrimit të shoqërisë administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive”.

Tregu i Fondeve

Gjatë vitit 2019, Autoriteti me Vendim Bordi nr. 210, datë 22.11.2019 licenoi shoqërinë “Albsig Invest” sh.a., si shoqëri administruese e fondeve të pensionit dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe miratoi krijimin e “Fondit të Pensionit Vullnetar Albsig”. Me Vendimin e Bordit nr. 255, datë 30.12.2019 u miratua krijimi i fondit të investimit “Albsig Standard” i administruar nga shoqëria “Albsig Invest”.

Tregu i titujve

Gjatë vitit 2019, Autoriteti me Vendim Bordi nr. 6, datë 31.1.2019 licenoi shoqërinë aksionare “Regjistri Shqiptar i Titujve ALREG” sh.a., si Regjistrar për ushtrimin e veprimtarisë së organizimit dhe administrimit të të dhënave për titujt e transferueshëm të borxhit me ofertë private dhe ofertë publike dhe titujt e transferueshëm të kapitalit që listohen/tregtohen në “Bursën Shqiptare të Titujve ALSE” sh.a. Gjatë vitit 2019 u licencua 1 broker fizik për shoqëritë komisionere.


Tabelë 6: Subjekte të tjera që veprojnë në tregun e titujve 2015-2019 (Në numër)

<i>Subjekte</i>	<i>2015</i>	<i>2016</i>	<i>2017</i>	<i>2018</i>	<i>2019</i>
Bursa Shqiptare e Titujve	0	0	1	1	1
Shoqëri komisionere	14	15	17	17	14
Broker fizik në shoqëri komisionere	19	21	26	29	30
Kujdestarë të titujve të Qeverisë së R.Sh.	8	8	9	9	9
Regjistruar aksionesh	1	1	1	1	2
Shoqëri këshillimi për investime në tituj	1	2	2	2	2
Këshilltar për investime në tituj	1	3	3	3	3
Agjent i lidhur	2	2	4	3	5

1.4. Qeverisja

Në mbështetje të kërkesave ligjore dhe nënligjore, struktura e organizimit dhe drejtimit të shoqërive administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe fondeve të pensionit vullnetar, paraqitet në skemën më poshtë:

Grafik 8: Strukturës aktuale e drejtimit të shoqërive të administrimit të fondeve të pensioneve dhe investimeve



Tabelë 7: Të dhëna për aksionarët e shoqërive administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe fondeve të pensionit vullnetar

<i>Subjekte</i>	<i>Numër</i>
Shoqëri administruese	5
Aksionarë gjithsej	16
<i>Klasifikimi i aksionerëve sipas pjesëmarrjes zotëruese</i>	
nën 10%	7
mbi 10% nën 33 %	3
mbi 33% nën 50%	1
mbi 50%	5

Tabelë 8: Klasifikimi i aksionarëve sipas vendit të origjinës

<i>Subjekte</i>	<i>Numër</i>
Aksionarë gjithsej	16
<i>nga të cilët</i>	
Aksionarë të huaj	8
Aksionarë vendas	8

Tabelë 9: Klasifikimi i aksionarëve sipas statusit

<i>Subjekte</i>	<i>Numër</i>
Aksionarë gjithsej	16
<i>nga të cilët</i>	
Aksionarë individ	9
Aksionarë shoqëri	7

Tabelë 10: Të dhëna mbi miratimin e ndryshimeve statutore*(Në numër)*

<i>Arsyeja e Ndryshimit të Statutit</i>	<i>2015</i>	<i>2016</i>	<i>2017</i>	<i>2018</i>	<i>2019</i>
Statut i ri/ndryshime të tjera	2	2	-	-	5
Rritje kapitali	-	-	1	2	1
Ndryshim i strukturës aksionere	-	-	1	-	2

1.5. Zbatueshmëria dhe Kuadri Ligjor e Rregullativ

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare gjatë vitit 2019 ka reflektuar komentet e Ministrisë së Drejtësisë dhe Bankës së Shqipërisë në dy projektligjet që lidhen me tregjet e kapitalit dhe sipërmarrjet e investimeve kolektive.

Sa i takon kuadrit rregullator për vitin 2019 dolën akte të reja si edhe u amenduan aktet ekzistuese, si më poshtë:

Rregullore nr. 71, datë 27.3.2019 “Për veprimtarinë e agentit të shoqërisë së brokerimit në tituj”. Kjo rregullore përcaktoi rregullat në lidhje me njohjen dhe monitorimin e veprimtarisë së agentit të shoqërisë së brokerimit në tituj, i cili vepron në emër dhe për llogari vetëm të një brokeri të licencuar për titujt në territorin e Republikës së Shqipërisë, apo shoqëri e licencuar nga Autoritetet rregullatore dhe mbikëqyrëse, anëtare të BE-së, në përputhje me kufizimet e licencës përkatëse. Vendimi nr. 55, datë 30.3.2011 “Për njohjen e veprimtarisë së agentit të brokerit të licencuar të letrave me vlerë”, i ndryshuar u shfuqizua me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje.

Rregullorja nr. 35, datë 27.3.2019 “Për organizimin dhe funksionimin e testimit të njohurive të kandidatëve që aplikojnë për licencë/rinovim licence në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”. Kjo rregullore përcakton mënyrën dhe procedurën për kryerjen e testimit të njohurive për licencim nga kandidatët që kanë plotësuar kriteret dhe aplikojnë në Autoritet për t’u pajisur me licencë për broker në tituj, këshilltar investimesh etj. Rregullorja e re përmbledh në një akt të vetëm rregullativ të gjitha rregullat për organizimin dhe funksionimin e testimit të njohurive të kandidatëve që aplikojnë për licencim në AMF, duke shfuqizuar kapitujt e testimit në rregulloret respektive, ekzistuese të licencimit.

Me vendimin nr. 120, datë 6.6.2019 Bordi i Autoritetit miratoi tarifat, komisionet dhe penalitetet e “Regjistrimit Shqiptar të Titujve (ALREG)”, vendimmarrje kjo e bazuar në nenin 130 të Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për titujt”.

Rregullore nr. 124, datë 21.6.2019 “Për disa kërkesa shtesë për aksionarët themelues, aksionarët ndikues si dhe anëtarin ekzekutiv të këshillit të administrimit të shoqërisë administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive”. Kjo rregullore ka si objekt përcaktimin e dokumenteve shtesë për aksionarët themelues të shoqërisë administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive si dhe dokumentacionin shtesë në lidhje me ndryshimin e kontrollit si dhe miratimin/ndryshimin e anëtarit ekzekutiv të këshillit të administrimit (administratorin/administratorët) e shoqërisë.

Me vendimin e Bordi nr. 34, datë 27.3.2019 u miratuan ndryshime në Manualin e Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave nr. 136, datë 29.09.2016, midis ndryshimeve të tjera evidentohet se shtohen subjektet që mbikëqyren nga Autoriteti me qëllim parandalimin e pastrimit të parave dhe/ose financimit të terrorizmit. Këto subjekte janë Bursat, agjentët, brokerat, shoqëritë e brokerimit, etj. që ushtrojnë veprimtari për emetimin, këshillimin, ndërmjetësimin, financimin dhe çdo shërbim tjetër që ka lidhje me tregtimin e titujve, etj.

Me vendimin nr. 80, datë 24.4.2019 Bordi miratoi ndryshime në rregulloren nr. 120, datë 02.10.2010 “Për licencimin dhe mbikëqyrjen e bursës së titujve”, e ndryshuar, duke përcaktuar detyrimin që Bursa të depozitojnë në Autoritet çdo akt që ka lidhje me rregullat e përcaktuara në dispozitën përkatëse si dhe çdo ndryshim të këtyre akteve, brenda 15 ditëve nga miratimi i tyre, nga organi kompetent i Bursës.

Me Vendimin nr. 248, datë 19.12.2019 Bordi miratoi ndryshime në Rregulloren nr. 71, datë 27.3.2019 “Për veprimtarinë e agjentit të shoqërisë së brokerimit në tituj” , u saktësua se Autoriteti shqyrton kërkesën për njohjen e veprimtarisë së agjentit në titujt pas regjistrimit të shoqërisë në QKB si edhe u shtua një dispozitë e re që parashikon njohjen/regjistrimin e kushtëzuar të veprimtarisë së agjentit në titujt sipas të cilës Autoriteti kërkon plotësimin e dokumentacionit, brenda një afati të përcaktuar, dokumentacioni i cili parashikohet në këtë rregullore.

1.6. Masat Korrigjuese dhe Administrative

Autoriteti, referuar evidentimit të çështjeve të dala nga inspektimet, ka ndjekur në vazhdimësi rekomandimet e lëna duke kërkuar informacion mbi zbatimin e këtyre rekomandimeve nga ana e shoqërive administruese të fondeve të pensioneve private vullnetare dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive.

Gjatë vitit 2019, Autoriteti ka marrë një vendim për heqjen e licencës ndaj shoqërisë së brokerimit të letrave me vlerë të qeverisë në bursë dhe në tregun me pakicë.

Kapitulli 2

MBIKËQYRJA E TREGUT TË SIGURIMEVE


2.1 Struktura e Tregut të Sigurimeve

Në vitin 2019 në total tregu, vëllimi i primeve të shkruara bruto nga shoqëritë e sigurimit rezultoi rreth 17.6 miliardë lekë, me një rritje prej 689 milionë lekë ose 4.1% më shumë se një vit më parë. Në këtë vëllim primesh 16.4 miliardë lekë ose 93.1% e totalit të primeve i përket tregut të Jo-Jetës dhe 1.2 miliardë lekë ose 6.9% tregut të Jetës.


Vëllimi i primeve të shkruara bruto në veprimtarinë e Jo-Jetës shënoi rritje prej rreth 3.9% dhe vëllimi i primeve të shkruara bruto në veprimtarinë e Jetës shënoi rritje prej rreth 6.3% krahasuar me vitin 2018. Tregu i sigurimeve vazhdon të ruajë të njëjtin konfigurim në vite, ku sigurimet e Jetës kanë një vëllim primesh të ulët krahasuar me ato të Jo-Jetës.

Numri i kontratave të sigurimit të lidhura në total tregu në vitin 2019, arriti në 1,350,075 me një rritje prej rreth 3.2% krahasuar me vitin 2018.


Grafik 9: Ecuria në vite e primit të shkruar bruto, sipas llojit të sigurimit Jo-Jetë dhe Jetë (Në mln. lekë)



Grafik 10: Ndarja e primit të shkruar bruto sipas llojit të sigurimit, viti 2019, (Në %)



Grafik 11: Ndarja e primit të shkruar bruto sipas linjës biznesit të Jo-Jetës, viti 2019 (Në %)



Klasa 1 dhe 2 - Aksidente dhe sëmundje
 Klasa 10 - Përgjegjësi ndaj palëve të treta
 Klasa 3 - Motorike, klasat e tjera
 Klasa 4, 5, 6, 7 - Marinë, avion dhe transport


Klasa 8 dhe 9 - Zjarri dhe dëmtime të tjera në pronë
 Klasa 11, 12 dhe 13 - Përgjegjësi civile
 Klasa 14 dhe 15 - Krediti dhe garancia

Sigurimi i detyrueshëm motorik zë 68.7% të tregut të Jo-Jetës me një vëllim primesh rreth 11.2 miliardë lekë dhe me një rritje prej 4.6% krahasuar me vitin 2018. Sipas grafikut të mësipërm vendin e dytë në ndarjen e tregut e zë portofoli “Zjarri e dëmtime në pronë” me një vëllim primesh rreth 1.93 miliardë milionë lekë. Primet e shkruara bruto në sigurimin e aksidenteve dhe shëndetit në vitin 2019 arritën në 1.18 miliardë lekë ose 0.6% më pak se një vit më parë.

Në vëllimin e primeve të shkruara bruto të sigurimit të Jetës pjesën më të madhe e zë sigurimi “Jetë Debitori” me 770 milionë lekë ose 14% më shumë se një vit më parë.


Totali i dëmeve të paguara bruto në vitin 2019 në tregun e sigurimeve arriti në 6.38 miliardë lekë.

Grafik 12: Ecuria në vite e dëme të paguara bruto, sipas llojit të sigurimit Jo-Jetë, Jetë, Fond Kompensimi
(Në mln. lekë)



Dëmet e paguara bruto për vitin 2019 patën një ulje prej 8.6% krahasuar me vitin 2018, ku në pamje të parë shihet që efekti prej 95.6% i uljes së dëmeve të paguara vjen nga sigurimi i Jo-Jetës. Por në qoftë se do të analizonim ecurinë e dëmeve bruto në vite, efekti kryesor vjen nga një dëmi i paguar në portofolin e zjarrit në vitin 2018 që ishte afërsisht 1.1 miliardë lekë dhe një faktor tjetër është efekti i dëmeve të paguara Fond Kompensimi të mbledhura në vite, por që u paguan më së shumti në vitin 2018.

Grafik 13: Ndarja e dëmeve të paguara bruto sipas linjës së biznesit, sipas klasave të Jo-Jetës



2.2. Pozicioni Financiar

Në zbatim të kuadrit rregullator ekzistues, AMF ka mbikëqyrur dhe analizuar tregun e sigurimeve, duke vlerësuar pozicionin financiar, rezultatet dhe treguesit teknikë të veprimtarisë së shoqërive të sigurimit gjatë vitit 2019. AMF ka ndjekur në vazhdimësi përmbushjen e kërkesave ligjore mbi Fondin e Garancisë të shoqërive të sigurimit dhe zbatimin e rregullave për investimin e tij.

Fondi i Garancisë

Fondi i garancisë është një shumë në mjete monetare (vlera e së cilës është përcaktuar në nenin 81 të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”) e depozituar nga shoqëria e sigurimit ose e risigurimit në një llogari bankare qëllimore me të njëjtin emër, në bankat në territorin e Republikës së Shqipërisë, ku shoqëria ka selinë qendrore të saj, e detyrueshme për t’u disponuar nga siguroesi që nga çasti i fillimit të veprimtarisë dhe në vazhdim. Shoqëritë e sigurimit zotërojnë Fondin e Garancisë të investuar në “depozita qëllimore” me afat 1-vjeçar pranë bankave të nivelit të dytë dhe në bono thesari. Fondi i Garancisë në nivel tregu për 12 shoqëri sigurimi dhe një shoqëri risigurimi duhet të jetë 4.81 miliardë lekë.

Në 31.12.2019 Fondi i Garancisë së shoqërive të sigurimit, në nivel tregu është investuar në depozita me afat maturimi jo më pak se 1 vit pranë bankave tregtare si dhe në letra me vlerë. Nga shqyrtimi i të dhënave të raportimeve financiare të 31.12.2019, në tabelat e mëposhtme, konstatohet se:


Totali i aktiveve në periudhën 31.12.2019 ka qenë 38.67 miliardë lekë duke u rritur me 7.1 miliardë lekë ose 23% më shumë krahasuar me vitin 2018. Kjo rritje ka ardhur kryesisht nga sektori i Jo-Jetës me 6.33 miliardë lekë ose 22% më shumë krahasuar me vitin 2018. Ky ndryshim ka ardhur si rezultat i rritjes së zërit “Pjesa e risiguruesve në provigjonet teknike” (Provigjone të dëmeve), për dëmet e shkaktuara nga dy tërmetet e ndodhura gjatë kësaj periudhe financiare.

Tabelë 11: Të dhëna financiare për tregun e sigurimeve, Aktivët (Në mln. lekë)

	31.12.'15	31.12.'16	31.12.'17	31.12'18	31.12'19*
Totali i aktiveve	27,610	29,688	30,579	31,564	38,672
Jeta	3,857	3,287	3,382	3,327	4,104
Jo-Jeta	23,752	26,401	27,197	28,237	34,567
Totali i investimeve	18,583	18,811	19,425	20,647	22,301
Jeta	2,904	2,743	2,851	2,822	3,578
Jo-Jeta	15,679	16,068	16,574	17,826	18,724
* Në aktivet e tregut të Jo-Jetës nuk janë të përfshira investimet në kapital të shoqërisë SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a. tek Sigal Life UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a dhe Eurosigs sh.a. tek Insig sh.a. dhe Albsig sh.a. te Albsig Jetë sh.a.					


Të njëjtën tendencë pozitive ka pasur edhe tregu i Jetës, ku totali i aktiveve u rrit me 778 milionë ose 23% më shumë krahasuar me vitin 2018. Licencimi në shtator 2019 të një shoqërie të re në tregun e Jetës, ka ndikuar në rritjen e investimeve nga shoqëritë pjesëmarrëse në këtë treg.

Grafik 14: Totali i aktiveve sipas linjës së biznesit në vite (Në mln. lekë)




Investimet dominuan totalin e aktiveve të shoqërive të sigurimit. Këto investime në 31.12.2019, paraqiten me një vlerë prej 22.3 miliardë lekë. Rritja e investimeve në vlerë absolute ka qenë rreth 1.65 miliardë lekë ose 8% më shumë se viti 2018.


Grafik 15: Totali i investimeve sipas linjës së biznesit në vite (Në mln. lekë)



Investimet e shoqërive të sigurimit janë përqendruar kryesisht në depozita me afat në institucione krediti (banka), Letra me vlerë të Qeverisë Shqiptare, Investime në pjesëmarrje dhe në Toka dhe Ndërtesa. Depozitat zënë peshën kryesore me 32.11%, ndjekur nga Letra me vlerë të Bono thesari dhe Obligacione me 10.94%, Toka dhe ndërtesa me rreth 10.20% dhe Investimet në pjesëmarrje me 10.10%. Në këtë mënyrë tregu i sigurimeve vazhdon të shfaqë një strukturë të thjeshtë të investimeve.

Grafik 16: Struktura e Aktivit (Në %)

Peshën kryesore në strukturën e pasivit të shoqërive të sigurimit e mbartin zërat e provigjoneve teknike, ku llogariten provigjonet për primin e pafituar për pjesën që i përket periudhës së rrezikut pas datës së mbylljes së vitit financiar dhe provigjonet e dëmeve, si dhe “kapitalet e veta” të cilat përfaqësojnë interesin e mbetur në aktivet e entitetit pas zbritjes së të gjitha detyrimeve të tij.

Grafik 17: Struktura e Pasivit (Në %)**Tabelë 12: Të dhëna financiare për tregun e sigurimeve, Pasivi** (Në mln. lekë)

	31.12.'15	31.12.'16	31.12.'17	31.12'18	31.12'19*
Totali i Pasivit	27,610	29,688	30,579	31,564	38,672
Jeta	3,857	3,287	3,382	3,327	4,104
Jo-Jeta	23,752	26,401	27,197	28,237	34,567
Provigjonet teknike bruto	14,014	15,568	15,840	16,393	22,036
Jeta	1,605	1,690	1,702	1,728	1,902
Jo-Jeta					


	12,409	13,878	14,138	14,665	20,135
Totali i kapitaleve të veta	10,120	9,688	9,418	10,665	11,166
Jeta	1,782	1,503	1,542	1,509	1,964
Jo-Jeta	8,338	8,185	7,876	9,156	9,201
Totali i kapitalit të nënshkruar	8,196	7,721	6,953	7,366	7,366
Jeta	1,227	1,234	1,221	1,230	1,632
Jo-Jeta	6,969	6,487	5,732	6,136	5,734

Provizjonet teknike bruto kanë shfaqur një trend pozitiv rritjeje për periudhën 2015-2018. Ky trend ka vazhduar edhe në vitin 2019, ku provizjonet teknike bruto në total për tregun e sigurimeve krahasuar me vitin 2018, janë rritur me rreth 5.64 miliardë lekë, ose 34.43%. Rritjen më të madhe e ka pasur sektori i sigurimit të Jo-Jetës me 5.47 miliardë lekë, ose 37%, ndërsa sektori i sigurimit të Jetës është rritur me 174 milionë lekë, ose 10% më shumë se në vitin 2018. Trendi pozitiv i rritjes së provigjoneve teknike në vlerë absolute është reflektuar edhe në peshën specifike që ky zë përfaqëson në totalin e pasivit, paraqitur edhe në grafikun më lart. Në vitin 2019, pesha specifike e provigjoneve teknike në strukturën e Pasivit të tregut të sigurimeve ishte 57%, duke u rritur me 5% nga viti 2018.


Kapitalet e veta, si rrjedhojë e mbajtjes së fitimit të periudhës, në 2019 pësuan rritje me 5% në vlerë absolute krahasuar me vitin 2018. Edhe pse me rritje, pesha specifike e këtij zëri në strukturën e Pasivit të tregut të sigurimeve përbën 29% duke pësuar një rënie prej 5% nga viti i kaluar. Kjo rënie në peshën specifike vjen si pasojë e rritjes më të madhe të provigjoneve teknike.

Aktivitet në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike në 31.12.2019 për tregun e sigurimeve në total janë në vlerën rreth 26.82 miliardë lekë, ku për tregun e sigurimit të Jo-Jetës janë në vlerën 24.52 miliardë lekë dhe për tregun e sigurimit të Jetës në vlerën rreth 2.3 miliardë lekë.

Aktivitet në mbulim të provigjoneve teknike janë aktivitet e shoqërisë së sigurimit, të cilat shërbejnë për mbulimin e përgjegjësiave të ardhshme që rrjedhin nga kontratat e sigurimit dhe që mbulojnë humbje, si pasojë e rreziqeve që lindin nga ushtrimi i veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit, për të cilat kjo e fundit detyrohet të krijojë provigjone teknike.


Grafik 18: Struktura e aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike (Në %)

Ecuria financiare e tregut të sigurimeve ka qenë pozitive, duke rezultuar në vlerën 861 milionë lekë. Për tregun e sigurimit Jo-Jetë rezultati financiar neto paraqitet në vlerën 697 milionë lekë dhe për tregun e sigurimit të Jetës në vlerën 165 milionë lekë.

Grafik 19: Rezultati financiar për tregun e sigurimeve sipas linjës së biznesit (Në mln. lekë)

Raporti dëme/prime neto për tregun është në masën 37%. Ndërkohë që raporti i kombinuar për tregun e sigurimit është në masën 97%.

Grafik 20: Raporti dëme prime/raporti i kombinuar (Në %)



2.3. Inspektimi në shoqëritë e sigurimeve

Inspektime të plota me fokus rrezikun

Edhe gjatë vitit 2019, Autoriteti vijoi me inspektimin e plotë në vend në dy shoqëri sigurimi të Jo-Jetës sipas metodologjisë me fokus rrezikun, bazuar në Manualin e Mbikëqyrjes së Shoqërive të Sigurimit. Inspektimi u përqëndrua në vlerësimin e rreziqeve kryesore ndaj të cilave ekspozohen shoqëritë e sigurimit sipas aktiviteteve të biznesit në shoqëritë e inspektuara, si dhe administrimi dhe mitigimi i këtyre rreziqeve nga drejtimi i lartë i shoqërisë. Inspektimi sipas metodologjisë me fokus rrezikun përqëndrohet edhe në përgjegjësitë e këshillit mbikëqyrës dhe menaxhimit të lartë të shoqërisë së sigurimit në drejtim të ruajtjes së sigurisë dhe stabilitetit financiar të shoqërisë. Me këto inspektime të plota në vend në shoqëritë e sigurimit AMF filloi ciklin e dytë të inspektimeve sipas metodologjisë me fokus rrezikun në të gjithë tregun e sigurimeve. Në mënyrë më të detajuar këto inspektime u përqëndruan në:

- Vlerësimin e rrezikut të kreditit në marrëdhënie me risiguruesit, mbledhjen e primeve dhe praktika të tjera të lidhura me to;
- Vlerësimin e rrezikut të sigurimit, duke u fokusuar kryesisht tek marrja në sigurim dhe rreziqet e përgjegjësisë, si dhe praktika të tjera të lidhura me to;
- Vlerësimin e rrezikut operacional, duke u fokusuar tek provigjonet, vlerësimi i dëmeve, procedurat e trajtimit të dëmeve, sistemet e teknologjisë së informacionit, performanca operacionale, si edhe aktivitete të tjera të lidhura me to;
- Vlerësimin e rrezikut rregullator dhe strategjik në drejtim të vlerësimit të Fondit të Garancisë, dhe përmbushjes së kërkesave ligjore e rregullatore në fuqi;

- Vlerësimin e fuqisë së kapitalit dhe cilësisë së fitimeve;
- Vlerësimin e elementeve të veçantë të aktiveve të pasqyrave financiare të shoqërisë;
- Menaxhimin e rrezikut, sistemet e kontrollit të brendshëm, përfshirë edhe mbikëqyrjen e veprimtarisë nga nivelet drejtuese të shoqërisë.

Në përfundim të inspektimeve, Autoriteti përditësoi profilin e rrezikut për shoqëritë e inspektuara, i cili përfaqëson vlerësimin për secilin nga rreziqet e shoqërisë së sigurimeve, i cili shërben si bazë për vendosjen e prioriteteve mbikëqyrëse dhe shpërndarjen e kapaciteteve të duhura sipas nivelit të ekspozimit të rrezikut. Në fund të procesit të inspektimit, gjetjet dhe rekomandimet e propozuara nga Autoriteti iu komunikuan subjekteve dhe zbatimi i tyre po ndiqet nga Autoriteti në përputhje me afatet kohore të lëna në raportin e inspektimit dhe do të monitorohen nga AMF.

Inspektime tematike

Gjatë vitit 2019 janë kryer disa inspektime tematike në shoqëritë e sigurimit Jo-Jetë, dhe 3 inspektime në shoqëritë e sigurimit të Jetës. Këto inspektime kanë pasur objekte të ndryshme dhe janë fokusuar në çështje që lidhen drejtpërdrejt me mbrojtjen e konsumatorëve si verifikimi i procesit të trajtimit të dëmeve dhe zbatimi i rekomandimeve të vendimeve të Bordit të Autoritetit. Inspektimet tematike në shoqëritë e sigurimit Jo-Jetë me objekt vlerësimin e procesit të trajtimit të dëmeve, janë kryer në përputhje me kërkesat e manualit të ri të dëmeve. Konkretisht në fokus të këtyre inspektimeve ishin:

- Verifikimi i dëmeve të paguara dhe atyre pezull, në zbatim të kërkesave të Rregullores së Autoritetit nr. 53, datë 25.06.2009 “Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”, e ndryshuar me Vendim Bordi nr. 91, datë 31.05.2019;
- Verifikimi i respektimit të kriterëve ligjore e rregullatore gjatë procesit të trajtimit të kërkesave për dëmshpërblim, duke përfshirë edhe verifikimin e akteve të vlerësimit;
- Verifikimi i dëmeve të refuzuara dhe ankesave të përfituesve;
- Verifikim i saktësisë së raportimit në Autoritet të provigjoneve teknike të dëmeve, etj.

Inspektime të tjera tematike janë kryer me qëllim shqyrtimin dhe vlerësimin e praktikave të shoqërive në lidhje aktivitetin e Risigurimit, inspektime në lidhje me produktin “Garanci Kontrate” të lëshuar për entet shtetërore, etj. Gjatë këtyre inspektimeve vlerësohet dhe ndiqet dhe zbatimi i rekomandimeve të lëna nga Autoriteti në inspektimet e mëparshme apo të tjera çështje sipas kërkesës së grupit të inspektimit. Në kuadër të monitorimit të zbatimit të vendimeve të Bordit të Autoritetit u kryen edhe 6 inspektime tematike në shoqëritë e sigurimit Jo-Jetë me objekt “Verifikimin e zbatimit të kërkesave të Vendimit të Bordit të Autoritetit”.

Çështjet kryesore të evidentuara gjatë inspektimeve tematike kryesisht lidheshin me trajtimin dhe respektimin e afateve rregullatore për pagesën e dëmshpërblimit, metodologjinë për vlerësimin e dëmeve si dhe çështje të tjera që lidhen me aktivitetin e risigurimit dhe me funksionimin e strukturave të brendshme të shoqërisë.

Në fund të procesit të inspektimit, gjetjet dhe rekomandimet e propozuara nga Autoriteti iu komunikuan subjekteve dhe zbatimi i tyre po ndiqet nga Autoriteti në përputhje me afatet kohore të lëna në raportin e inspektimit dhe do të monitorohen nga AMF.

Inspektime të përbashkëta

Gjatë vitit 2019 janë kryer disa inspektime të përbashkëta me institucione të tjera me të cilat Autoriteti bashkëpunon me qëllim një mbikëqyrje të plotë dhe efektive të tregut të sigurimeve. Autoriteti ka kryer për herë të parë një inspektim me Autoritetin Austriak të Tregjeve, i zhvilluar në Austri dhe Shqipëri me një grup inspektimi të përbërë me përfaqësues nga dy institucionet. Janë kryer inspektime në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë pranë të gjitha bankave tregtare me objekt verifikimin në vend të produkteve bankare aktive të shoqërive të sigurimit, si dhe verifikimin e lëvizjeve të depozitave të shoqërive me bankat (depozita me afat, llogari kursimi dhe llogari rrjedhëse), për disa nga shoqëritë e sigurimit.

2.4. Mbikëqyrja e Grupeve

Në tregun e sigurimeve në Shqipëri gjatë vitit 2019 kanë ushtruar veprimtari dy grupe sigurimi me kapital vendas dhe katër shoqëri sigurimi të cilat janë pjesë e grupeve ndërkombëtare të sigurimit, Uniq Insurance Group (UIG) dhe Vienna Insurance Group (VIG), me kapital të huaj austriak.

Autoriteti, në kuadër të një mbikëqyrjeje efektive të grupeve të sigurimit, në përputhje edhe me parimet themelore të sigurimit (ICP) sipas ICP 23 “Për mbikëqyrjen e grupeve”, të hartuara nga Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS), ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me mbikëqyrësit e shteteve ku ushtrojnë veprimtarinë shoqëritë e sigurimit me kapital shqiptar dhe mbikëqyrësit e grupeve të sigurimit ndërkombëtarë që ushtrojnë veprimtarinë në Shqipëri.

Gjatë vitit kalendarik 2019, përfaqësues të AMF-së morën pjesë në takimet e përvitshme të kolegjeve të mbikëqyrjes të grupeve të sigurimeve UNIQA Insurance Group (UIG) dhe Vienna Insurance Group (VIG), të cilat organizohen nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Austrisë (FMA). Kolegjet e mbikëqyrjes kanë qëllim shkëmbimin e informacionit në lidhje me ecurinë e grupeve të sigurimit, në funksion të një mbikëqyrjeje financiare sa më efektive. Përfaqësuesit e AMF-së raportuan gjithashtu pranë FMA-së mbi mbarëvajtjen e veprimtarive të shoqërive të sigurimit, pjesë e grupeve UIG, VIG, që ushtrojnë veprimtari në Shqipëri, mbi prezantimin e rreziqeve që karakterizojnë funksionimin e tyre në tregun shqiptar, si dhe sjelljen në vëmendje të çështjeve dhe problematikave të konstatuara, si nga mbikëqyrja në distancë *off-site*, ashtu edhe nga mbikëqyrja në vend *on-site*.

Në vijimësi, si edhe në zbatim të Udhëzimit Metodologjik “Mbi mbikëqyrjen e grupit të sigurimit”, me qëllim shkëmbimin e informacionit në funksion të mbikëqyrjes efektive në nivel grupi për shoqëritë vendase të sigurimit dhe risigurimit, të cilat kanë investime apo degë të tyre në vende të huaja, Autoriteti gjatë vitit 2019, ka marrë pjesë në 3 Kolegje Mbikëqyrëse Rajonale të një Grupi Sigurimi me kapital vendas, të organizuara në Shkup të Maqedonisë së Veriut, Tiranë pranë ambienteve të Autoritetit, si dhe në Prishtinë pranë ambienteve të Bankës Qendrore të Kosovës.

2.5. Provigjonet Teknike

Në kuadrin e analizës së shëndetit financiar të shoqërive të sigurimit, AMF vlerëson nëse provigjonet teknike janë të mjaftueshme dhe në përputhje me nivelin e rrezikut të kontraktuar nga shoqëritë. Mjaftueshmëria e provigjoneve teknike, vlerësohet në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe mospërmbushja e këtij detyrimi përbën shkelje të rregullave të menaxhimit të rrezikut.

Ecuria në nivel tregu e provigjoneve teknike ndër vite shfaq një tendencë në rritje duke ruajtur dhe strukturën e aktivitetit Jetë dhe Jo-Jetë. Për vitin 2019, provigjonet teknike bruto, në total për aktivitet Jetë dhe Jo-Jetë, janë rreth 22.04 miliardë lekë. Peshën më të lartë nga pikëpamja e veprimtarisë së ushtruar e mbajnë provigjonet teknike bruto të shoqërive të Jo-Jetës, me 91.37% të totalit të provigjoneve teknike bruto ose rreth 20.13 miliardë lekë, ndërkohë që provigjonet teknike bruto për aktivitetin e Jetës arrijnë në rreth 1.9 miliardë lekë ose 8.63% e totalit të provigjoneve teknike bruto. Kjo strukturë reflekton gjithashtu edhe raportin e primeve të shkruara bruto për aktivitetin e Jo-Jetës kundrejt atyre të Jetës, përkatësisht 93.1% dhe 6.9%.

Provigjoni Teknik


Provigjoni teknik është shuma e llogaritur në bazë të një parashikimi dhe sipas mënyrave aktuariale të caktuara, e cila mbahet nga siguruesi, për të mbuluar përgjegjësitë që rrjedhin nga kontratat e sigurimit. **Provigjonet teknike përfshijnë:**

- Provigjonet për prime, të cilat përbëhen nga provigjonet për primet e pafituara dhe për rreziqe të paskaduara. Këto provigjone krijohen në përpjesëtim me primet e shkruara që lidhen me mbulimet e sigurimit, të cilat janë ende të vlefshme pas përfundimit të periudhës financiare gjatë së cilës janë krijuar këto provigjone;
- Provigjonet për bonuse dhe rabate, të cilat krijohen në nivel të njëjtë me shumën e pagesave që merr i siguruari bazuar në të drejtën për përfitimet që rrjedhin nga kontratat e sigurimit, të drejtën për reduktim të pjesshëm të primit të sigurimit (rabat) si dhe të drejtën e rimbursimit të një pjese të primit të sigurimit në rast të përfundimit të parakohshëm të kontratës së sigurimit;
- Provigjonet teknike të dëmeve, të cilat krijohen në rastin e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit para përfundimit të periudhës së sigurimit të kontratës së sigurimit dhe vlerësimi i tyre bëhet në nivel të njëjtë me përgjegjësitë e marra përsipër nga shoqëria e sigurimit nëpërmjet kontratës së sigurimit;
- Provigjone për mbrojtjen për rrezikun ndaj investimit;
- Provigjone të tjera teknike. Këto provigjone krijohen nga shoqëritë e sigurimit me qëllim për të mbuluar përgjegjësitë e pritshme dhe rreziqet për dëme të mëdha, të cilat rrjedhin nga siguri i përgjegjësisë për humbje nga rreziqe bërthamore, përgjegjësinë e prodhuesit të produkteve farmaceutike si dhe rreziqet e përmbytjes dhe tërmetit.

Provigjonet matematike krijohen në nivel të njëjtë me vlerën aktuale të detyrimeve të ardhshme që rrjedhin nga kontratat e sigurimit të jetës, duke zbritur vlerën aktuale të parashikuar për primet e ardhshme për t'u paguar sipas kontratës në fjalë.

Nga të dhënat në nivel tregu, të pasqyruara në grafikun e mëposhtëm, vihet re tendenca në rritje e treguesit të provigjonit teknik të dëmeve dhe primeve, duke reflektuar përpjekjet e vazhdueshme të Autoritetit në drejtim të përmirësimit të këtij treguesi. AMF në vazhdimësi ka dhënë rekomandime për përmirësimin në rritje të treguesit të provigjonit teknik të dëmeve nga siguri i detyrueshëm në përputhje me rritjen e aktivitetit të tregut të sigurimeve. Këto rekomandime janë bazuar në analizat e të dhënave të shoqërive të sigurimit, në gjetjet e konstatuara gjatë inspektimeve në vend, si dhe nga

informacioni i marrë nga palë të treta (gjykatat, për dëmet në proces gjyqësor) lidhur me detyrimet dhe rrezikun ndaj të cilit janë të ekspozuara shoqëritë.

Grafik 21: Provigjoni teknik bruto*(Në mln. lekë)*

Provigjoni Teknik Bruto për sigurimin e detyrueshëm motorik (MTPL)

Provigjoni teknik bruto për produktin MTPL zë peshën specifike më të lartë në totalin e provigjoneve teknike të tregut të Jo-Jetës. Ky tregues, për 31.12.2019, arrin në rreth 11.8 miliardë lekë, duke pësuar kështu një rritje me rreth 10% krahasuar me vitin e kaluar. Pesha e provigjoneve teknike bruto për portofolin e MTPL ka pësuar rënie në 58.62% nga 73.18% që rezultoi në fund të vitit 2018. Ndikimin kryesor e ka dhënë rritja e provigjoneve teknike bruto të dëmeve për linjën e biznesit sigurimi i pronës nga zjarri dhe rreziqe të tjera si dhe linja e biznesit MTPL. Vetëm për dy ngjarjet e tërmetit të ndodhura gjatë vitit 2019, atë të 21 shtatorit dhe atë të 26 nëntorit, vlera e dëmeve të provigjonuara arrin nivelin 3.58 miliardë lekë.

Tabelë 13: Pesha dhe struktura provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm *(Në mln. lekë)*

Pesha e provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Provigjone bruto total MTPL	5,876,000	7,606,407	8,259,209	9,757,238	9,823,894	10,731,867	11,803,025
Provigjone bruto total Jo-Jeta	7,980,000	9,662,572	12,409,665	13,866,272	14,137,852	14,664,884	20,134,552
Pesha specifike (në %) e sigurimeve të detyrueshme kundrejt totalit për tregun	74%	79%	67%	70%	69.49%	73.18%	58.62%
Struktura e provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Provigjoni teknik për dëmet MTPL	52%	53%	52%	52%	52%	54%	56%
Provigjoni I Primit të pafituar MTPL	48%	47%	48%	48%	48%	46%	44%

Referuar tabelës më sipër, vërehet që peshën më të lartë e mban provigjoni teknik i dëmeve në krahasim me provigjoni e primit të pafituar. Edhe gjatë 2019 është ruajtur e njëjta strukturë ndarjeje, në linjë me ecurinë e tarifimit të produkteve të ofruara të sigurimit të detyrueshëm motorik, tregues i cili shfaq efektin e vet tek provigjoni i primit të pafituar.

Ngjarjet e tërmetit të ndodhura gjatë vitit 2019

Gjatë vitit 2019 në Shqipëri kanë ndodhur dy ngjarje “Tërmeti”, konkretisht me magnitudë 5.6 (21 shtator 2019) dhe 6.4 (26 nëntor 2019), me pasoja “katastrofike” në jetë të humbura si dhe dëme materiale (ekonomike). Këto ngjarje ishin edhe sfida më e madhe për tregun e sigurimeve në vend. Me ndodhjen e këtyre ngjarjeve, në funksion të mbrojtjes së konsumatorëve dhe zhvillimit të qëndrueshëm të tregut të sigurimeve, Autoriteti ka mbikëqyrur dhe monitoruar me shumë kujdes këtë situatë, duke kërkuar raportim nga shoqëritë e sigurimit, me frekuencë ditore. Në vijim me stabilizimin e situatës, monitorimi është kryer me bazë javore.

Bazuar në vlerësimet paraprake, duke përfshirë dhe dëmet IBN(E)R (*Incurring but not (enough) reported*), vlera e kërkesave për dëmshpërblim arriti nivelin e 487 milionë lekësh për ngjarjen e 21 shtatorit dhe rreth 3.8 miliardë lekë për ngjarjen e 26 nëntorit deri në 31.12.2019. Referuar numrit të dëmeve të raportuara, në linjë me pronat e siguruara, vihet re, që rreth 85% e tyre i përkasin të siguruarve, të cilët kanë siguruar pronën për efekt kredie, ndërsa pjesa tjetër janë prona të siguruara në mënyrë vullnetare.

Nisur nga treguesit e shoqërive të sigurimit, vihet re se tregu i sigurimeve e përballoi faturën financiare të dëmeve të ndodhura nga dy ngjarjet e tërmetit duke e ndarë këtë faturë edhe me shoqëritë e risigurimit. Bazuar në kontratat e risigurimit në fuqi për vitin 2019, për secilën ngjarje, vlera e dëmeve që pritet të paguhet nga tregu i sigurimeve arrin deri në 220 milionë lekë, ndërsa diferenca pritet të paguhet nga shoqëritë e risigurimit.

Me Rregulloren nr. 85/1, datë 30.09.2015 "Për kriteret e risigurimit", të ndryshuar, AMF ka përcaktuar cilësinë e risiguresve me të cilët duhet të nënshkruajnë kontratat e risigurimit shoqëritë që ushtrojnë aktivitetin e sigurimit në Republikën e Shqipërisë. Cilësia e risiguresve që mbulojnë aktualisht shoqëritë e sigurimit është A+ e lart, sipas agjencive klasifikuese Standard & Poors, AM Best, Fitch, etj. Për ngjarjet e tërmetit, duke qenë ngjarje me probabilitet të ulët, por me ndikim të lartë në rast ndodhjeje, Autoriteti ka miratuar metodologjinë e llogaritjes së normës së mbajtjes agregate neto për sigurimin nga tërmeti (NST) për shoqëritë e sigurimit. Nga vitit 2014 dhe në vijim, AMF e mbikëqyr tregun e sigurimeve sipas metodologjisë me bazë rreziku. Pas këtyre vlerësimeve AMF ka miratuar rritjen më të madhe të provigjoneve teknike në nivelin 34.43%, krahasuar me vitin 2018, rritje e cila merr në konsideratë edhe përfshirjen e dëmeve të këtyre dy ngjarjeve.

Sigurimi i përgjegjësisë së ndërtuesit

Me Vendimin nr. 207, datë 22.11.2019 Bordi miratoi elementet dhe kushtet e përgjithshme të kontratës së sigurimit të detyrueshëm në ndërtim, në bazë e për zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 650, datë 02.10.2019 “Për sigurimin e ndërtimeve”.

Ky produkt sigurimi, me afat 10-vjeçar me përfitues blerësin/blerësit dhe me efekt nga data e përfundimit të punimeve, mbulon dëmet e ndërtesës, përfshirë dëmet ndaj të tretëve, që rrjedhin kur, për shkak të tokës ose për defekt të ndërtimit, ndërtimi shembet tërësisht ose pjesërisht, ose paraqet rrezik të dukshëm shembjeje ose defekte të tjera të rënda, që shfaqen pas lidhjes së kontratës së kalimit të pronësisë.

Në konceptimin e këtij produkti, janë analizuar modele të ndryshme të vendeve të BE, në të cilët ky produkt ka vite që ofrohet si dhe ka pasur bashkëpunim me risiguruesit kryesorë ndërkombëtarë të cilët, në vendet ku operojnë, e mbulojnë në risigurim këtë produkt.

Aktualisht, këtë produkt e ofrojnë në treg të gjitha shoqëritë e sigurimit që ushtrojnë aktivitetin në klasat e Jo-Jetës. Në funksion të mbikëqyrjes me bazë rreziku, Autoriteti shqyrton dhe monitoron aftësinë paguese si dhe kapacitetin e marrëveshjeve të risigurimit për çdo shoqëri sigurimi. Gjithashtu, Autoriteti mbikëqyr dhe monitoron edhe produktet e tjera të lidhura me sigurimin e përgjegjësisë së ndërtuesit, siç janë:

- Sigurimi i përgjegjësisë së ndërtuesit për dëmtime të objektit të përfunduar.(VKM nr. 693, datë 02.10.2019);
- Sigurimi i projektuesve, për mbulimin e përgjegjësiave profesionale.(VKM nr.408/2015)

Për të mbyllur ciklin e përgjegjësisë së ndërtuesit/zhvilluesit me miratimin e Ligjit 3/2020, në bashkëpunim me grupet e interesit, gjatë vitit 2020, Autoriteti do të miratojë elementët dhe kushtet e përgjithshme të sigurimit të detyrueshëm të të gjitha rreziqeve në ndërtim.

Primet e Sigurimit të Detyrueshëm Motorik

Primi i rrezikut

Në kuadrin e projektit të Bankës Botërore *First Initiative*, lidhur me liberalizimin e tarifave të sigurimit të detyrueshëm motorik, shoqëritë e sigurimit janë njohur dhe kanë pranuar modelin e llogaritjes së primit të rrezikut për kontratën e sigurimit të detyrueshëm motorik TPL, metodologji e cila është përshtatur dhe përdorur edhe në vlerësimin e primit të rrezikut për kontratën e sigurimit të Kartonit Jeshil dhe atë Kufitar.

Bazuar në kërkesat e kësaj metodologjie, ku elementët kryesorë për përcaktimin e primit të rrezikut, janë frekuenca dhe kostoja mesatare e dëmeve, shoqëritë e sigurimit marrin në konsideratë inflacionin e dëmit ndër vite si dhe bëjnë projeksionin e tij për periudhat e ardhshme financiare, element ky i rëndësishëm në përcaktimin e një vlere sa më të saktë të primit të rrezikut të ardhshëm.

Autoriteti, mbi bazën e të dhënave të shoqërive të sigurimit, llogarit primin e rrezikut në nivel tregu për produktet e sigurimit të detyrueshëm motorik brenda datës 31 mars të çdo viti. pasardhës. Në vijim, shoqëritë e sigurimit llogaritin nivelin e provigjoneve teknike të primit të pafituar të sigurimit të detyrueshëm motorik, duke u kujdesur që njëherazi:

- Provigjionet teknike të llogariten për çdo policë sigurimi;
- Vlera e provigjioneve teknike të jetë të paktën sa vlera më e lartë midis primit të rrezikut të llogaritur nga vetë shoqëria e sigurimit dhe primit të rrezikut në nivel tregu të llogaritur nga Autoriteti.

Primi mesatar i sigurimit

Primi i paguar nga të sigurvearit përfshin primin e rrezikut, pjesën e llogaritur për mbulimin e shpenzimeve të marrjes në sigurim dhe shpenzimeve administrative, përfshirë dhe komisionet, si dhe pjesën e llogaritur për fitimin e shoqërisë së sigurimit.

Tabelë 14: Primi mesatar i paguar për motoçikleta, autovetura, furgonë për vitet 2015 - 2019

(Në lekë)

Viti/Kategoria	A1/1	A1/2	B1/1	B1/2	B2/1	B2/2
2015	5,640	8,550	15,100	15,850	24,500	29,050
2016	6,150	9,210	16,330	17,120	26,500	31,440
2017	6,040	9,280	16,050	16,880	26,260	30,550
2018	6,140	9,350	16,400	17,230	26,650	31,400
2019	6,450	9,820	17,220	18,090	27,980	32,970

Primi mesatar i paguar nga të sigurvearit për kategoritë kryesore të mjeteve motorike ka pësuar një rritje afërsisht me 5% gjatë vitit 2019, krahasuar me vitin 2018.

2.6. Risigurimet

Bazuar në kuadrin ligjor dhe aktet rregullatore të miratuara nga Autoriteti, shoqëria e sigurimit është e detyruar të risigurojë në një shoqëri risigurimi atë pjesë të rrezikut të sigurvearit që tejkalon limitin e lejuar prej 10% të vlerës së kapitalit. Për produkte dhe raste të veçanta sigurimi, shoqëritë e sigurimit kanë kryer transferim të rrezikut, me anë të kontratave të risigurimit fakultativ, për të zbutur efektet financiare të dëmeve të mëdha dhe ato të mundshme.


Strategjia e ndjekur nga tregu i sigurimit për transferimin e rrezikut, në përgjithësi, është realizuar nëpërmjet bashkësigurimit (kalimit të një pjese të rrezikut të kontratës së sigurimit në një kompani tjetër sigurimi), kalimit në risigurim të portofolave të sigurimit, si dhe mbulimit me risigurim fakultativ të kontratave të veçanta. Në bazë të kërkesave rregullatore, shoqëritë e sigurimit, raportojnë në Autoritet programin e risigurimit. Bazuar në funksionin e saj mbikëqyrës, AMF ndjek ecurinë e zbatimit të këtij programi dhe kontratave specifike të lidhura, duke synuar të sigurojë stabilitetin e vazhdueshëm financiar në lidhje me standardet e mbajtjes së rrezikut nga këto shoqëri risigurimi dhe kriteret e lidhura me cilësinë e risigurveave.

Marrëveshjet risigurvease në portofolat e sigurimit të Jo-Jetës kanë qenë të formës jo proporcionale, kryesisht të tipit *Excess of Loss* (Tejkalim humbjeje) dhe të formës proporcionale, të tipit *Quota Share Surplus*. Në sigurimin e Jetës, mbulimi me risigurim është kryer nëpërmjet marrëveshjeve risigurvease të formës proporcionale të tipit *Surplus* dhe të tipit *Quota Share*.


Primet e ceduara në risigurim për 31.12.2019 rezultojnë:

- Për totalin e tregut të sigurimeve në vlerën prej 3 miliardë lekë ose sa 17.12% e vlerës së primeve të shkruara bruto në nivel tregu. Vlera e primeve të ceduara në risigurim, në nivel tregu, krahasuar me fundin e vitit 2018, është rritur me rreth 137 milionë lekë ose 4.8%;
- Për aktivitetin e Jo-Jetës në vlerën prej 2.96 miliardë lekë ose sa 18.13% e vlerës së primeve të shkruara bruto për sigurimin e Jo-Jetës. Vlera e primeve të ceduara në risigurim, për gjithë aktivitetin e Jo-Jetës, krahasuar me fundin e vitit 2018, është rritur me rreth 137 milionë lekë ose 4.9%;
- Për sigurimin e Jetës në vlerën prej 42.22 milionë lekë ose sa 3.47% e vlerës së primeve të shkruara bruto për sigurimin e Jetës. Primet e ceduara në risigurim për sigurimin e Jetës, janë rritur me rreth 0.5 milionë lekë ose 1.33%, krahasuar me fundin e vitit 2018.

Grafik 22: Ecuria e primeve të ceduara në risigurim për periudhën 2011–2019 (Në mln. lekë)



Grafik 23: Primi i ceduar në risigurim/prime të shkruara bruto, total i tregut (Në %)



Pjesëmarrësit kryesorë në kontratat e risigurimit, sikurse edhe gjatë viteve të kaluara për sigurimin e Jo-Jetës kanë qenë VIG Re, UNIQA Re, Munich Re, Hannover Re, Swiss Re, Partner Re, Scor, Lloyd's syndicates, etj. Për sigurimin e Jetës, shoqëria e vetme risiguruese e përfshirë në këtë program është Scor Global Life. Më shumë se 90% e partnerëve risigurues të shoqërive të sigurimit kanë klasifikim më të lartë se BB nga Standard & Poors, nga ku mbi 60% kanë klasifikim më të lartë se A.

Raportet e vetëvlerësimit të rreziqeve (ORSA)

Në zbatim të kërkesave dhe afateve të përcaktuara në Rregulloren nr. 18, datë 28.04.2015 për “Rregullat e organizimit të sistemit të administrimit të rrezikut në shoqërinë e sigurimit”, shoqëritë e sigurimit gjatë vitit 2019 kanë paraqitur raportin vjetor mbi vlerësimin e rreziqeve të shoqërisë. Autoriteti ka analizuar raportet e vetëvlerësimit të shoqërive të sigurimit, ku vëmendje e veçantë i është kushtuar shqyrtimit të:

- Strategjive, me anë të të cilave përcaktohet qasja e shoqërisë së sigurimit për të trajtuar zonat e veçanta të rrezikut dhe detyrimet ligjore e rregullatore;
- Politikave, me anë të të cilave përcaktohen procedurat dhe kërkesat e tjera që janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga Këshilli i Administrimit/Mbikëqyrjes, drejtuesit e lartë ekzekutivë, funksionarët kryesorë dhe punonjësit e shoqërisë së sigurimit;
- Procesteve, me anë të të cilave zbatohen strategjitë dhe politikat e shoqërisë së sigurimit, si edhe;
- Kontrollleve, me anë të të cilave sigurohet që strategjitë, politikat dhe proceset ekzistojnë, mbikëqyren dhe funksionojnë në përmbushje të objektivave.

Në vijim të analizimit të raporteve të vetëvlerësimit, në kuadër të mbikëqyrjes dhe të monitorimit, u bë i mundur nga Autoriteti një vlerësim perspektiv për aftësinë paguese të shoqërive të sigurimit, si dhe dhënia e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin në të ardhmen të këtij raporti.

2.7. Qeverisja e Shoqërive të Sigurimit

Shoqëritë e sigurimit që operojnë në tregun shqiptar janë organizuar sipas sistemit me një dhe me dy nivele qeverisjeje. Në shoqëritë me një nivel qeverisjeje, këshilli i administrimit ushtron funksionet e administrimit dhe të mbikëqyrjes, ndërsa te shoqëritë me dy nivele qeverisjeje, këshilli mbikëqyrës ushtron funksione mbikëqyrjeje dhe administratori, apo bordi i drejtorëve, ushtron funksione administrimi. Gjatë vitit 2019, AMF miratoi ndryshime apo riemërime në përbërjen e këshillave mbikëqyrës të shoqërive të sigurimi, si dhe emërime në organet drejtuese të tyre.

Tabelë 15: Të dhëna për aksionarët e shoqërive të sigurimit

Subjekte	Numër	%
Shoqëri sigurimi	12	
Aksionarë gjithsej	36	
<i>Klasifikimi i aksionerëve sipas pjesëmarrjes zotëruese</i>		100

nën 10%	18	50.00
mbi 10% nën 20%	1	2.78
mbi 20% nën 33 %	1	2.78
mbi 33% nën 50%	3	8.33
mbi 50%	13	36.11
<i>Klasifikimi i aksionerëve sipas vendit të origjinës:</i>		100
Aksionarë të huaj	2	6
Aksionarë vendas	34	94
<i>Klasifikimi i aksionerëve sipas statusit</i>		
Aksionarë individë	6	17
Aksionarë shoqëri	30	83

Gjatë vitit 2019, AMF ka miratuar kërkesa të shoqërive të sigurimit për ndryshime statutores.

Tabelë 16: Të dhëna mbi miratimin e ndryshimeve statutores (Në numër)

Arsyeja e Ndryshimit të Statutit	2015	2016	2017	2018	2019
Statut i ri/ndryshime të tjera	4	4	2	3	1
Rritje kapitali	2	2	1	3	1
Ndryshim i strukturës aksionere	3	4	1	1	-

2.8. Aktiviteti Licencues

Në tregun e sigurimeve, për vitin 2019, u licencuan:

- Shoqëri të sigurimit të Jetës;
- Ndërmjetësimit në sigurime (broker/agent);
- Vlerësuesit të dëmeve në sigurime;
- Aktuarëve në sigurime.

Autoriteti në aktivitetin e licencimit ka mbajtur parasysh kërkesat ligjore dhe procedurat për licencimin e subjekteve si dhe i ka përmirësuar ato sidomos lidhur me respektimin e afateve kohore për depozitimin e dokumentacionit të kërkuar, informacionit të detajuar lidhur me deklarin e burimit të të ardhurave të përdorura nga aksionerët për zotërimin e aksioneve në një shoqëri dhe dokumentacionin që vërteton burimin e tyre, zbatimin e kërkesave që duhet të plotësojnë aksionerët, administratorët, anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës/Këshillit të Administrimit për të qenë të duhur dhe të përshtatshëm.

Kështu, u rishikuan Rregullorja nr. 85, datë 3.7.2017 “Mbi licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së vlerësuesit të dëmeve në sigurime”, e ndryshuar, si edhe u hartua Rregullorja e re nr. 37, datë 27.3.2019 “Mbi rinovimin e licencës së aktuarit të autorizuar”.

Shoqëri sigurimi

Gjatë vitit 2019 Autoriteti ka marrë vendime lidhur me kërkesën e tre shoqërive për ushtrimin e veprimtarisë në sigurime në territorin e Republikës së Shqipërisë, (2 nga të cilat depozituar që nga fundi i vitit 2018), të paraqitura prej subjekteve si vijon:

Me Vendimet nr.165, datë 14.08.2019 dhe nr. 171, datë 13.09.2019, Autoriteti dha miratimin paraprak të veprimtarisë së sigurimit në klasat e jetës të shoqërisë “Albsig Jetë” sh.a. dhe për licencimin përfundimtar të saj për të ushtruar veprimtari sigurimi në klasat e Jetës në Republikën e Shqipërisë, pas plotësimit të kërkesave ligjore për licencimin si e tillë.

Gjithashtu, AMF me vendimet nr.18, datë 4.3.2019 dhe nr. 105, datë 31.5.2019, ka refuzuar kërkesat e paraqitura nga dy shoqëri për licencimin e ushtrimit të veprimtarisë në sigurime në klasat e Jo-Jetës, pasi nuk plotësuan kërkesat e parashikuara nga kuadri ligjor. Pas licencimit të shoqërisë “Albsig Jetë” sh.a. në tregun shqiptar të sigurimeve ushtrojnë veprimtari sigurimi 12 shoqëri, nga të cilat 4 shoqëri në klasat e jetës dhe 8 shoqëri në klasat e Jo-Jetës. Një shoqëri është e licencuar edhe për ushtrimin e veprimtarisë në risigurime.

Ndërmjetësit në Sigurime

Ndërmjetësit në sigurime përfshijnë brokera fizikë, shoqëri brokerimi, agjentë, shoqëri agjentësh, subjekte të tjera, banka dhe subjekte financiare jobankare të licencuar/miratuara nga AMF mbi bazën e rregullave të miratuara për çdo kategori, të cilat janë përmirësuar sidomos lidhur me forcimin e luftës për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Gjatë vitit 2019, ka vazhduar interesi për licencimin/miratimin e subjekteve fizikë dhe juridikë në veprimtaritë e ndërmjetësimit. Në tregun e sigurimeve aktualisht operojnë 15 shoqëri brokerimi dhe 4 banka me veprimtari brokerimi.

Tabelë 17: Të dhëna mbi brokera të licencuar në sigurime (Në numër)

Statusi i Brokerit	Të licencuar në vitin 2018	Licenca të reja në vitin 2019	Tërhequr licenca gjatë vitit 2019	Të licencuar në fund të vitit 2019
Shoqëri brokerimi	19	1	1	19
nga këto banka	4	-	-	4
Broker fizikë	36	17	1	52

Nga 15 shoqëritë e brokerimit, 8 prej tyre dhe një bankë, ushtrojnë veprimtari vetëm në fushën e sigurimit të Jo-Jetës, ndërsa 4 shoqëri ushtrojnë veprimtari brokerimi në sigurime të Jetës, të Jo-Jetës dhe risigurime, 3 shoqëritë e tjera, si edhe 3 bankat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në të dy fushat e sigurimit, të Jetës dhe Jo-Jetës.

Tabelë 18: Shoqëri brokerimi sipas klasave të sigurimit (Në numër)

Viti	2015	2016	2017	2018	2019
Shoqëri brokerimi Jo-Jetë	5	6	8	9	9
Shoqëri brokerimi Jo-Jetë dhe Jetë	2	5	5	6	6
Shoqëri brokerimi Jo-Jetë, Jetë, Risigurime	2	3	3	4	4
Totali	9	14	16	19	19

Veprimtaria e agjentit në sigurime

Gjatë vitit 2019 vijoi puna për miratimin e personave fizikë për ushtrimin e veprimtarisë si agjentë në sigurime të Jetës dhe të Jo-Jetës, në bazë të kërkesave të depozituara në AMF nga shoqëritë e sigurimit. Gjatë vitit 2019 u miratuan 96 persona fizikë (agjentë) në sigurime. Në procesin e licencimit për të vepruar si agjentë u përfshinë edhe 14 persona juridikë, si subjekte financiare jobankare, shoqëri agjenti, banka të nivelit të dytë dhe subjekte të tjera me aktivitet financiar dhe tregtar.

Tabelë 19: Të dhëna mbi agjentë të licencuar në sigurime (Në numër)

Statusi i agjentit	Të licencuar në fund të vitit 2018	Licenca të reja në 2019	Tërheqje licence, ndërprerje kontrate në 2019	Të licencuar në fund të vitit 2019
Persona juridikë	30	14	6	38
Nga ky numër, në banka	3	1	-	4
Person fizikë	637	96	54	679

Vlerësuesit e dëmeve në sigurime

Gjatë vitit 2019, AMF miratoi për personat fizikë 3 licenca të reja për vlerësues dëmsh në sigurime dhe rinovoi 10 licenca ekzistuese. Të dhëna mbi numrin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime, sipas statusit të vlerësuesit (i punësuar/i pavarur) dhe llojit të licencës (për dëme materiale dhe/ose shëndetësore) jepen në tabelën e mëposhtme.

Tabelë 20: Të dhëna mbi numrin e vlerësuesve të dëmeve të licencuar në sigurime (Në numër)

Vlerësues sipas statusit/llojit të licencës	Të licencuar në fund të vitit 2018	Rinovim licence në 2019	Licenca të reja në 2019	Përfunduar afati i licencës në 2019	Tërheqje licence, në 2019	Të licencuar në fund të vitit 2019
Sipas statusit të personit						
Të pavarur	36	7	-	9	-	34
Të punësuar	38	3	3	8	-	36
Licencë joaktive	4	-	-	2	-	2
Sipas llojit të Licencës						
Dëme materiale	3	-	-	1	-	2
Dëme shëndetësore	17	3	1	2	-	19

Dëme materiale + shëndetësore	58	7	2	16	-	51
Totali	78	10	3	19	-	72

Gjithashtu, gjatë vitit 2019 u licencuan edhe tre subjekte juridikë për ushtrimin e veprimtarisë së vlerësuesit të dëmeve.

Aktuarë në sigurime

Gjatë vitit 2019, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në bazë dhe për zbatim të kërkesave të nenit 222, të Ligjit nr. 52, datë 22.5.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” si dhe Rregullores nr. 37, datë 27.3.2019 “Mbi rinovimin e licencës së aktuarit të autorizuar”, miratoi rinovimin e autorizimit për 10 persona për të ushtruar veprimtarinë e aktuarit të autorizuar në sigurime, për një periudhë 3 vjeçare.

Testimet profesionale në fushën e sigurimeve

Në zbatim të kërkesave rregullative, licencimi i profesionit të brokerit në sigurime, apo i vlerësuesit të dëmeve në sigurime është i lidhur me kalimin me sukses të testit për njohuritë profesionale në fushën përkatëse. Gjatë vitit 2019, Autoriteti ka organizuar 2 testime për aplikantët që kërkuan të pajisen me licencën e brokerit në sigurime dhe 2 testime për vlerësuesit e dëmeve. Qëllimi i organizimit të testimeve ka qenë certifikimi i njohurive profesionale, me synim kryerjen e shërbimeve financiare nga profesionistë që njohin legjislacionin dhe fushën e aktivitetit ku do të operojnë.

Monitorimi i ndërmjetësve në sigurime

Gjatë vitit 2019, Autoriteti në kuadër të mbrojtjes së interesave të konsumatorit si objektivi kryesor i tij, ka monitoruar nëpërmjet raportimeve periodike, rast pas rasti apo verifikimeve në vend zbatimin e kërkesave ligjore dhe rregullatore të aktivitetit të agjentëve/punonjësve, kryesisht të atyre që ushtrojnë veprimtarinë e shitjes së policave të sigurimit të detyrueshëm TPL.

Pjesë e këtyre verifikimeve kanë qenë edhe ankesat e depozituara në Autoritet, ku për shkeljet e konstatuara Bordi i Autoritetit ka marrë masa disiplinore deri në pezullimin e licencës për një periudhë 6-mujore.

Gjithashtu, gjatë vitit 2019, vijoi inspektimi pranë të gjitha shoqërive të brokerimit, për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga Bordi i Autoritetit dhe nga inspektimet e mëparshme, si dhe u inspektuan edhe shoqëri të tjera brokerimi aktiviteti i të cilave filloi gjatë vitit 2018. Në fokus të këtyre inspektimeve kanë qenë verifikimi i zbatimit të rregullave të brendshme gjatë ushtrimit të veprimtarisë së ndërmjetësimit në sigurime në kuadër të mbrojtjes konsumatore.

2.9. Byroja Shqiptare e Sigurimit (BSHS)

Byroja Shqiptare e Sigurimit (Byroja) është person juridik, me seli në Tiranë, e krijuar jo për qëllime fitimi. Referuar Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, Byroja administron: Fondin e Kompensimit dhe Fondin e Garancisë së Kartonit Jeshil.

Byroja është përfaqësuese kombëtare në Këshillin e Byrove dhe është përgjegjëse për të gjitha detyrimet, që rrjedhin nga anëtarësia në sistemin e Kartonit Jeshil. Anëtar i Byrosë Shqiptare është çdo shoqëri sigurimi e licencuar për të ushtruar veprimtarinë në sigurimin e detyrueshëm motorik dhe sigurimin e pasagjerëve nga aksidentet në transportin publik.

Mbikëqyrja e Byrosë kryhet nga Autoriteti, i cili ka përcaktuar me rregullore të veçantë rregullat dhe standardet e raportimit dhe të mbikëqyrjes së saj. Kompetencat, detyrat e organeve drejtuese të Byrosë dhe forma e organizimit të saj përcaktohen në statutin e Byrosë, i cili propozohet nga asambleja e përgjithshme dhe miratohet nga Autoriteti.

Gjatë vitit 2019, u miratua nga Bordi i Autoritetit Rregullorja nr. 119, datë 06.06.2019 “Mbi Administrimin e Fondit të Kompensimit”, e cila përcakton rregullat e detyrueshme mbi administrimin e Fondit të Kompensimit dhe mbi delegimin, trajtimin, pagesën dhe rimbursimin e praktikave objekt i Fondit të Kompensimit. Në funksion të mbrojtjes konsumatore, dhe uljen e detyrimeve nga Fondi i Kompensimit gjatë vitit 2019, nga Autoriteti janë marrë disa vendime:

- Vendimi nr. 118, datë 06.06.2019 "Për marrjen e masave korrigjuese ndaj BSHS-së", duke kryer shpërndarjen e praktikave të përfunduara të Fondit të Kompensimit;
- Vendimi nr. 150, datë 24.07.2019 "Për marrjen e masave korrigjuese ndaj BSHS-së", duke kryer shpërndarjen e praktikave të përfunduara të Fondit të Kompensimit;
- Vendimi nr.225, date 22.11.2019 “Për marrjen e masave korrigjuese ndaj BSHS-së”, me qëllim ndër të tjera sistemimin e praktikave të paguara (të përfunduara), duke i plotësuar me dokumentacionin përkatës si dhe duke i pasqyruar këto në përllogaritjen e detyrimit të saktë të Fondit të Kompensimit.

Në zbatim të Rregullores nr. 2, datë 28.01.2010, e ndryshuar, me qëllim informatizimin e procesit të trajtimit të dëmeve nga Fondi i Kompensimit dhe nxjerrjen e saktë të raporteve të dëmeve, prej muajit janar të vitit 2019 pranë BSHS-së, funksionon Sistemi Elektronik i Administrimit të Dëmeve të Byrosë Shqiptare të Sigurimit. Në këtë sistem, nga ana e BSHS dhe shoqërive të sigurimit po punohet edhe për administrimin e dokumentacionit të praktikave të dëmeve të fondit të kartonit jeshil. Ky sistem i shërben Autoritetit që në kohë reale të verifikojë statusin e praktikës së dëmeve.

Fondi i Kompensimit

Bordi me Vendimin nr. 260, datë 28.12.2018 ka miratuar Fondin e Kompensimit të vitit 2019. Ky vendim është marrë bazuar në nenin 45, të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2012, Autoriteti, me propozim të Byrosë, vendos çdo vit shumën e kontributeve, sipas pikave 2 e 3, shkronja b e këtij neni dhe afatin brenda të cilit duhet të bëhet derdhja.

Autoriteti edhe për vitin 2019, ka hartuar dhe zbatuar një plan veprimi që lidhet kryesisht me ecurinë e Fondit të Kompensimit, ku përcaktohen pikat kyçe ku Autoriteti duhet të fokusohet për këtë çështje.

Strukturat e AMF-së kanë monitoruar shpërndarjen e praktikave të përfunduara të Fondit të Kompensimit, si dhe ecurinë e marrëveshjeve të lidhura nga shoqëritë e sigurimit për vitin 2018 dhe 2019, duke kërkuar në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e rregullores përkatëse. Për vitin 2019 pagesat për dëmet e Fondit të Kompensimit janë në vlerën rreth 604 milionë lekë, të cilat nga janari i vitit 2019 e në vazhdim janë pjesë e raportimit periodik mujor të BSHS-së në AMF.

Në funksion të mbikëqyrjes së BSHS-së lidhur me administrimin e Fondit të Kompensimit, gjatë vitit 2019, janë kryer disa inspektime me tematika të ndryshme. Një mekanizëm tjetër kontrolli për dëmet objekt Fond Kompensimi ka qenë edhe ngritja e një grupi të përhershëm inspektimi brenda Autoritetit. Ky grup ka pasur për detyrë të verifikojë rast pas rasti dhe pa paralajmërim çdo ankesë të depozituar në Autoritet përfshirë edhe ato nëpërmjet portalit të bashkëqeverisjes. Nga inspektimet tematike të kryera në shoqëritë e sigurimit dhe BSHS, për praktikatat që i përkasin dëmeve me objekt Fond Kompensimi, janë marrë disa vendime Bordi lidhur me shpërndarjen e praktikave të përfunduara dhe lëshimin e autorizimeve nga BSHS në shoqëritë e sigurimit si dhe pagesën e tyre në zbatim të kërkesave rregullatore në fuqi.

Në muajin dhjetor 2019 Autoriteti ka miratuar vlerën e Fondit të Kompensimit për vitin 2020, duke përcaktuar dhe detyrimin për pagesën e praktikave me ngjarje më të hershme.

Inspektime lidhur me Fondin e Kompensimit

Gjatë vitit 2019 janë kryer 36 inspektime tematike pranë BSHS dhe shoqërive të sigurimit Jo-Jetë me fokus dëmet objekt i Fondit të Kompensimit. Çështjet më thelbësore të trajtuara kanë të bëjnë me kontrollin e pagesave të dëmeve sipas kërkesave rregullatore, përputhshmërinë e tyre me të dhënat e raportuara, vlerësimin e sigurisë dhe vlefshmërisë së programeve informatike të përdorura nga BSHS për ruajtjen dhe administrimin e të dhënave, ndjekjen e padive të regresit, si dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga inspektimet e mëparshme të Autoritetit. Përfundimet e dala nga inspektimet e ushtruara i kanë shërbyer përcaktimit të saktë të detyrimit të Fondit të Kompensimit si dhe pagesës së dëmeve, me qëllim mosakumulimin e detyrimit për në të ardhmen.

Gjithashtu, gjatë vitit 2019, grupi i përhershëm i inspektimit, ka shqyrtuar edhe ndjekjen e pagesave sipas marrëveshjeve të lidhura mes palëve për detyrimet e lindura nga dëmet e Fondit të Kompensimit, ndjekjen e ecurisë së shlyerjes së pagesave për dëmet me datë aksidenti më të hershme, si dhe ndjekjen e rekomandimeve të lëna në raportet e inspektimit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullatore në fuqi. Informacionet e përftuara nga inspektimet e kryera në shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës dhe BSHS me objekt dëmet e Fondit të Kompensimit janë përcjellë në Bord, i cili ka vijuar me marrjen e masave përkatëse, zbatimi i të cilave kryhet në vazhdimësi nga strukturat e Autoritetit.

Gjatë vitit 2019 janë ndjekur me prioritet edhe nëpërmjet shkresave kërkesat për vëmendje nga përfaqësuesit ligjor të përfituesve të dëmeve Fond Kompensimi ndaj BSHS-së dhe shoqërive të sigurimit duke i adresuar ato rast pas rasti.

Gjithashtu, Autoriteti në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve në zbatim të kërkesave rregullatore për mbikëqyrjen e veprimtarisë së BSHS-së ka monitoruar procesin e asgjësimit të kontratave të sigurimit të detyrueshëm motorik në tregun e sigurimeve.

2.10. Zbatueshmëria dhe Kuadri Ligjor

AMF miratoi Rregulloren nr. 249, datë 24.12.2019 “Për Regjistrin Elektronik të Dëmeve të Sigurimeve të Detyrueshme Motorike”.

Rregullorja doli në zbatim të nenit 38 pika 1, germa d) dhe pika 2, të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar dhe shfuqizoi Rregulloren nr. 36, datë 30.04.2009 “Për Regjistrin Elektronik të Dëmeve të Sigurimeve të Detyrueshme Motorike”, e ndryshuar. Shoqëria e sigurimit dhe Byroja detyrohen të furnizojnë regjistrin e dëmeve me të gjitha të dhënat për dëmet që rrjedhin nga sigurimi i përgjegjësisë së pronarit ose përdoruesit të mjetit motorik, për dëme shkaktuar palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti.

Me Vendimin nr. 207, datë 22.11.2019 Bordi miratoi elementet dhe kushtet e përgjithshme të kontratës së sigurimit të detyrueshëm në ndërtim, në bazë e për zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 650, datë 02.10.2019 “Për sigurimin e ndërtimeve”. Ky produkt sigurimi, me afat 10-vjeçar me përfitues blerësin/blerësit dhe me efekt nga data e përfundimit të punimeve, mbulon dëmet e ndërtesës, përfshirë dëmet ndaj të tretëve, që rrjedhin kur, për shkak të tokës ose për defekt të ndërtimit, ndërtimi shembet tërësisht ose pjesërisht, ose paraqet rrezik të dukshëm shembjeje ose defekte të tjera të rënda, që shfaqen pas lidhjes së kontratës së kalimit të pronësisë.

Udhëzim nr. 156, datë 24.07.2019 “Mbi raportimin e shitjeve të policave të sigurimit të punonjësve të punësuar në veprimtarinë minerare nga aksidentet në punë”. Personat, që zotërojnë leje për të ushtruar veprimtari minerare brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, janë të detyruar të kryejnë sigurimin e punonjësve të tyre nga aksidentet personale në punë, sipas një kontrate, pranë një shoqërie sigurimi. Ky detyrim rrjedh nga VKM nr. 1109, datë 30.07.2008. “Për sigurimin e punonjësve, të punësuar në veprimtarinë minerare, nga aksidentet në punë”. Kushtet standarde të kontratës së sigurimit, përfshirë tabelat e koeficienteve të përfitimit, sipas dëmtimeve shëndetësore, janë miratuar nga Bordi i Autoritetit sipas Vendimit nr. 92, datë 14.08.2008. Udhëzimi i ri u hartua bazuar në kërkesën e rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë dhe objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i procedurës së identifikimit, raportimit të të dhënave të shitjes së policave të sigurimit të punonjësve nga aksidentet personale në fushën minerare, si dhe mënyra e funksionimit të këtij sistemi raportimi.

Rregullorja nr. 119, datë 6.06.2019 “Mbi administrimin e Fondit të Kompensimit”. Kjo rregullore përcaktoi rregullat e detyrueshme mbi administrimin e Fondit të Kompensimit dhe mbi delegimin, trajtimin, pagesën dhe rimbursimin e praktikave, objekt i Fondit të Kompensimit dhe ka shfuqizuar

rregulloren nr. 36, datë 21.03.2012 “Për krijimin, llogaritjen, financimin, administrimin e Fondit të Kompensimit dhe kryerjen e pagesave të dëmeve”.

Rregullorja nr. 37, datë 27.03.2019 “Mbi rinovimin e licencës së aktuarit të autorizuar”. Kjo rregullore shfuqizoi rregulloren nr. 57, datë 28.4.2016 “Mbi trajnimet e vazhdueshme profesionale dhe rinovimin e licencës së aktuarit të autorizuar”, pasi trajnimet profesionale përbëjnë objekt për një tjetër rregullore të AMF-së, gjithashtu u përcaktuan rregulla lidhur me afatet e paraqitjen së kërkesës për rinovimin e licencës.

Rregullorja nr. 35, datë 27.03.2019 “Për organizimin dhe funksionimin e testimit të njohurive të kandidatëve që aplikojnë për licencë/rinovim licence në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”. Kjo rregullore përcakton mënyrën dhe procedurën për kryerjen e testimit të njohurive për licencim nga kandidatët që kanë plotësuar kriteret dhe aplikojnë në Autoritet për t’u pajisur me licencë për vlerësues dëmsh, broker në sigurime, aktuar i autorizuar, etj., ose për të rinovuar licencën e vlerësuesit të dëmeve në sigurime. Rregullorja e re përmbledh në një akt të vetëm rregullativ të gjitha rregullat për organizimin dhe funksionimin e testimit të njohurive të kandidatëve që aplikojnë për licencim apo rinovim licence në AMF, duke shfuqizuar kapitujt e testimit në rregulloret respektive, ekzistuese të licencimit.

Amendime të akteve ekzistuese

Me Vendimin e Bordit nr. 111, datë 06.06.2019, u bënë ndryshime në Rregulloren nr. 23, datë 26.2.2018 “Për regjistrin elektronik *online* të shitjeve të kontratave të sigurimit të detyrueshëm motorik”, duke u riformuluar fusha e zbatimit të rregullores, kështu kjo rregullore zbatohet nga shoqëritë e sigurimit, agjentët/shoqëritë e agjentëve, punonjësit e shoqërive të sigurimit, si dhe në rast kërkesë nga brokerat/shoqëritë e brokerimit, të licencuar nga AMF për të ushtruar veprimtari në klasat që lidhen me sigurimin e detyrueshëm. Gjithashtu, tek përkufizimi i llojeve të policave u shtua edhe polica e sigurimit të pasagjerëve nga aksidentet në transportin publik.

Me Vendimin e Bordit nr. 91, datë 31.05.2019 u miratuan ndryshimet në Rregulloren nr. 53, datë 25.6.2009 "Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit". Lidhur me kërkesën për dëmshpërblim si datë e marrjes së saj do të quhet data e depozitimit të kërkesës së bashku me dokumentacionin e plotë shoqërues e nëse kërkesa e paraqitur nuk është e plotë, shoqëria e sigurimit i drejtohet paraqitësit të kërkesës me shkrim brenda 8 ditëve pas pranimit të kërkesës dhe i kërkon plotësimin e dokumentacionit. Më tej u bënë shtesat sipas të cilave në rast pranimi të kërkesës, shoqëria e sigurimit duhet të njoftojë palën e dëmtuar për masën e dëmshpërblimit të vlerësuar prej saj dhe në rast refuzimi shoqëria e sigurimit duhet të njoftojë me shkrim palën e dëmtuar për refuzimin dhe shkaqet ligjore, që çojnë në këtë refuzim. Shoqëria e sigurimit do të kryejë pagesën e dëmshpërblimit brenda 14 ditëve, pas përfundimit të afatit të trajtimit të dëmit dhe nënshkrimit të deklaratës së pranimit të dëmshpërblimit.

Me Vendimin e Bordit nr. 14, datë 15.02.2019 u miratuan ndryshimet në Rregulloren nr. 110, datë 28.7.2011 "Për përcaktimin e nivelit të provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit", rregullore e cila del në zbatim të nenit 10, të Ligjit nr. 10 076, datë 12.2.2009 “Për

sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”. Sipas ndryshimeve shoqëria publikon primet e rrezikut si dhe primet e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit në faqen e saj të internetit dhe i mban ato të afishuara në faqe gjatë gjithë periudhës së zbatimit.

Me Vendimin e Bordit nr. 106, datë 31.05.2019 u miratuan ndryshimet në Rregulloren nr. 19, datë 28.4.2015 "Për aktivet në mbulim të provigjoneve teknike dhe llojet e investimeve të lejuara të këtyre aktiveve" Ndryshimet konsistojnë tek objekti i rregullores, kategoritë e investimeve ndërsa ndryshon tërësisht dispozita për diversifikimin dhe kufizimet e investimeve.

Me Vendimin e Bordit nr. 107, datë 31.05.2019 u miratuan ndryshime në Rregulloren nr. 34, datë 28.5.2015 "Për raportimin e detyruar dhe periodik të shoqërive të sigurimit dhe risigurimit", ndryshime të cilat kanë të bëjnë me formën, përmbajtjen dhe mënyrën e plotësimit të raportit mbi aktivet në mbulim të provigjoneve teknike, të raportit mbi mjaftueshme rinë e kapitalit etj.

Me Vendimin e Bordit nr. 125, datë 21.06.2019 u miratuan ndryshimet në Rregulloren nr. 1, datë 25.1.2016 “Për procedurat dhe mënyrën e depozitimit të informacionit dhe dokumentacionit në lidhje me burimin e kapitalit për aksionarët e shoqërisë së sigurimit”, u riformulua dispozita për dokumentacionin e aksionarit themelues, dispozita për kriteret e aksionarit influencues si edhe u shtua një dispozitë e re për bashkëpunimin me DPPP. Në rast se Autoriteti konstaton, apo ka dyshime të arsyeshme se aksionari themelues, aksionari influencues dhe/apo burimi i parave të tij lidhet me persona të dënuar për kryerjen e veprave penale, që kanë lidhje familjare apo marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi me aksionarët e propozuar, njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe pezullon procedurën e licencimit apo miratimit deri në një përgjigje nga kjo e fundit. Në rast se Autoriteti konstaton, apo ka dyshime të arsyeshme se struktura e kapitalit të shoqërisë së sigurimit apo burimi i tij lidhet me kompani të regjistruara në parajsë fiskale, njofton dhe kërkon informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe pezullon procedurën e licencimit apo miratimit deri në një përgjigje nga kjo e fundit.

Me Vendimin e Bordit nr. 13, datë 15.02.2019, u miratuan ndryshimet në Rregulloren nr. 9, datë 25.1.2016 "Mbi bazat dhe metodat e llogaritjes, mënyrat e mbajtjes së provigjoneve teknike, si dhe kriteret dhe procedurat e miratimit të tyre nga Autoriteti". Midis të tjerash ndryshimet konsistuan në ndryshimin e formatit të raportimit të bazës së të dhënave që merren në konsideratë nga aktuarët e shoqërive të sigurimit për përllogaritjen e provigjoneve teknike të sigurimit për klasat e Jo-Jetës si edhe formatin e tabelave përmbledhëse të plotësuar e që depozitohen nga shoqëria e sigurimit së bashku me bazën e të dhënave dhe llogaritjet e provigjoneve teknike.

Me vendimin nr. 182, datë 13.09.2019 Bordi miratoi një ndryshim në Udhëzimin nr. 156, datë 24.7.2019 “Për miratimin e udhëzimit mbi raportimin e shitjeve të policave të sigurimit të punonjësve të punësuar në veprimtarinë minerare nga aksidentet në punë”. Gjatë periudhës së përshtatjeve në sistemet e tyre, nga shoqëritë e sigurimeve, u evidentuan disa kërkesa të reja, me qëllim raportimin sa më të saktë të policave dhe njëkohësisht u shfaqën disa probleme teknike, për të cilat u shty afati aplikimit *live* të raportimit të policave të sigurimit të punonjësve të punësuar në veprimtarinë minerare nga aksidentet në punë të jetë nga data 1.9.2019 në datën 1.10.2019.

Me Vendimet e Bordit nr. 36, datë 27.03.2019 dhe nr. 164, datë 14.08.2019 u miratuan ndryshime në Rregulloren nr. 85, datë 3.7.2017 "Mbi licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së vlerësuesit të dëmeve në sigurime". Ndryshimet kishin të bënin midis të tjerash me afatin e paraqitjes së kërkesës për rinovim licence etj. Ndryshimet ishin zgjidhje e problemeve që ka nxjerrë monitorimi i punës së vlerësuesve të dëmeve, i shkeljeve të konstatuara nga Autoriteti gjatë ushtrimit të funksioneve të veta mbikëqyrëse dhe duke e reflektuar këtë tek shkaqet për refuzimin e licencës, mosrinovim e licencës apo revokimin e saj.

2.11. Masat Korrigjuese dhe Administrative

Legjislacioni që rregullon veprimtarinë e subjekteve financiare nën mbikëqyrjen e AMF-së si dhe ligji "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" parashikojnë masa korrigjuese dhe administrative me qëllim parandalimin, korrigjimin apo ndërprerjen e rrethanave e veprimeve që përbëjnë shkelje të dispozitave ligjore ose akteve të Autoritetit. Masat mbikëqyrëse, korrigjuese e sanksionuese janë vendosur nga Autoriteti në mënyrë të paanshme, transparente duke respektuar parime të efektshmërisë, vazhdimësisë, dhe proporcionalitetit me rrethanën apo veprimin që përbën shkelje dhe ndikim mbi interesat e të siguruarve. Masat e marra nga Autoriteti janë bazuar në inspektimet në vend, kontrollin mbi dokumente, verifikim të informacionit.

Bordi i AMF-së, gjatë periudhës janar-dhjetor 2019, ka marrë gjithsej 32 vendime për masa administrative e korrigjuese ndaj subjekteve të mbikëqyrura. Si rezultat i gjetjeve nga inspektimet dhe performancës jo të mirë financiare, masat juridike të marra në përputhje me legjislacionin në fuqi janë shtimi i mjeteve për plotësim të kërkesave rregullative për kapitalin minimal të kërkuar, mbulimi me aktive i provigjoneve teknike, kufizim përdorimi të aktiveve të shoqërisë, revokim licence, pezullim ushtrim veprimtarie, gjoha monetare dhe çështje të tjera.

Tabelë 21: Masat administrative të marra nga AMF gjatë vitit 2019

(Në numër)

Masa administrative gjatë vitit 2019								
Përshkrimi i masës	Rregulla të administrimit të rrezikut	Raportim në AMF	Monitorimi i moszbatimit të rekomandimeve të lëna	Inspektim	BSHS/ Fond Kompensimi	Vlerësuesit e dëmeve në sigurime	Agjent/ punonjës në sigurime	Broker/ Shoqëri brokerimi në sigurime
Vendime Bordin	3	2	2		4	6	4	7
Urdhër eliminim shkelje	3							1
Masa korrigjuese			2	1	3	5		4
Gjobë		2	2		1	1		2
Refuzim Emërimi							1	
Tërheqje licence								2
Pezullim licence							3	

Vendime të ankimuara të Bordit të Autoritetit

Gjatë vitit 2019, janë shqyrtuar në rrugë administrative dhe gjyqësore disa ankimime të vendimeve të Bordit, konkretisht:

- Ankime Administrative të depozituara pranë AMF-së, gjatë vitit 2019, janë 4 vendime, 2 vendime të marra në dhjetor 2018 dhe 2 vendime të marrë në prill 2019. Nga shqyrtimi i këtyre ankimeve, Bordi mori 3 vendime për refuzim ankimi, 1 vendim ndryshim pjesërisht i vendimit të bordit;
- Ankime të depozituara në gjykatë gjatë vitit 2019, janë 4 vendime Bordin, nga të cilat dy ankime janë për vendime të dhjetorit 2018 dhe dy ankime për vendime të vitit 2019.

Ecuria e vendimeve të ankimuara në gjykatë

Përsa i përket ankimeve në gjykatë ndaj 4 vendimeve të Bordit, të katërta çështjet janë fituar në gjykatën e shkallës së parë nga AMF dhe për dy prej tyre është depozituar ankim nga pala paditëse në Gjykatën e Apelit. Ndërsa për dy çështjet e tjera, palët nuk mund të depozitojnë ankim, për shkak të vlerës së vogël, në Gjykatën e Apelit bazuar në Ligjin 49/2012 “Për organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Autoriteti ka ndjekur dhe 5 procese gjyqësore si palë e tretë, 4 çështje gjyqësore në Gjykatën Administrative të Apelit, një proces për të cilin Autoriteti nuk duhet të ishte palë e paditur, pra padia ishte me të meta dhe gjatë gjykimit gjykata vendosi për pranimin e kërkesës për daljen nga procesi si palë e paditur, gjithashtu AMF ka ndjekur edhe proces gjyqësor me shoqëritë përmbarimore. AMF ka ndjekur me rigorozitet proceset e ankimit dhe mbrojtjes gjyqësore në të gjitha shkallët e sistemit gjyqësor. Gjatë vitit 2019, Autoriteti ka ndjekur 33 procese gjyqësore.

Gjatë vitit 2019, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë janë gjykuar 4 çështje, të cilat janë fituar nga Autoriteti dhe ndaj të cilave është bërë ankim në Gjykatën Administrative të Apelit. Gjatë vitit 2019, AMF ka ndjekur dhe gjykimin e 4 çështjeve në Gjykatën Administrative të Apelit, nga të cilat 1 çështje është fituar nga AMF dhe 3 janë fituar nga palët paditëse, ndaj dy prej të cilave është bërë rekurs në kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe për një çështje nuk mund të ushtrohet rekurs për shkak të vlerës së vogël parashikuar në nenin 56 të Ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Nga totali i 21 çështjeve të mbartura, 12 çështje janë për shqyrtim në gjykatën Administrative të Apelit dhe 8 çështje pritet të gjykohen në Gjykatën e Lartë.

Kapitulli 3

MBIKËQYRJA E TREGUT TË PENSIONEVE PRIVATE VULLNETARE

3.1. Struktura e Tregut

Skema e organizimit dhe funksionimit të pensioneve private vullnetare, e sanksionuar me Ligjin nr. 10197 datë 10.12.2009 ka krijuar hapësirat e nevojshme për të stimuluar shtetasit të kursejnë privatisht dhe vullnetarisht për të përfituar një pension shtesë.

Edhe gjatë vitit 2019, në tregun e pensioneve private vullnetare ushtruan aktivitetin e tyre 3 fonde pensioni vullnetar të administruar nga tre shoqëri administruese, përkatësisht “Raiffeisen Invest” sh.a., që administron Fondin e Pensionit Vullnetar “Raiffeisen”, “SIGAL-Life Uniq Group Austria” sh.a., që administron Fondin e Pensionit Vullnetar “Sigal”, si dhe “Credins Invest” sh.a., që administron Fondin e Pensionit Vullnetar “Credins Pension”.

3.2. Pozicioni Financiar



Tregu i fondeve të pensionit vullnetar që prej fillimit të aktivitetit të tij, ka pasur tendencë në rritje, përse i përket aseteve që menaxhon, si dhe numrit të kontribuesve.

Totali i aseteve neto të këtij tregu më 31.12.2019 është rreth 2.9 miliardë lekë me një numër prej 28,273 anëtarë. Asetet neto të këtij tregu më 31.12.2019 kanë pësuar një rritje me 27.14%, ndërsa numri i anëtarëve është rritur me 11.76% krahasuar me fundin e vitit 2018.

Tabelë 22: Asetet neto të fondeve të pensionit vullnetar

<i>Përshkrimi</i>	<i>Vlera (mln. lekë)</i>			<i>Ndryshimi (në %)</i>	
	<i>2017</i>	<i>2018</i>	<i>2019</i>	<i>31.12.'17- 31.12.'18</i>	<i>31.12.'18- 31.12.'19</i>
Asetet neto të tregut të FP	1,727.54	2,289.10	2,910.44	32.51%	27.14%

Në 31.12.2019 fondi i pensionit vullnetar “Sigal” zë peshën më të madhe të këtij tregu përse i përket vlerës së aseteve neto 45.80%, kurse fondi i pensionit vullnetar “Raiffeisen” dhe fondi i pensionit vullnetar “Credins Pension” zënë respektivisht 25.82% dhe 28.38% të tregut, siç shihet edhe në grafikun e mëposhtëm.

Grafik 24: Ndarja e tregut sipas vlerës së aseteve neto të fondeve të pensionit, 31.12.2019 (Në %)**Grafik 25: Ndarja e tregut sipas vlerës së aseteve neto të fondeve të pensionit vullnetar 2017-2019 (Në %)****Tabelë 23: Vlera e kuotës së fondeve të pensionit vullnetar (Në lekë)**

Fondi i pensionit	Vlera e aseteve neto për kuotë 2017	Vlera e aseteve neto për kuotë 2018	Vlera e aseteve neto për kuotë 2019
Sigal	1,350	1,394	1,449
Raiffeisen	1,635	1,724	1,809
Credins Pension	1,354	1,406	1,475

Nga tabela e mësipërme mund të shihet se vlera e aseteve neto për kuotë për secilin nga fondet e pensionit ka pasur një tendencë në rritje. Në fund të vitit 2019 vlera e aseteve neto për kuotë e fondit të pensionit “Sigal” është rritur me 3.95% krahasuar me fundin e vitit 2018, kurse për fondin e pensionit vullnetar “Raiffeisen” dhe “Credins Pension” ky tregues është rritur respektivisht me 4.94% dhe 4.88%.

Asetet e këtij tregu në vlerën 2.92 miliardë lekë janë investuar kryesisht në obligacione të qeverisë shqiptare, në masën 94.84% të totalit dhe janë rritur me 25.37% krahasuar me fundvitin 2018. Pjesa

tjetër e aseteve e këtij tregu konsiston në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare dhe në llogari të arkëtueshme.

Tabelë 24: Struktura e aseteve të tregut të fondeve të pensionit vullnetar gjatë tre viteve të fundit

<i>Përshkrimi</i>	<i>Vlera (mln. lekë)</i>		
Periudha	31.12.'17	31.12.'18	31.12.'19
Asetet neto të fondeve të pensionit	1727.54	2,289.10	2,910.44
Totali i aseteve të fondeve	1732.94	2,303.26	2,921.48
<i>nga të cilët:</i>			
Mjete Monetare dhe Ekuivalentë të Mjeteve Monetare	58.44	47.73	91.86
Obligacione Thesari të RSH	1,641.76	2,210.16	2,770.77
Depozita bankare	0.00	0.00	0.00
Asete të tjera	32.74	45.37	58.84
Totali i Detyrimeve të Fondeve	5.4	14.16	11.03

Tabelë 25: Ndryshimi i strukturës së aseteve të tregut të fondeve të pensionit vullnetar më 31.12.2019 krahasuar me 31.12.2018


<i>Përshkrimi</i>	<i>Vlera (Në mln. lekë)</i>		<i>Ndryshimi (Në %)</i>	<i>Pjesa ndaj totalit (Në %)</i>	
Periudha	31.12.2018	31.12.2019	31.12.'18- 31.12.'19	31.12.'18	31.12.'19
Asetet neto të fondeve të pensionit	2,289.10	2,904.07	26.87%		
Totali i aseteve të fondeve	2,303.26	2,921.48	26.84%	100	100
<i>nga të cilët:</i>					
Mjete Monetare dhe Ekuivalentë të Mjeteve Monetare	47.73	91.86	92.46%	2.07%	3.14%
Obligacione Thesari të RSH	2,210.16	2,770.77	25.37%	95.96%	94.84%
Depozita bankare	0.00	0.00	-	0.00%	0.00%
Asete të tjera	45.37	58.85	29.71%	1.97%	2.01%
Totali i Detyrimeve të Fondeve	14.16	17.41	22.92%	0.61%	0.60%

Gjatë vitit 2019, totali i investimeve të fondeve të pensionit ka qenë rreth 2.77 miliardë lekë dhe këto investime konsistojnë në obligacione të thesarit të Republikës së Shqipërisë (94.84% ndaj totalit të aseteve). Investimet e tregut të pensioneve kanë shënuar një rritje me 25.37% krahasuar me 31.12.2018.

Tabelë 26: Vlera e investimeve të tregut të fondeve të pensionit vullnetar (në mln. lekë)

<i>Përshkrimi</i>	<i>Vlera</i>		
<i>Periudha</i>	<i>2017</i>	<i>2018</i>	<i>2019</i>
Totali i investimeve të tregut të FP	1,641.76	2,210.16	2,770.77

Duke qenë se detyrimet e fondeve të pensionit vullnetar janë afatgjata pasi anëtarët mund të tërhiqen kur arrijnë moshën e pensionit, atëherë dhe politika e investimeve për të tre fondet e pensionit, të cilat operojnë në treg është afatgjatë duke mbartur në këtë mënyrë dhe riskun e tregut. Kështu kjo politikë e investimeve të fondeve të pensionit ka synuar në maturime 5, 7 dhe 10 vjeçare.


Grafik 26: Ndarja sipas maturimit të investimeve në fondet e pensionit vullnetar, 31.12.2019(Në %)

Në grafikun më sipër vihet re se pjesën më të madhe e zënë investimet në obligacione me afat maturimi 10 vjeçar në masën 61.3%. Ky fakt tregon se fondet e pensionit vullnetar synojnë të ndërtojnë një portofol të përbërë kryesisht nga letra me vlerë afatgjatë.

Tabelë 27: Numri i anëtarëve sipas fondeve të pensionit vullnetar


<i>Përshkrimi</i>	<i>Numri i anëtarëve në FP</i>			<i>Ndryshimi (në %)</i>	
<i>Periudha</i>	<i>2017</i>	<i>2018</i>	<i>2019</i>	<i>31.12.'17-31.12.'18</i>	<i>31.12.'18-31.12.'19</i>
Sigal	6,066	7,067	8,084	16.50%	14.39%
Raiffeisen	2,800	2,911	3,052	3.96%	4.84%
Credins Pension	12,081	15,320	17,137	26.81%	11.86%
Total	20,947	25,298	28,273	20.77%	11.76%

Siç shihet në tabelë, numri i anëtarëve në fondet e pensionit vullnetar ka ardhur duke u rritur.

Grafik 27: Ndarja e tregut sipas numrit të anëtarëve në fondet e pensionit vullnetar më 31.12.2019 (Në %)

Në fund të vitit 2019, ishin 16,499 anëtarë të tregut të fondeve të pensionit vullnetar që janë përfshirë në planet individuale të pensionit vullnetar, ndërsa 11,774 anëtarë janë përfshirë në planet profesionale të pensionit vullnetar të krijuara nga punëdhënësit për punonjësit e tyre.

Në grafikun më poshtë është paraqitur ndarja e anëtarëve të tregut të fondeve të pensionit vullnetar sipas planeve të pensionit për fundvitin 2019, ku 58.36% e anëtarëve të këtij tregu bëjnë pjesë në planet individuale të pensionit, kurse 41.64% e tyre bëjnë pjesë në planet profesionale të pensionit.

Grafik 28: Ndarja e anëtarëve të tregut të fondeve të pensionit vullnetar sipas planeve të pensionit më 31.12.2019, (Në %)

Pjesa më e madhe e anëtarëve të fondeve të pensionit vullnetar “Sigal” dhe “Raiffeisen” janë përfshirë në planet profesionale të pensionit përkatësisht 77.25% dhe 70.25%, ndërsa 80.25% e anëtarëve të fondit të pensionit vullnetar “Credins Pension” janë përfshirë në planet individuale të pensionit.

Tabelë 28: Ndarja e anëtarëve të fondeve të pensionit vullnetar sipas planeve të pensionit më 31.12.2019

<i>Fond Pensioni</i>	<i>Numri i anëtarëve në planet individuale të pensionit</i>	<i>Numri i anëtarëve në planet profesionale të pensionit</i>
Sigal	1,839	6,245
Raiffeisen	908	2,144
Credins Pension	13,752	3,385
Total	16,499	11,774

3.3. Mbikëqyrja dhe Analiza e Rreziqeve të Tregut

Parimet e qeverisjes së mirë dhe menaxhimit të rreziqeve janë pjesë e zbatimit të metodologjisë së re mbikëqyrëse për fondet e pensioneve vullnetare, asaj me bazë rreziku, e cila u hartua dhe u miratua në vitin 2016. Nëpërmjet kësaj metodologjie evidentohen rreziqet më të mëdha që prekin këtë treg dhe njëkohësisht strategjitë që duhen ndjekur për zbutjen e tyre në një nivel të pranueshëm.

Metodologjia me bazë rrezikun, me qëllim zhvillimin e një procesi të shëndoshë për gjykimin e vlerësimit të rrezikut, ka parashikuar gjithashtu ngritjen e Komitetit të Rrezikut për Fondet e Pensionit, i cili ka filluar aktivitetin e tij në vitin 2016 me miratimin e Metodologjisë së re mbikëqyrëse.

Gjatë mbledhjeve të Komitetit të Rrezikut në vitin 2019 janë prezantuar matricat e rrezikut të pranishëm dhe rrezikut të mbetur në sistem dhe u dakordësua vlerësimi i këtyre rreziqeve, duke identifikuar rreziqet që kërkojnë ndërhyrje më të shpejtë në sistem. Kështu, si rreziku më i madh në kushtet e Shqipërisë u identifikua pjesëmarrja e ulët e kontribuesve në sistem, gjë që ka lidhje edhe me rritjen e besueshmërisë në sistem. Komiteti i Rrezikut, duke pasur si objektiv zbutjen e rreziqeve, miraton planin e mbikëqyrjes për një periudhë afatmesme për tregun e fondeve të pensionit.

3.4. Inspektime

Në kuadrin e metodologjisë mbikëqyrëse me bazë rrezikun, gjatë vitit 2019 u kryen inspektime në vend pranë njërës prej njësive të depozitarëve të fondeve të pensionit vullnetar si dhe pranë njërës prej shoqërive administruese të këtyre fondeve. Objektivi i këtyre inspektimeve ishte vlerësimi i nivelit të rreziqeve mbështetur në parimet me të cilat duhet të përputhet aktiviteti i tyre, verifikimi i zbatimit të bazës ligjore në fuqi gjatë ndjekjes së procedurave operationale në lidhje me fondet si dhe respektimi i kuadrit ligjor mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe masat kundër financimit të terrorizmit.

Qasja e ndjekur gjatë inspektimeve ishte shqyrtimi i dokumentacionit të kërkuar, zhvillimi i intervistave me personat përgjegjës si dhe verifikimi ose testimi në vend në lidhje me çështje të ndryshme. Pas përfundimit të inspektimit, mbi bazën e gjetjeve të identifikuara, u vlerësua përputhshmëria e aktivitetit të njësisë dhe shoqërisë administruese me parimet me të cilat duhet të përputhet aktiviteti i tyre. Nga gjetjet e këtij inspektimi AMF ka lënë rekomandimet përkatëse, për të cilat subjektet kanë punuar për t'i përmbushur.

3.5. Kuadri Ligjor dhe Rregullativ

Për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10 197, datë 10.12.2009 “Për Fondet e Pensionit Vullnetar”, gjatë vitit 2019, pati zhvillime të procedurave drejt miratimit të tij, si raporti i vlerësimit ndikimit të aktit (RIA), përditësimi i projektligjit me komentet e ministrive dhe institucioneve si edhe rishikimi i relacionit shpjegues e ridërgimi i tij në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, procedura këto standarde të miratimit të një akti ligjor.

Për vitin 2019, nuk pati akte të reja, ndërsa lidhur me amendimet e akteve ekzistuese të Autoritetit në lidhje me rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregut të pensioneve private suplementare vullnetare është Vendimi nr. 86, datë 26.4.2019 i Bordit i cili miratoi ndryshime në Manualin e Mbikëqyrjes me Bazë Rreziku të Fondeve Vullnetare të Pensionit nr. 146, datë 29.09.2016 dhe që konsistonte në përshtatjen e emërtesat e njësive të cituara në manual në përputhje me strukturën e AMF-së.

3.6. Masat Korrigjuese dhe Administrative

Legjislacioni që rregullon veprimtarinë e subjekteve financiare nën mbikëqyrjen e AMF-së si dhe ligji “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” parashikojnë masa korrigjuese dhe administrative me qëllim parandalimin, korrigjimin apo ndërprerjen e rrethanave e veprimeve që përbëjnë shkelje të dispozitave ligjore ose akteve të Autoritetit.

Autoriteti ka marrë një masë me vërejtje ndaj shoqërive administruese të fondit të pensionit në lidhje me mosraportimin në kohë të raportit të kontrollit të brendshëm dhe të auditorit të jashtëm së bashku me letrën për drejtim.

Kapitulli 4

MBROJTJA E KONSUMATORIT DHE TRANSPARENCA

4.1. Mbrojtja e konsumatorit dhe investitorit

Mbrojtja e konsumatorit dhe investitorit është një nga objektivat kryesore të punës së AMF-së. Gjatë vitit 2019, AMF u përqendrua tek trajtimi i ankesave të investitorëve apo personave të siguruar të paraqitur në AMF si edhe në monitorimin e veprimtarisë së subjekteve të mbikëqyrura për të siguruar që veprimtaria e tyre promocionale dhe produkteve që ofrohen në treg është në përshatje të interesave të konsumatorit.

Për herë të parë, në shkurt 2019, filloi zbatimi i regjistrimit të ri si platformë e depozitimit *online* të ankesave të konsumatorëve, e cili bën të mundur depozitimin e ankesave dhe ndjekjen e ecurisë së tyre nëpërmjet faqes *online* të AMF duke e pajisur ankimuesin me një kod unik.

Shqyrtimi dhe trajtimi i ankesave të konsumatorëve dhe investitorëve

Shqyrtimi i ankesave të konsumatorit/investitorit synon zgjidhjen në mënyrë profesionale, të paanshme e të shpejtë të ankesave të depozituara. Informacioni i marrë nga shqyrtimi i ankesave i jep AMF-së tregues mbi cilësinë e shërbimeve të ofruara nga subjektet nën mbikëqyrje për konsumatorët e investitorët. Këto të dhëna i shërbejnë institucionit të ndërhyjë në kohë në përmirësimin e politikave dhe proceseve të punës së subjekteve të mbikëqyrura më qëllim parandalimin e sjelljeve jo korrekte ndaj konsumatorit/investitorit.

Gjatë vitit 2019, në Autoritet janë depozituar gjithsej 94 ankesa, nga të cilat 59 raste janë trajtuar më tej me shoqëritë dhe klientët, ndërsa 35 raste janë konstatuar se nuk qëndrojnë, pasi nuk ka pasur shkelje nga ana e shoqërive të sigurimit. Duke iu referuar të dhënave të pasqyruara në regjistrin e ankesave, gjatë vitit 2019 ka përfunduar trajtimi për 98 % të ankesave të depozituara.

Pjesa më e madhe e ankesave, 55 raste, lidhen me problematika të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit i cili përbën edhe portofolin kryesor të tregut të sigurimeve, me pretendimin e mostrajtimimit brenda afateve të praktikave të dëmit, shumën e kompensimit apo edhe mosmarrëveshje/paqartësi lidhur me shkaktarin e aksidentit. AMF i ka trajtuar këto duke evidentuar shkaqet e vonesave, paqartësive dhe vlerësimit të respektimit të procedurave të vlerësimit të dëmit, duke ndihmuar në zgjidhjen e shpejtë të tyre. Më 1 korrik 2019 hynë në fuqi ndryshimet në rregullorja nr. 53 “Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit” e cila ripërcaktoi rregullat dhe procedurat e trajtimit të dëmeve në sektorin e transportit.

Për arsye të dy ngjarjeve të tërmetit, shtator dhe nëntor 2019, një numër i ankesave lidhej me sigurimin ndaj tërmetit. Deri në fund të vitit 2019 u depozituan 7 raste. Problematikat e tjera të ankesave lidheshin me dëmshpërblim nga sigurimi Kasko, për dëme të Fondit të Kompensimit, sigurimeve inxhinierike, shëndeti në udhëtim, etj.

Sa i përket ankesave të trajtuara në numrin e përgjithshëm të ankesave, por që iu është dhënë përgjigje refuzuese nga Autoriteti, përfshihen refuzimet për arsye se: (i) nuk janë evidentuar shkelje të legjislacionit në fuqi nga shoqëritë e sigurimit; (ii) trajtimi i çështjeve në fjalë ka qenë jashtë juridiksionit të AMF-së; (iii) nuk ka vijuar trajtimi për arsye të mungesës së të dhënave minimale të nevojshme për AMF për identifikimin e shqyrtimin e rasteve.

Monitorimi i zbatimit të legjislacionit në fuqi

Gjatë vitit 2019, me qëllim që të sigurohet që veprimtaria promociionale rreth subjekteve të mbikëqyrura dhe produktet që ofrohen në treg përmbajnë të dhëna të qarta, të vërteta dhe të plota, Autoriteti ka shqyrtuar e verifikuar përputhshmërinë ligjore për 2 materiale promociionale dhe kushte të kontratave për 6 produkte sigurimi. Gjithashtu, në funksion të mbrojtjes konsumatore janë kryer edhe inspektive në vend në shoqëri brokerimi në tregun e sigurimit, shoqëri sigurimesh dhe pranë BSHS.

Rritja e nivelit të informacionit të disponueshëm për publikun

Gjatë gjithë vitit 2019, në zbatim të nenit 66, të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit”, janë kryer monitorime periodike mujore të faqeve zyrtare të shoqërive të sigurimit, për monitorimin e përmbushjes të detyrimit për informim. Pas verifikimeve dhe komunikimeve të vazhdueshme me shoqëritë e sigurimit, situata e informacionit të detyrueshëm për t’u publikuar në fund të vitit paraqitet e përmbushur sipas detyrimeve ligjore.

4.2. Edukimi Financiar

Në kuadër të përmbushjes së misionit së tij, Autoriteti e vlerëson si një nga përparësitë kryesore informimin dhe edukimin e vazhdueshëm të investitorit dhe konsumatorit, për përfshirjen e tij në tregjet financiare. AMF e vlerëson edukimin financiar si një proces mjaft të rëndësishëm edhe për rritjen e besimit të konsumatorit në tregjet financiare në përgjithësi dhe ato nën mbikëqyrjen e Autoritetit, në veçanti.

Tregu financiar karakterizohet nga zhvillim i shpejtë, ku qasja ndaj shërbimeve financiare bëhet më e lehtë, ndërkohë që rreziqet e tregjeve financiare transferohen tek qytetarët. Duke iu përshtatur këtyre tendencave, zhvillimi i kulturës financiare, nëpërmjet edukimit financiar, shihet nga Autoriteti si aftësi jetësore kyçe që individët dhe konsumatorët e produkteve financiare duhet të zotërojnë. Në këtë këndvështrim, edhe gjatë vitit 2019, në fokus kanë qenë aktivitetet në zbatim të Strategjisë “Për rritjen e besimit të konsumatorit/investitorit në tregjet nën mbikëqyrje (2017–2020)”. Ndër aktivitetet kryesore mund të rendisim:

- Stafi i Autoritetit ka vijuar të jetë i pranishëm në universitete të ndryshme publike dhe private, si edhe në shkollat e mesme profesionale në qytetet Tiranë, Durrës dhe Shkodër, duke zhvilluar takime dhe organizuar orë të hapura mësimore. Këto takime dhe leksione të hapura kanë zgjeruar më tej grupet e interesuara për informacione financiare dhe zhvillimet

e tregjeve që mbikëqyr Autoriteti dhe janë përmbyllur me nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me këto institucione arsimore;

- Më 24 maj 2019 u zhvillua për të dytin vit radhazi Konferenca e AMF-së “Edukimi Financiar”, ku morën pjesë studentë dhe staf akademik nga universitete publike dhe private në vend, të cilët kontribuan me punimet e tyre, për çështje të lidhura me tregjet nën mbikëqyrjen e Autoritetit;
- Autoriteti koordinoi dhe mundësoi kryerjen e praktikave mësimore për rreth 150 studentë, si në Autoritet, ashtu edhe në subjektet nën mbikëqyrjen e tij;
- Pesë trajnime të formimit profesional u organizuan për profesionistët, të cilët dëshirojnë të ushtrojnë veprimtarinë e tyre në tregjet nën mbikëqyrjen e Autoritetit;
- Në javën e parë të muajit tetor, Autoriteti, në bashkëpunim me shoqatat profesionale dhe aktorët kryesorë në tregjeve në vend, zhvilloi “Javën e Investitorit”. Ky aktivitet ishte në kuadër të nismës së Organizatës Ndërkombëtare të Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO), si një javë sensibilizimi për rritjen e edukimit financiar në tregun e kapitaleve dhe fondeve. AMF, si anëtare e kësaj organizate, ju bashkua nismës me qëllimin kryesor të shpërndajë mesazhet kryesore për edukimit financiar dhe mbrojtjen e investitorëve, si dhe të ofrojë sa më shumë informacion për investitorët aktualë dhe ata potencialë.

Sipas rekomandimeve të KLSH-së dhe Rezolutës së Kuvendit, Autoriteti propozoi ngritjen e grupit ndërinstitucional për hartimin e strategjisë kombëtare për “Edukim Financiar”, në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrinë e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin.

Autoriteti miratoi përfshirjen e një grupi studentësh të ekselencës për të bashkëpunuar me stafin e AMF-së për realizimin e projektit të titulluar “Vlerësimi i njohurive dhe krijimi i udhëzuesve për edukimin financiar për tregjet financiare jobankare”, të cilët punuan për hartimin e një pyetësoi për t’u shpërndarë në të gjithë grupet e popullatës, mbi perceptimin e njohurive të shërbimeve që ofrojnë tregjet nën mbikëqyrje. Me qëllim informimin dhe edukimin e konsumatorëve, AMF hartoi dhe publikoi në faqen *online* disa broshura informuese “Sigurimi i Jetës”, “Sigurimi i detyrueshëm i mjetit motorik në sektorin e transportit”, “Sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme civile” dhe “Ankimi”.

4.3. Transparenca dhe Marrëdhëniet me Publikun

Aktiviteti mbikëqyrës dhe rregullator i AMF-së dhe zhvillimet e tregjeve financiare jobankare janë pasqyruar gjerësisht si në median tradicionale ashtu edhe në mediat e reja. Komunikimi publik ka synuar si publikun e gjerë ashtu edhe grupet e veçanta të interesit, duke vijuar zbatimin e iniciative dhe aktiviteteve të Strategjisë “Për rritjen e besimit të konsumatorit/investitorit për tregjet nën mbikëqyrje”. Informacioni i përcjellë në media dhe te publiku ka pasur objektiv krahas rritjes së transparencës institucionale edhe edukimin financiar e ndërgjegjësimin e publikut për rolin e Autoritetit në mbrojtje të konsumatorit.

Mediat kanë publikuar informacione lidhur me tregun e sigurimeve dhe zhvillimeve në këtë treg, duke i dedikuar pjesën më të madhe të mbulimit si nga mediat tradicionale dhe ato të reja, e rrjetet sociale. Tematikat e pasqyrimin lidheshin si me sigurimin e detyrueshëm motorik, ashtu edhe sigurimin e


pronës, sidomos nga faktorët natyrorë. AMF në bashkëpunim me Shoqatën e Siguruesve të Shqipërisë ka bërë një fushatë të gjerë ndërgjegjësimi për sigurimin e pronës dhe kjo i ka dhënë efektet e saj në pasqyrimin mediatik. Edhe tematikat e lidhur me mbrojtjen e konsumatorit në sigurime dhe përdorimi i faqes *online* të AMF-së për të gjetur informacione, apo paraqitur ankimet e konsumatorëve kanë qenë të pranishme në media.

Tematika e pasqyruar gjerësisht në media lidhet me format e reja të investimeve, platformat e tregtimit *online*, si edhe investimet në monedhat virtuale. Po kështu zhvillimi i tregut të kapitalit në vend, sidomos pas fillimit të aktivitetit të Bursës ALSE kanë qenë në vëmendjen e medias duke bërë prezentë te publiku mundësitë e investimit. Autoriteti ka vijuar publikimin e informacioneve - të ardhura edhe nga institucionet ndërkombëtare apo vendet partnere.

Media mbuloi gjerësisht Konferencën II “Edukimi Financiar” në maj 2019 si me kronika informative, edhe nëpërmjet programe më të zgjeruara televizive informative. AMF organizoi një emision televiziv në rubrikën “Auditor Arsimi” në Televizionin Publik Shqiptar. Diskutimi televiziv, me pjesëmarrjen e studentëve të pranishëm me punime në konferencë, i shërbeu si shtrirjes më të gjerë të informacioneve për tregjet financiare, ashtu edhe për të ndërgjegjësuar për rolin e tyre si përhapës të zhvillimit në tregjet financiare.

Autoriteti ka zgjeruar edhe komunikimin në rrjetet sociale, si në faqen zyrtare në Facebook ashtu dhe në faqen zyrtare *online*. Gjatë vitit 2019, postimet në faqen e Autoritetit në Facebook kanë marrë mesatarisht mbi 110 klikime për çdo postim duke përfshirë edhe shpërndarjet e këtyre informacioneve në faqet individuale të ndjekësve, ashtu edhe pëlqimet e tyre. Komunikimi përmes faqes AMF në Facebook, ndiqet nga grupmosha 18-44 vjeç. Postimet e ndryshme të AMF-së kanë arritur rreth 115 mijë ndjekës. Shpërndarja gjeografike e ndjekësve të faqes, është kryesisht nga Tirana, por në shifra të vogla ka edhe ndjekës nga Italia, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Greqia, Gjermania, Kosova, etj.

Grafik 29: Struktura e klikimeve në faqen *online* të AMF-së, 2019 (Në %)




Edhe gjatë vitit 2019, tendenca rritëse e numrit të klikimeve në faqen zyrtare *online* të AMF-së ka ecur në të njëjtin ritëm me zhvillimet e tanishme të medias në vend, ku komunikimet dixhitale po

zëvendësojnë gjithnjë e më shumë komunikimet me mediat tradicionale, duke u shndërruar në formën prioritarë të komunikimit. Sipas informacioneve të publikuara në faqen *online*, pjesa më e madhe e përdoruesve kërkojnë lajmet, informacionet lidhur me kuadrin ligjor, vendimet e miratuara nga Bordi i AMF-së, të dhënat statistikore. Rreth 28% e klikimeve në faqen *online* janë kryer në seksionin e Qendrës Kombëtare të të Dhënave të sigurimit të Detyrueshëm Motorik, duke dëshmuar se faqja *online* është mjaft aktive dhe e përdorshme nga drejtuesit e mjeteve dhe shoqëritë e sigurimit, për të verifikuar policat e sigurimit.

Faqja *online* ka edhe seksionin në gjuhën angleze, duke u shërbyer edhe investitorëve apo analistëve të huaj si burim informacioni për strukturën dhe zhvillimin e tregjeve financiare të sigurimeve, pensione private vullnetare dhe letrave me vlerë në Shqipëri. Faqja vizitohet edhe nga vizitorë jashtë vendit dhe pjesa më e madhe e tyre janë nga vende si SHBA, Itali, Kosovë, Angli, etj. Gjatë vitit 2019, faqja *online* www.amf.gov.al është vizituar 578,222 herë dhe mbi 75% e vizitorëve janë vizitor të rinj në faqen e AMF-së.

Grafik 30: Pasqyrimi mediatik për tregjet financiare jobankare dhe AMF, 2017-2019 (Në numër)



Kapitulli 5

BASHKËPUNIMI INSTITUCIONAL DHE PROJEKTET

5.1. Bashkëpunimi me institucionet e vendit

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka një rol të rëndësishëm për zhvillimin dhe ruajtjen e stabilitetit të qëndrueshëm financiar të vendit. Bashkëpunimi i rregullatorëve të ndryshëm ekonomikë dhe financiarë është konsideruar mjaft i rëndësishëm për ecurinë e tregjeve financiare. Për t'i shërbyer këtij bashkëpunimi edhe gjatë vitit 2019 janë thelluar marrëdhëniet me institucionet më të rëndësishme financiare në vend apo institucione e grupe të tjera interesi, veprimtaria e të cilëve lidhet direkt ose indirekt me aktivitetin mbikëqyrës apo rregullator.

5.2. Bashkëpunimi Rajonal dhe Ndërkombëtar

AMF është anëtare e Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS), që prej vitit 2001. Themeluar në vitin 1994, IAIS përfaqëson rregullatorët dhe mbikëqyrësit e më shumë se 200 juridiksioneve në rreth 140 vende. Objektivat e saj janë mbikëqyrja sa më efektive e industrisë së sigurimeve për zhvillimin dhe ruajtjen e tregjeve, mbrojtjen e të siguruarit, si dhe duke kontribuar në stabilitetin financiar global. Ky anëtarësim ka ndihmuar në thellimin e bashkëpunimit ndërkombëtar midis autoriteteve për mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve. Gjatë vitit 2019, AMF vazhdoi pjesëmarrjen, në mënyrë aktive, në takimet e nivelit të lartë, Mbledhjet e Përgjithshme Vjetore, si dhe në mbledhjet e Komiteteve Teknike dhe Ekzekutive të kësaj organizate.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare merr pjesë rregullisht në mbledhjet vjetore të Komiteteve të IAIS-it. Në shkurt 2019 u zhvillua mbledhja vjetore e Komiteteve të IAIS-it në Bazel, Zvicër, ku dhe AMF mori pjesë. Në këtë mbledhje u diskutuan çështje për rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregjeve të sigurimeve. Në kuadër të intensifikimit të marrëdhënieve me vendet anëtare, në maj, AMF inicioi procesin për nënshkrimin e MMoU-së me IAIS, në kuadër të programit të transparencës dhe shkëmbimit të informacionit. Ky proces filloi me vlerësimin e paketës ligjore mbikëqyrëse me fokus finalizimin e procesit të nënshkrimit të MMoU-së.

Me ftesë të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Maqedonisë (ISA), në shtator, AMF mori pjesë në seminarin e organizuar nga Instituti për Stabilitetin Financiar (ISF) në bashkëpunim me Shoqatën Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS). Në këtë Seminar dyditor u trajtuan temat që lidhen me mbikëqyrjen e grupeve, sjelljen e biznesit dhe digjitalizimin.

Në muajin nëntor AMF ishte pjesëmarrëse në mbledhjen e Komiteteve Teknike dhe Ekzekutive, si dhe në Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore organizuar nga Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS) dhe në konferencën vjetore me titull “Mbikëqyrja në epokën digjitale” u diskutuan çështjet që lidhen me sfidat e zhvillimeve të vrullshme teknologjike me të cilat përballen rregullatorët në mbarë botën.

Veprimtaritë kryesore në kuadër të bashkëpunimit me Organizatën Ndërkombëtare të Komisioneve të Letrave me Vlerë, (IOSCO)

AMF është anëtare me të drejta të plota në Organizatën Ndërkombëtare të Komisioneve të Letrave me Vlerë, (IOSCO) dhe njëkohësisht nënshkruese e Memorandumit Shumëpalësh të IOSCO-s që prej vitit 2009. Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë është organizmi ndërkombëtar që mbledh së bashku rreth 95% të rregullatorëve të letrave me vlerë në gjithë botën dhe njihet si hartues i standardeve globale për sektorin e letrave me vlerë. IOSCO zhvillon, zbaton dhe promovon respektimin e standardeve të njohura ndërkombëtare për rregullimin e letrave me vlerë.

AMF ka qenë e angazhuar në plotësimin e të gjithë detyrimeve që rrjedhin nga pjesëmarrja në këtë organizatë dhe vazhdon të plotësojë kuadrin rregullator, me qëllim përafrimin me standardet e parimet e IOSCO-s. AMF është gjithashtu pjesëmarrëse aktive në Komitetin Rajonal të Evropës të IOSCO-s, *European Regional Committee* (ERC) dhe anëtare e Komitetit të Tregjeve në Rritje e Zhvillim, *Groëth and Emerging Markets Committee* (GEMC).

Në muajin maj 2019, drejtues të lartë të Autoritetit ishin të pranishëm në Takimin e 44-të Vjetor të zhvilluar nga Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO) në bashkëpunim me Komisionin e Letrave me Vlerë dhe Investimeve të Australisë (ASIC). Takimi, u organizua nga Komisioni Australian i Letrave me Vlerë dhe Investimeve (ASIC) ku morën pjesë rreth 350 anëtarë të IOSCO-s. Takimi vjetor përfshinte takime të Bordit të IOSCO-s, Komitetit të Tregjeve në Rritje dhe Zhvillim të IOSCO-s (GEMC), Komitetit Rajonal të Evropës (ERC) dhe Komitetit Konsultativ të Anëtarëve (AMCC).

Gjithashtu, gjatë muajit maj, përfaqësues të AMF-së morën pjesë në projektin e asistencës teknike të IOSCO-s për zhvillimin e manualeve të zbatueshmërisë. Ky projekt u nda në 3 faza. Në këtë projekt morën pjesë anëtarët e përzgjedhur nga vendet e rajonit *European Regional Committee* (ERC) ku bëjnë pjesë: Shqipëria, Armenia, Republika e Azerbajxhanit, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Gjeorgjia, Lituania, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Republika e Serbisë, Ukraina dhe Uzbekistani.

Në shtator 2019, AMF mori pjesë në Mbledhjet e Komiteteve të IOSCO-s, në Mbledhjen e Komitetit Rajonal Evropian (ERC), në Mbledhjen Vjetore të Komitetit GEMC të IOSCO-s të organizuar nga Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Letrave me Vlerë, *International Organization of Securities Commission* (IOSCO), si edhe në Mbledhjen Vjetore dhe Konferencën e Komitetit për Tregjet në Rritje dhe Zhvillim (GEMC) e organizuar nga Banka Qendrore e Rusisë (CBR).

AMF mori pjesë në seminarin “Për AML/CFT në Tregun e Titujve”. Ky seminar u organizua në tetor nga IOSCO në bashkëpunim me Komisionin e Mbikëqyrjes të Sektorit Financiar, *Commission de Surveillance du Secteur Financier of Luxembourg*, (CSSF) dhe u mbajt në Luksemburg. Në këtë seminar u trajtuan çështjet e PPP/FT në tregun e titujve, si dhe diskutimet mbi udhëzuesin e fundit i publikuar nga FATF për këtë treg, tipologjitë e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Veprimtaritë kryesore në kuadër të bashkëpunimit me Organizatën Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Pensioneve (IOPS).

AMF është anëtare me të drejta të plota, si dhe pjesë aktive e strukturave të ndryshme të kësaj organizate që nga viti 2006. IOPS është organizatë e pavarur ndërkombëtare e krijuar në vitin 2004 me iniciativë të OECD-së dhe Rrjetit Ndërkombëtar të Rregullatorëve dhe Mbikëqyrësve të Pensioneve (INPRS), me qëllim përfaqësimin e interesave të enteve rregullatorë të pensioneve private. Forumi Global organizohet çdo vit në një nga shtetet anëtare të IOPS-it, ku në fokus të diskutimeve vendosen zhvillimet e fundit dhe sfidat me të cilat përballen rregullatorët dhe industria e fondeve të pensioneve private. IOPS organizon një sërë eventesh vjetore, duke përfshirë mbledhjet e komiteteve, seminarët rajonale dhe trajnimet (*workshopet*). Mbledhjet e Komitetit Ekzekutiv dhe Teknik zakonisht mbahen tre herë në vit, ndërsa Mbledhja e Përgjithshme Vjetore e IOPS-it zhvillohet një herë në vit.

Në mars, AMF mori pjesë në Mbledhjet e Komitetit Teknik dhe Ekzekutiv, si edhe në Konferencën Ndërkombëtare të IOPS/OECD mbi Pensionet Private: “Opsionet për krijimin e sistemeve të qëndrueshme për pensionet në tregjet emergjente”. Konferenca dhe Mbledhjet u organizuan nga Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Pensioneve (IOPS) në bashkëpunim me Autoritetin për Rregullimin dhe Zhvillimin e Fondeve të Pensioneve të Indisë (PFRDA).

AMF ishte pjesëmarrëse në Mbledhjen e qershorit të Komitetit Teknik IOPS/OECD, si edhe konferenca për kërkime në Fushën e Pensioneve dhe konferenca e Shoqatës Ndërkombëtare Kërkimore për Pensionet (IPRA). Temat e trajtuara gjatë Konferencës së IV-të Vjetore për Zhvillimet në Skemat e Pensioneve kishin të bënin me ndikimet në parashikimet e sëmundjeve dhe vdekshmërisë në lidhje me programet e pensioneve, mënyrat e sigurimit të pensionit nëpërmjet vetëpunësimit, zgjerimit të mbulimit të pensioneve tek punonjësit joformalë, si edhe faktorët që pengojnë ofrimin efektiv të të ardhurave nga pensionet, korrupsioni, kapaciteti i shtetit dhe ofrimi i “pastër” i të ardhurave të pensioneve.

Në muajin nëntor, AMF, në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Pensioneve, (IOPS) dhe Organizatën për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) organizuan për herë të parë Forumin Global për Pensionet Private. Në forumin më të madh për tregjet financiare të zhvilluar ndonjëherë në Shqipëri morën pjesë përfaqësues nga autoritetet rregullatore dhe mbikëqyrëse, ekspertë të nivelit të lartë nga industria e fondeve private të pensionit dhe vendet anëtare të të dyja organizatave OECD dhe IOPS. Gjithashtu u mbajtën edhe Mbledhjet e Komitetit Teknik dhe Ekzekutiv, si edhe Mbledhja e Përgjithshme Vjetore me vendet anëtare të IOPS-it ku u zhvilluan edhe zgjedhjet për kryesimin e IOPS-it.

Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (EIOPA)

Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (EIOPA) së bashku me dy organet e tjera Evropiane, Autoritetin Bankar Evropian dhe **Rregullatorin Evropian të Tregjeve dhe Letrave**

me Vlerë (ESMA) ndihmojnë në zbatimin e rregullave për institucionet financiare dhe në këtë mënyrë ruajnë stabilitetin e sistemit financiar të Evropës.

Në shtator 2019 AMF mori pjesë në Forumin e parë për Ballkanin Perëndimor mbi Mbikëqyrjen e Sigurimeve dhe në Konferencën e 6-të Globale për Mbikëqyrjen e Sigurimeve (GIS) i zhvilluar në bashkëpunim me Universitetin Goethe dhe Grupin e Bankës Botërore. Ky Forum u fokusua në sigurimin e qëndrueshëm, mbështetjen e sfidave globale, modelet e biznesit, mangësitë e kapacitetit mbrojtës dhe risqet sistemike. Në këtë Forum të rëndësishëm u shkëmbyen informacione mbi situatën e tregut të sigurimeve në rajon, çështjet kryesore të rregullimit dhe mbikëqyrjes dhe mundësitë e forcimit të bashkëpunimit midis vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Banka Botërore

Banka Botërore mbetet një partner i rëndësishëm strategjik që mbështet Autoritetin ndër vite, në përmbyllje të misionit themelor. Edhe gjatë vitit 2019, Banka Botërore vijoi të mbështesë Autoritetin në zbatimin e projektit të asistencës teknike “Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, i fokusuar në zhvillimin e tregut të kapitaleve”. Banka Botërore, nëpërmjet ekspertizës dhe ekspertëve të saj, ka ndjekur në vazhdimësi zhvillimin e këtij projekti të rëndësishëm, i cili është i financuar nga Sekretariati Shtetëror për Çështjet Ekonomike Zvicerane (SECO) përmes Grantit (*Trust Fund Grant*).

Bashkëpunimi me autoritete homologe në BE

Gjatë vitit 2019, Autoriteti ka pasur në vëmendje zgjerimin dhe forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve dypalëshe dhe shumëpalëshe me autoritetet homologe, duke marrë pjesë në takimet apo veprimtaritë e organizuara për njohjen dhe përditësimin me tendencat më të fundit mbikëqyrëse dhe rregullatore, si dhe shkëmbimin e përvojave të ndërsjella.

Autoriteti i Tregjeve Financiare të Austrisë (FMA)

Një partner mjaft i rëndësishëm i AMF-së në zhvillimin e tregjeve financiare nën mbikëqyrje prej vitesh është Autoriteti i Tregjeve Financiare të Austrisë (FMA). Bashkëpunimi me FMA-në është konsoliduar ndër vite dhe materializuar me takime të shpeshta të drejtuesve të lartë të institucioneve dhe stafit teknik. Prej vitit 2009, të dyja institucionet kanë nënshkruar një marrëveshje mirëkuptimi, pas investimeve të grupeve austriake të sigurimeve në Shqipëri, duke u konkretizuar me shkëmbim përvojë dhe punë të përbashkët në mbikëqyrjen e grupeve austriake që operojnë në Shqipëri.

AMF është pjesëmarrëse e rregullt e kolegjeve mbikëqyrëse të “UNIQA Insurance Group” (UIG) dhe Vienna Insurance Group (VIG). Ekspertët e departamentit të mbikëqyrjes të AMF-së, si çdo vit, edhe në vitin 2019 morën pjesë në mbledhjet dy ditore të Kolegjit të Mbikëqyrjes të Grupit UIG dhe VIG organizuar nga Autoriteti Austriak i Tregut Financiar (FMA) gjatë muajit mars. Të gjitha çështjet kryesore nga raportimet u përmbledhën në një material nga përfaqësuesit e Autoritetit Austriak të Tregut Financiar, si një analizë përmbledhëse nga Kolegji për tu ndarë me Grupin UNIQA. Ndërsa gjatë takimeve me Grupin VIG pati diskutime dhe pyetje drejtuar menaxhimit të Grupit VIG mbi

problematikat e hasura nga autoritetet mbikëqyrëse gjatë inspektimeve *on-site* dhe *off-site* në shoqëritë e grupit VIG në nivel lokal. Në përfundim të kolegjit u prezantuan përmirësimet dhe pritshmëritë nga zhvillimi i mbledhjeve të Kolegjit të Mbikëqyrjes për Grupin e Sigurimit Vienna Insurance Group (VIG), si dhe gjetjet kryesore nga inspektimet *on-site* dhe *off-site* të kryera nga FMA.

Në muajin tetor, me ftesë të Autoritetit Mbikëqyrjes së Tregjeve Financiare të Austrisë (FMA), AMF mori pjesë në Konferencën me temë “Tendencat e reja të Sigurimit dhe ndikimi i tyre në Rajonin e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore.” Kjo konferencë u organizua në kontekstin e zhvillimeve të Tregjeve Financiare duke bashkuar përfaqësuesit e shoqatave të sigurimit si dhe mbikëqyrësit e sigurimeve. Diskutimet e kësaj konference u fokusuan në çështjet që lidhen me ndryshimet klimaterike, produktet inovative, të cilat po zhvillohen në funksion të këtyre ndryshimeve, qeverisjen e mirë të korporatës në një epokë digjitalizimi dhe ndryshimesh të modeleve të biznesit, mbi rreziqet e reja, çështjet kryesore rregullatore dhe mbikëqyrëse në rajon. Fokus i kësaj konference ishte edhe forcimi i kompetencave të konsumatorit sipas një rregullore të re të sjelljes dhe regjimit mbikëqyrës, mbi informacionin kontraktual në një policë sigurimi dhe mjetet që duhet të përdoren në mënyrë që informacioni në policë të bëhet sa më i qartë dhe i lexueshëm.

Në dhjetor, një grup nga Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, mori pjesë për herë të parë në një inspektim të përbashkët me Autoritetin e Mbikëqyrjes së Tregjeve Financiare të Austrisë (FMA) në Vjenë, pranë zyrave qendrore të UNIQA International AG në kuadër të një inspektimi të përbashkët me FMA.

Gjithashtu, në dhjetor, në kuadër të reciprocitetit, mbështetjes dhe përfitimit të praktikave më të mira, nisur nga situata aktuale e ngjarjeve të tërmetit dhe katastrofat natyrore u zhvillua një takim i strukturave të larta drejtuese të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) me përfaqësues të lartë në Autoritetin e Mbikëqyrjes së Tregjeve Financiare të Austrisë (FMA) për të diskutuar edhe rreth tematikave të mbajtura gjatë Forumit të Parë për Mbikëqyrjen e Sigurimeve të Ballkanit Perëndimor të EIOPA në Frankfurt, zhvillimet në tregjet, si dhe temat mbi mbikëqyrjen efikase.

Autoriteti Rregullator i Tregjeve Financiare të Francës (AMF)

Gjatë vitit 2019, një nga prioritetet e AMF-së ka qenë edhe bashkëpunimi me Autoritetin Rregullator të Tregjeve Financiare të Francës. me qëllim marrjen e eksperiencave më të mira për ndarjen e informacionit në drejtim të zbatueshmërisë, si edhe në drejtim të zhvillimeve më të fundit në tregjet e teknologjisë financiare (FinTech). Në këtë kuadër u zhvillua një takim dypalësh ndërmjet dy autoriteteve homologe për të diskutuar rreth tregjeve nën mbikëqyrje dhe shkëmbimin e informacionit në kuadër të aderimit të Shqipërisë në BE.

Bashkëpunimi Rajonal

Edhe në vitin 2019 ka vijuar bashkëpunimi me institucionet homologe të rajonit, nëpërmjet takimeve të përbashkëta pune, shkëmbimit të informacionit dhe eksperiencave në aspektin rregullator e mbikëqyrës, me synim rritjen e efektivitetit të mbikëqyrjes së tregjeve financiare jo bankare.

Takimi i Autoriteteve të tregut të Kapitalit të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor (WB6)

Në kuadër të bashkëpunimit midis vendeve të rajonit gjatë muajit qershor u organizua “Takimi i katërt i Grupit të punës për Tregun e Kapitalit, dhe Tregjet Financiare”, si pjesë e bashkëpunimit rajonal të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor i emërtuar WB6. Ky takim u organizua nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC). Synimi i grupit rajonal të punës për tregun e kapitalit ishte përparimi në kapitullin e tregjeve të kapitalit dhe strategjisë së përgjithshme të tregjeve financiare. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare është anëtar i këtij grupi pune për tregjet e kapitalit.

Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Sllovenisë (AZN)

Në kuadër të Memorandumit të Mirëkuptimit të nënshkruar ndërmjet Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve (AZN) për bashkëpunimin reciprok dhe shkëmbimin e informacionit për Mbikëqyrjen e Tregut të Sigurimeve, në muajin korrik, AMF mori pjesë në një takim të përbashkët me autoritetin homolog Slloven.

Në shtator 2019, AMF mori pjesë në Konferencën e 5-të Vjetore “*Back to Basics*” B2B. Kjo konferencë u organizua nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve të Sllovenisë (AZN). Në të u trajtuan sfidat e hershme me të cilat është përballur tregu i sigurimeve të cilat janë nënvleftësuar vitet e fundit në një periudhë kur tregu i sigurimeve është orientuar drejt digjitalizimit. Konferenca kishte në fokus parimet themelore të praktikave të marrjes në sigurim, ekuilibrin midis cilësisë, konkurrencës dhe limitet e digjitalizimit në sektorin e sigurimeve.

Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut (ISA)

AMF ka një bashkëpunim të ngushtë me Agjencinë e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut (ISA). Marrëveshja e Mirëkuptimit midis dy institucioneve, e cila është në fuqi që prej vitit 2010, ndikon pozitivisht në efikasitetin e mbikëqyrjes dhe rregullimit të industrisë së sigurimeve të dy vendeve, sidomos në kushtet e shtrirjes së veprimtarisë të shoqërive shqiptare të sigurimit në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi, me iniciativën e ISA dhe *XPRIMM Media*, në shkurt përfaqësues të AMF-së morën pjesë në Konferencën Rajonale për aktuarët në sigurime, e cila u mbajt në Shkup, si dhe në muajin korrik u zhvillua një takim pune i specialistëve të Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit të AMF-së me autoritetet homologe në Maqedoninë e Veriut për shkëmbim eksperiencash në fushën e TI-së.

AMF mori pjesë në Takimin Rajonal për Mbikëqyrjen e Grupeve. Ky takim u zhvillua në kuadër të zhvillimit të takimeve rajonale me Homologët e Maqedonisë së Veriut dhe Kosovës. Takimi u organizua nga ISA.

Gjithashtu, me ftesë të ISA-s, AMF mori pjesë në seminarin e organizuar nga Instituti për Stabilitetin Financiar (ISF) në bashkëpunim me Shoqatën Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS).

Banka Qendrore e Kosovës (BQK)

Bashkëpunimi i AMF-së me Bankën Qendrore të Kosovës (BQK) vijoi të forcohet edhe gjatë vitit 2019. Në kuadër të thellimit të bashkëpunimit midis dy autoriteteve, AMF mori pjesë në takimet e mëposhtme:

Në muajin mars, përfaqësues nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve morën pjesë në Kolegjin e Dytë të Grupit të Sigurimeve Eurosig të mbajtur në Shkup. Mbikëqyrja e grupeve bazohet në Udhëzimin Metodologjik “Mbi mbikëqyrjen e grupit të sigurimit”, miratuar në vitin 2018.

Në muajin korrik, në Prishtinë u zhvillua një takim pune midis specialistëve të Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit të AMF-së dhe specialistëve të TI-së së BQK-së ndërsa në muajin dhjetor një takim pune pranë zyrave të AMF-së, me pjesëmarrjen edhe të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut (ISA) mbi shoqëritë e sigurimit, të cilat e kanë shtrirë aktivitetin e tyre në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut.

Iniciativa Rajonale për mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve në rajonin e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore (CESEE ISI)

AMF është pjesëmarrëse aktive në nismën rajonale “Iniciativa Rajonale për mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve në rajonin e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore (CESEE ISI). Takimi i shtatëmbëdhjetë u zhvillua në maj, në Shkup, Maqedoninë e Veriut. Ky takim u organizua nga Iniciativa për Mbikëqyrjen e Sigurimeve për vendet e Evropës Juglindore, Qendrore e Lindore (CESEE ISI) në bashkëpunim me Agjencinë e Sigurimeve të Maqedonisë (ISA).

Takimi i tetëmbëdhjetë u organizua nga CESEE ISI në bashkëpunim me Bankën Kombëtare Çeke (CNB). Temat e diskutuara kishin në fokus: vlerësimin e kërkesave të kapitalit, mjetet analitike, mbikëqyrjen e veprimtarive ndërkufitare, transferimin e funksioneve, dilemat e mundshme dhe niveli i lejuar i aktiviteteve të jashtme, shkollimi financiar/aktivitetet e edukimit të organizuara nga mbikëqyrësit, kërkesat për IDD, kërkesat për trajnim profesional dhe zhvillim si dhe çështje që lidhen me licencimin.

5.3. Proceset integruese për tregjet nën mbikëqyrje

Roli i AMF-së në Integrimin Evropian

AMF ka bërë përpjekje pozitive për të harmonizuar legjislacionin e brendshëm të shërbimeve financiare me *acquis*. Legjislacioni aktual i Shqipërisë në fushën e shërbimeve financiare përbën një bazë të fortë për një harmonizim të mëtijshëm dhe të plotë me legjislacionin evropian. Në fushën e shërbimeve financiare jobankare është konsoliduar puna për rishikimin e kuadrit rregullator dhe mbikëqyrës, duke synuar përafrimin e mëtijshëm të tij me *acquis* e BE-së dhe është bërë progres në përafrimin e legjislacionit të tregut të sigurimeve, tregjeve të kapitalit dhe pensione private. AMF, si institucion kontribuues në këtë proces, ka punuar në përafrimin e kuadrit ligjor, gjë që nënvizohet edhe në Progres Raportin e fundit të KE-së.

Gjithashtu, AMF ka vazhduar të japë kontributin e saj në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga Raporti i KE-së dhe Planit Kombëtar i Integritimit Evropian. Ajo koordinon dhe përgatit raportimet në lidhje me kapitullin 9 “Shërbimet Financiare”, si dhe është kontribues në kapitujt kriteri ekonomik, kapitulli 2, kapitulli 3, kapitulli 4, kapitulli 6, kapitulli 17 dhe kapitulli 28.

AMF gjithashtu ka monitoruar rregullisht zbatimin e MSA-së, si dhe të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian. Ajo ka marrë pjesë në takimet e radhës së nënkomiteteve përkatëse, si dhe ka kryer raportime të suksesshme në kuadër të Integritimit Evropian, më konkretisht:

- Takimi i 11-të i Nënkomitetit Çështjet Ekonomike - Financiare & Statistikat - 3 tetor 2019;
- Takimi i 10-të i Nënkomitetit Tregu i Brendshëm dhe Konkurrenca duke përfshirë Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Shëndetit - 21 shkurt 2019.

Vlerësimi i palës evropiane gjatë këtyre raportimeve ishte pozitiv për veprimtarinë e AMF-së dhe rekomandimi i vetëm për AMF-në në Raportin e KE-së për Shqipërinë ishte miratimi i projektligjit “Për sigurimin e detyrueshëm motorik në sektorin e transportit”.

Gjatë vitit 2019, AMF ka vazhduar bashkëpunimin me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, si institucioni koordinues në procesin e integritimit evropian. AMF ka përgatitur raporte të cilat pasqyrojnë progresin e arritur duke kontribuar në hartimin e dokumenteve që lidhen me procesin e Stabilizim-Asociimit. AMF, gjatë vitit 2019, ka përcjellë në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme informacione periodike për monitorimin e realizimit të PKIE 2019-2021, si dhe ka punuar për hartimin e PKIE 2020-2022 për kapitullin 9 “Shërbimet Financiare” si një nga instrumentet kryesore për planifikimin dhe monitorimin e përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të BE-së, në procesin e integritimit evropian të Shqipërisë. Ndërkohë, AMF ka dhënë kontributin e saj për hartimin e PKIE 2020-2022 për të gjithë kapitujt ku është kontribues.

Janë përgatitur të dy kontributet për progresin e bërë nga institucioni ynë për raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2020 sipas pyetje të bëra nga ekspertët e KE-së. Edhe gjatë vitit 2019 Autoriteti në cilësinë e koordinatorit të kapitullit 9 “Shërbimet Financiare” ka zhvilluar takime të

GNPIE-së për kapitullin 9 “Shërbimet Financiare” duke përgatitur materialet përkatëse, si dhe ka marrë pjesë edhe në takimet e GNPIE-ve të kapitujve ku AMF është kontribues.

Procesi i takimeve shpjeguese (*explanatory screening*) të *acquis*, që u konkretizua nëpërmjet takimeve në Bruksel përgjatë vitit 2018-2019, është vetëm hapi i parë drejt hapjes së negociatave sipas kapitujve. Ky proces tashmë ka përfunduar dhe ka filluar hapi i dytë.

Hapi i dytë është takimi bilateral (*Bilateral Screening*) ku Komisioni Evropian (KE) i bën kërkesë Shqipërisë të shpjegojë pozicionin e saj kundrejt plotësimit të kërkesave të legjislacionit të BE-së nëpërmjet një plani të detajuar veprimi për përafrimin e legjislacionit. Ekspertët e institucioneve shqiptare duhet të bëjnë analizën e akteve të tyre ligjore sipas fushës dhe të thonë sa i kanë të përputhura me legjislacionin evropian dhe kur parashikojnë të bëjnë një përputhje të plotë.

Në kuadër të haptit të dytë, AMF duke u bazuar në Urdhrin e KM nr.94, datë.20.05.2019 “Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e GNP për integrimin evropian”, caktoi anëtarët për GNP për kapitullin 9 “Shërbimet Financiare” ku AMF është institucioni koordinator i këtij kapitulli, ndërsa institucione kontribuese për kapitullin 9 janë Banka e Shqipërisë (BSH), Instituti i Statistikave (INSTAT), Agjencia e Sigurimit të Depozitave (ASD) Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ), si dhe caktoi anëtarët e kapitujve ku AMF është kontribues. Lidhur me takimin bilateral janë realizuar tashmë këto hapa kyçe:

- Caktimi i institucioneve përgjegjëse për çdo kapitull (ky proces u krye nga MEPJ me miratim të Kryeministrit);
- Caktimi i institucioneve përgjegjëse për *acquis* e kapitullit 9;
- Caktimi i anëtarëve nga institucionet përgjegjëse për harmonizimin/zbatimin e *acquis* për kapitullin 9 dhe kapitujt ku AMF kontribuon (ky hap është realizuar me caktimin e anëtarëve nga institucionet sipas fushave përkatëse);
- Vlerësimi i mangësive ligjore për Kapitullin 9 dhe kapitujt ku AMF kontribuon;
- Hartimi i tabelave të përputhshmërisë për çdo *acquis* në kapitullin 9 dhe kapitujt ku AMF kontribuon;
- Përgatitja e tabelës së analizës së mangësive institucionale dhe administrative për kapitullin 9, si dhe për kapitujt e tjerë.

5.4. Projekte

Projekte me asistencë teknike të Bankës Botërore

Mbështetur nga Sekretariati i Shtetit Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO) Projekti “Përmirësimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare – BB/SECO - I: Fokus Zhvillimi i Tregut të Kapitaleve” (2016-2019)

Projekti “Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare: Fokusi tek zhvillimi i tregut të kapitaleve” synon të mbështesë AMF-në në forcimin e kapaciteteve të saj në

mbikëqyrjen e tregut të fondeve të investimeve dhe tregjet e obligacioneve të korporatave dhe atyre të qeverisë vendore. Ky projekt është mbështetur nga Banka Botërore, e cila ndjek edhe zbatimin e tij, ndërsa (SECO) është financues i këtij projekti përmes Grantit (*Trust Fund Grant*). Projekti ka filluar të zbatohet në muajin korrik 2016 dhe përfundoi në 31 mars të vitit 2019.

Projekti është i ndarë në tre faza zbatimi:

- Faza e parë: Zhvillimi i kapaciteteve mbikëqyrëse dhe rregulluese të AMF-së për sektorin e fondeve të investimeve / Vlerësimi i nevojave mbikëqyrëse të AMF-së në lidhje me zhvillimin e shpejtë të sektorit të fondeve të investimeve;
- Faza e dytë: Shqyrtimi dhe zhvillimi i legjislacionit dhe kuadrit mbikëqyrës për sektorin e fondeve të investimeve dhe tregun e obligacioneve;
- Faza e tretë: Zhvillimi i kapaciteteve të AMF-së të mbikëqyrë dhe rregullojë sektorin e fondeve të investimeve dhe tregun e bonove/ndërtimi i kapaciteteve.

Projekti “Përmirësimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare– BB/SECO - II:

“Fokus Zhvillimi i Tregut të Kapitaleve” (2019-2022)

Projekti “Përmirësimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare: Fokusi tek zhvillimi i tregut të kapitaleve” synon të mbështesë AMF-në në forcimin e kapaciteteve të saj në rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregut të kapitalit, si dhe të rrisë e zhvillojë tregun e kapitalit dhe produktet e tij përmes rritjes së vetëdijes dhe edukimit financiar dhe stimulimit të inovacionit financiar. Ky projekt është mbështetur nga Banka Botërore, e cila ndjek edhe zbatimin e tij, ndërsa Sekretariati i Shtetit Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO) është financues i këtij projekti përmes Grantit (*Trust Fund Grant*). Projekti, i cili vazhdon punën e nisur gjatë projektit të mëparshëm “Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare: Fokusi tek zhvillimi i tregut të kapitaleve” – BB/SECO -I, është aprovuar nga BB në 22.08.2019 dhe pritet të përfundojë më 31.12.2022. Projekti pritet të arrijë rezultatet që kanë të bëjnë me një kuadër më të forcuar rregullator dhe mbikëqyrës për tregjet e kapitalit me rritjen e aftësisë së AMF-së për të monitoruar dhe mbikëqyrur tregjet e kapitalit dhe me ndërgjegjësimin dhe edukimin financiar të pjesëmarrësve në treg.

“Fokus Zhvillimi i Tregut të Sigurimeve” (2019-2022)

Nëpërmjet alokimit të drejtpërdrejt të fondeve dhe ekspertizës së saj, Banka Botërore do të ndihmojë në forcimin e kornizës rregullatore dhe mbikëqyrëse të AMF-së për kompanitë e sigurimeve dhe promovimin e besimit të konsumatorit përmes stabilizimit dhe zhvillimit të tregut. Më konkretisht nëpërmjet asistencës teknike, Banka Botërore:

- Do të mbështesë AMF-në për të forcuar kapacitetin e saj të mbikëqyrjes së tregut të sigurimeve dhe të zbatimit të rregulloreve ekzistuese, nëpërmjet rishikimit të metodologjisë dhe analizës mbikëqyrëse të treguesve të rrezikut të sigurimit, si dhe ndërtimin e kapaciteteve, *workshop* për

stafin e AMF-së për vlerësimin dhe qëndrueshmërinë e modelit të biznesit të kompanive të sigurimeve;

- Do të mbështesë AMF-në duke përmirësuar kornizën dhe procedurat rregullatore të falimentimit dhe likuidimit të ndërmarrjeve të sigurimeve nëpërmjet analizimit të procedurave të falimentimit dhe likuidimit të kompanive të sigurimeve, si dhe rekomandimeve se si të përmirësohet korniza. Do të realizojë hartën e rrugës drejt zbatimit të regjimit të aftësisë paguese, bazuar në direktivën *Solvency II*, të përshtatshme për vendin tonë;
- Do të mbështesë iniciativën e AMF-së për rritjen e besimit të konsumatorit në sigurime duke rritur transparencën dhe përgjegjshmërinë e subjekteve të sigurimit të konsumatorët nëpërmjet ndihmës për zhvillimin dhe prezantimin e një sistemi të përcjelljes publike të cilësisë së shërbimit të siguriesve dhe performancës së kërkesë-ankesave.

Zbatimi i këtij projekti, aprovuar nga Banka Botërore në qershor 2019, i cili filloi zbatimin në shtator 2019 duke hartuar dhe planin zbatues me veprimet dhe hapat konkrete të grupit të punës në autoritet, pritet të përfundojë në dhjetor 2022 dhe do të ndihmojë AMF-në në përmirësimin e kapaciteteve të tij për mbikëqyrjen e sektorit të sigurimeve dhe rritjen e besimit të konsumatorit.

Forcimi i kapaciteteve të AMF-së si rregullator i sigurimeve dhe ulja e rreziqeve të sektorit të sigurimeve është e rëndësishme për ruajtjen e stabilitetit financiar dhe zhvillimin e mëtejshëm të sektorit financiar dhe tregut. Raporti i mbulimit të aftësisë paguese për tregun e sigurimeve është një tregues i rëndësishëm për shëndetin e sektorit të sigurimeve. Sipas strategjisë së saj, AMF synon të ndërmarrë masa për të siguruar stabilitetin afatgjatë të sektorit të sigurimeve. Përmes kësaj ndihme do të behet rishikimi i procedurave të falimentimit dhe likuidimit të kompanive të sigurimeve aktuale, ligjeve dhe rregulloreve përkatëse këshilla për azhurnimin e kornizës ligjore dhe rregullatore sipas nevojës, rregullimin e procedurave dhe zbatimin e tyre, si dhe ngritjes së kapaciteteve. Rishikimi pritet të sigurojë detaje mbi mekanizmat e mbrojtjes sikurse të vendosur në vendet e tjera evropiane.

Bazuar në strategjinë e AMF-së në lidhje me mbrojtjen e konsumatorit për të rritur transparencën, trajtimin e drejtë dhe për të rritur pjesëmarrjen në skemën e sigurimeve, ndihma do të konsistojë për të zhvilluar dhe prezantuar një sistem të ndjekjes publike të cilësisë së shërbimit të siguriesve dhe performancës së kërkesave. Kjo është planifikuar të arrihet duke ndërtuar një portal vlerësimi të performancës financiare dhe të kërkesave për të gjitha ndërmarrjet e sigurimeve, të cilat do të përmbajnë statistikën kryesore për regjistrimet e shërbimit të kërkesave të siguriesit dhe treguesit e performancës financiare. Do të përfshijë gjithashtu informacione themelore për mbrojtjen e konsumatorit, siç janë përmbledhjet e të drejtave të konsumatorit, procedurat e ankesave, analiza e raporteve të kërkesave të kompanive, klauzolat kryesore të kontratave të sigurimit, etj. AMF më tej do të sigurojë qëndrueshmërinë e portalit në të ardhmen.

AMF siguroi mbështetje me asistencë teknike nga Banka Botërore dhe po vijon bashkëpunimin me konsulentët dhe grupin e punës në Autoritet për hartimin e projektit teknik të ligjit për përballimin e situatave nga katastrofat natyrore sikurse tërmeti.

Projekti “Përmirësimi i cilësisë së raportimit financiar” (EU-REPARIS), me komponent “Përmirësimi i kapaciteteve të rregullatorëve financiarë në monitorimin dhe kontrollin e zbatimit më të mirë të raportimit financiar (EU-Fin Rep)” (2017-2019)

Në kuadër të projektit kombëtar “Përmirësimi i cilësisë së raportimit financiar (REPARIS), AMF ishte përfutues i komponentit “Përmirësimi i kapaciteteve të rregullatorëve financiarë në monitorimin dhe kontrollin e zbatimit më të mirë të raportimit financiar”. Ky komponent i projektit është financuar nga Sekretariati i Shtetit Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO), u administrua nga Banka Botërore dhe u ekzekutua nga Ministria Financave dhe Ekonomisë.

Fokus për AMF-në ishte unifikimi i konceptit të zbatimit të SNRF-ve sipas standardeve të BE-së dhe përmirësimi i kapaciteteve të autoritetit në monitorimin dhe kontrollin e tregjeve nën mbikëqyrje. Projekti në nivel komponenti kishte për qëllim përmirësimin e kapaciteteve për adoptimin e standardeve më të larta të BE-së në kuadër të SNRF-ve dhe të funksionit mbikëqyrës dhe rregullator të Autoritetit nëpërmjet përgatitjes së udhëzimeve të cilat ndihmojnë Autoritetin për vlerësimin e raporteve të auditit të jashtëm të shoqërive nën mbikëqyrje dhe për përmirësimin e praktikave të komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit me auditorët sipas modeleve të shteteve të tjera të zhvilluara.

Gjatë 2019 sikurse dhe 2018 është punuar me fazën e dytë konkretisht për përgatitjen e mjeteve për rishikimin e cilësisë së auditimit, trajnimeve përkatëse si dhe udhëzimet të cilat ndihmojnë Autoritetin për vlerësimin e raporteve të auditit të jashtëm të shoqërive nën mbikëqyrje.

Paralelisht është zbatuar edhe faza e tretë e komponentit të projektit në kuadër të komunikimit të rregullatorëve me auditorët ligjorë duke përpiluar një raport vlerësimi për nivelin e bashkëpunimit ndërmjet rregullatorëve dhe auditorëve, raport që jep rekomandime për përmirësimin e praktikave të komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit me auditorët sipas modeleve të shteteve të tjera. Me finalizimin e këtij komponenti në dhjetor 2019, fokus mbetet pjesëmarrja dhe angazhimi i AMF-së në projekte të ndryshme në të ardhmen.

Projekte me asistencë teknike të Korpusit Vullnetar të Shërbimeve Financiare – FSVC

AMF dhe FSVC kanë ndjekur planin vjetor të aktiviteteve të përbashkëta, për mbështetjen e tregut të sigurimeve dhe tregut të kapitalit, bazuar edhe në Memorandumin e Bashkëpunimit të nënshkruar në vitin 2018.

Në tregun e sigurimeve, FSVC mbështeti AMF për rritjen e kapaciteteve mbikëqyrëse për produktet e mikrosigurimeve. Asistenca teknike në këtë fushë mundësoi krijimin e profileve specifike të rrezikut për këto produkte, si edhe u ideuan mundësi përdorimi të kanaleve të reja për shpërndarjen dhe promovimin e mikrosigurimeve.

FSVC ndihmoi Autoritetin të bëjë një vlerësim të potencialit për rritjen e mbulimit të sigurimeve në sektorin bujqësor, i cili aktualisht është i pambuluar, dhe rekomandoi hapa për të lehtësuar ekzistencën e produkteve të përshtatshme të sigurimit në këtë industri.

II. ORGANIZIMI INSTITUCIONAL I AMF-së

II.1 Kuadri ligjor dhe rregullator i AMF-së

Gjatë vitit 2019, me qëllim përmirësimin e kuadrit të brendshëm rregullator të Autoritetit, e që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e tij, u miratuan këto akte të reja si edhe amendimet në aktet ekzistuese si më poshtë:

Rregullore nr. 170, datë 14.8.2019 “Për marrëdhëniet e punës të punonjësve në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, e cila shfuqizoi Rregulloren nr. 129, datë 26.11.2015 “Për marrëdhëniet e punës të punonjësve në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”.

Rregullore nr. 169, datë 14.8.2019 “Për organizimin, funksionimin dhe përshkrimin e detyrave” e cila doli në bazë të nenit 14, pika 7, të Ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, i ndryshuar dhe shfuqizoi rregulloren nr. 130, datë 31.8.2017 “Për organizimin, funksionimin dhe përshkrimin e detyrave”.

Rregullore nr. 227, datë 19.12.2019 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”. Rekomandimi për rishikimin e rregullores ekzistuese erdhi nga ILDKPKI, me qëllim përshtatjen e saj me të gjitha ndryshimet ligjore sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, apo të ndryshimeve të ligjit organik të institucionit. Rregullorja e re në pjesën më të madhe konsiston në plotësime të neneve përbërëse si dhe në përshtatjen me bazën ligjore dhe emërtesat. Për këtë është shfrytëzuar modeli i rregullores që ILDKPKI ka të publikuar në faqen zyrtare të saj si dhe udhëzimi (manuali) ndihmës i ILDKPKI për formën dhe përmbajtjen që rregullorja duhet të ketë.

Rregullore nr. 146, datë 24.07.2019 “Për administrimin e aktiveve në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”. Kjo rregullore u hartua në zbatim të pikës 8, të nenit 14, të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe shfuqizoi Rregulloren nr. 90, datë 18.7.2012 “Për rregullat e inventarizimit, vlerësimit dhe nxjerrjes nga përdorimi të aktiveve në zotërim të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare”. Rregullorja e re përcakton procedurat dhe përgjegjësitë për regjistrimin, kodim marrjen në dorëzim, lëvizjen, inventarizimin, amortizimin, vlerësimin, si dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve, që janë në pronësi ose në administrim nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Rregullore nr. 69, datë 27.3.2019 “Për miratimin e rregullores “Për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”. Kjo rregullore u hartua në zbatim të pikës 10, të nenit 13 të Ligjit nr.60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

Me Vendimin nr. 192, datë 14.10.2019, Autoriteti miratoi politikat e brendshme të sigurisë së Teknologjisë së Informacionit në AMF, në zbatim të nenit 14, pika 8, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar.

Me Vendimin nr. 211, datë 22.11.2019 u miratua Memorandumi i Mirëkuptimit në lidhje me bashkëpunimin reciprok për përgatitjen dhe shpërndarjen e informacionit në fushën e tregjeve financiare ndërmjet Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Qendrës për Emancipimin Ekonomik të Medias (UNECEM). Përgatitja dhe shpërndarja e një informacioni të përzgjedhur me kujdes dhe të rishkruar lehtësisht, të kuptueshëm për mediat dhe për qytetarin, për veprimtarinë e tregjeve financiare jobankare kryesisht: tregu i sigurimeve të Jetës dhe operatorët e tij; tregu i investimeve kolektive (fondet e investimit) dhe operatorët e tij, si dhe tregu i pensioneve private suplementare dhe operatorët e tij.

Me Vendimin e Bordit nr. 29, datë 4.3.2019 u miratua ndryshime në Rregulloren nr. 17, datë 8.4.2015 "Për funksionimin dhe mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes së bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare". U përfshinë në strukturën e relacionit të projektaktit, pikërisht ato standarde që janë pjesë e punës për hartimin e një relacioni shoqërues të një akti, vlerësimi i ndikimit që projekti mund të ketë tek akte të tjera; përputhshmërinë e projektit me *acquis communautaire*, me standardet ndërkombëtare sipas tregjeve, etj.

Me Vendimin nr. 168, datë 14.08.2019 Bordi i Autoritetit miratoi ndryshimet në Rregulloren nr. 83, datë 29.06.2011 “Mbi marrëdhëniet financiare të punonjësve në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” dhe me Vendimin e Bordit nr.86, datë 26.04.2019 u miratuan ndryshime të cilat konsistuan në përshtatjen e emërtesave sipas strukturës organizative të AMF-së, në disa akte rregullative: Rregullore nr. 14, datë 25.02.2009 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare”, Rregullore nr.129, datë 26.11.2015 “Për marrëdhëniet e punës të punonjësve në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, Rregullore nr.10, datë 25.01.2016 “Mbi funksionimin e bibliotekës së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare”, Rregullore nr.75, datë 30.05.2016 “Për komunikimin me median e publikun, publikimet dhe funksionimin e faqes së internetit”, Udhëzim nr.62, datë 22.05.2008 “Për vlerësimin e arritjeve individuale të punonjësit”.

II.2. Politika e Burimeve Njerëzore

Në funksion të arritjes së objektivave afatmesëm të zhvillimit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, edhe për vitin 2019, politikat e burimeve njerëzore u orientuan drejt rritjes profesionale të punonjësve, qëndrueshmërisë dhe vazhdueshmërisë së kapaciteteve administrative, si dhe përmirësimit të bazës rregullative dhe strukturës organizative të Autoritetit.

Përmirësimet në strukturën organizative të Autoritetit kanë qenë në fokusin e politikave të burimeve njerëzore, me qëllim rritjen e efikasitetit të veprimtarisë së institucionit si dhe përshtatjen më të mirë të strukturave të disa njësive të Autoritetit me detyrat specifike që burojnë nga objektivat e institucionit.


Kështu, në ndryshimet kryesore që u ndërmorën përmendim funksionet e licencimit, të cilat më parë ishin të organizuar sipas tregjeve, ndërsa organizimi i ri, këtë funksion e grupoi dhe e ngriti në nivel drejtorie. Rishikim pati edhe në shpërndarjen e numrit të punonjësve në disa njësi, me qëllim administrimin më efikas të burimeve njerëzore në raport me ngarkesën e punës.

Politikat e punësimit në AMF, reflektuan nevojën për staf me përvojë profesionale të lidhur me fushën, veçanërisht në funksionet e mbikëqyrjes. Kështu, në muajin gusht të vitit 2019, u rishikuan në përgjithësi kriteret e punësimit dhe veçanërisht kriteret për punonjësit në njësitë e mbikëqyrjes me qëllim që përvoja dhe kualifikimi profesional në raport me drejtimin apo profilin e edukimit arsimor, të përbënte avantazh.


Gjatë vitit 2019 u punësuan 10 punonjës të rinj, 7 prej të cilëve në nivel specialistësh dhe 3 në nivel drejtuesish. Avantazh në procesin e përzgjedhjes kanë pasur kandidatët me përvojë profesionale, të diplomuar kryesisht jashtë vendit dhe me note mesatare të preferueshme mbi 8.

Përfaqësimi gjinor në AMF duhet të jetë më i ekuilibruar. Raporti i femrave ndaj meshkujve në totalin e punonjësve është 70% janë femra dhe 30% janë meshkuj, ndërkohë që ky raport përmirësohet në nivelet drejtuese me 9%, ku 61% janë femra dhe 39% janë meshkuj. AMF tregon kujdes në kombinimin e përvojës me elementin e ri. Aktualisht mosha mesatare e stafit në Autoritet është 41 vjeç.


Grafik 31: Struktura e punonjësve sipas profesionit (Në %)



Grafik 32: Struktura e punonjësve sipas funksioneve (Në %)



Grafik 33: Struktura e punonjësve të AMF-së sipas grupmoshës (Në %)



Një tjetër drejtim i rëndësishëm i punës së Autoritetit vazhdon të jetë rritja e qëndrueshmërisë së burimeve njerëzore, duke i konsideruar si një nga asetet më të rëndësishme të institucionit. AMF mbështet dhe nxit zbatimin e procedurave për ofrimin e mundësisë së promovimit për nivelin e shërbimit profesional. Kështu, gjatë vitit 2019, 14 punonjës në pozicionin “specialist” u ngritën në pozicione më të larta pune, duke u bazuar në përvojën e punës me mbi 6 vjet eksperiencë në Autoritet, si dhe rezultate shumë të mira në punë.

Për përjasjen me praktikën më të mira në fushën e burimeve njerëzore, u rishikua rregullorja “Për marrëdhëniet financiare të punonjësve me AMF-në”, për ofrimin e mbështetjes financiare punonjësve kur dalin në pension, të së drejtës për dhënien e lejes me baza ditore nga leja vjetore, apo të rishikimit të shpenzimeve për shërbime brenda dhe jashtë vendit.

Shkalla e qarkullimit të stafit për vitin 2019, rezultoi të jetë 6.6%.

Kualifikimi profesional

Duke vlerësuar rëndësinë e aftësive profesionale të punonjësve në ekzekutimin me cilësi të detyrave të ngarkuara dhe arritjen e objektivave strategjike të Autoritetit, po aq i rëndësishëm vlerësohet përmirësimi i vazhdueshëm i politikave për rritjen e kualifikimeve të tyre profesionale, marrjen e titujve akademikë, si dhe përfitimin e certifikatave profesionale ndërkombëtare.

Në këtë proces, me synim rritjen e ekspertizës profesionale, gjatë vitit 2019, punonjës kryesisht të departamenteve të mbikëqyrjes, kanë kryer testimet “*Asset servicing*” për titullin IOC, dhënien e provimit të nivelit të I, për titullin CFA, apo ACCA.

AMF, në mënyrë sistematike dhe të vazhdueshme, realizon trajnime dhe aktiviteteve të rëndësishme profesionale brenda dhe jashtë vendit ku ruhet linja e specializimeve të punonjësve sipas tregjeve dhe sipas nivelit/shkallës së njohurive (bazike apo të avancuara).

Aktivitetet konsistojnë më shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira profesionale me autoritetet homologe, institucionet financiare, si dhe me shoqatat ndërkombëtare të rregullatorëve. Theksojmë gjithashtu rëndësinë e aktiviteteve në vend, që projektet me institucione të huaja kanë në forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit.

Në kuadër të përgjegjësisë sociale, ndjeshmërisë qytetare dhe në solidarizim me familjet e dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e datës 26 nëntor 2019, ku tërmeti me magnitudë 6.4 të shkallës Rihter goditi Shqipërinë dhe shkaktoi shumë viktima, si dhe dëme materiale tepër të larta duke lënë të pastrehë shumë njerëz, punonjësit e Autoritetit kanë dhënë kontributin e tyre, duke mbështetur financiarisht rindërtimin e njëres prej shtëpive të dëmtuara nga tërmeti, në njësinë administrative të Baldushkut.

II. 3. Sistemet e Teknologjisë së Informacionit

Gjatë vitit 2019, janë kryer zhvillime në infrastrukturën e teknologjisë së informacionit si dhe përmirësime të aplikacioneve ekzistuese. AMF ka aplikuar metodat më bashkëkohore në ndërtimin e sistemeve të informacionit. Për këtë janë analizuar rekomandimet e ndryshme, edhe nga institucionet si FSVK, AKSHI, KLSH dhe Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë dhe janë krijuar grupe pune për adresimin e tyre deri në fazën përfundimtare të plotësimit.

Aktivitetet kryesore të ndodhura gjatë vitit 2019 përfshijnë:

- Mirëmbajtja dhe përmirësimi i infrastrukturës teknike të dhomës së serverave primare në AMF, si dhe infrastrukturë dytësore pranë AKSHI;
- Përgatitja dhe konfigurimi i mëtejshëm i infrastrukturës së brendshme të shërbimeve të AMF-së, si administrimi i email-eve, kompjuterave, serverave, dokumenteve, telefonia qendrore;
- Përditësimi i faqes zyrtare *online* të AMF-së me shërbime të reja për publikun si dhe përmirësimin e rubrikës së transparencës;
- Hartimi dhe zbatimi i politikave të sigurisë së informacionit, duke ruajtur konfidencialitetin, integritetin dhe besueshmërinë e informacioneve të AMF-së;
- Raportimi në kohë reale i policave të minatorëve, si dhe të pasagjerëve në udhëtim;
- Zhvillimi i sistemit për raportim *online* të ID të huaja, si dhe të mjeteve të sapo zhdoganuara;
- Përmirësimi i regjistrat të dëmeve, si dhe integrimin në kohë reale me sistemet e dëmeve pranë shoqërive të sigurimit;
- Krijimi i një sistemi raportimi *online* për tregun e fondeve të pensione dhe të investimeve;
- Krijimi i sistemeve ndihmëse për autoritetin duke u bazuar në burimet e brendshme si, sistemin e inventarizimit, sistemin e pagave apo sistemin më kryesor atë të ankesave nga konsumatorët.

Duke ndarë sistemet e TI-së në grupe kryesore si më poshtë theksohen disa detaje më shumë në lidhje me arritjet e Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit gjatë vitit 2019.

Sistemi i Raportimit *Online*

Sistemi AMF In-Reg është një platformë raportimi web, nëpërmjet të cilës shoqëritë e sigurimit raportojnë të dhënat e kërkuara nga Autoriteti në mënyrë elektronike nëpërmjet internetit. Raportet janë projektuar, ndërtuar dhe zbatuar në përshtatje me aplikacionin *Vizor Builder*.

Sistemi SRF ka për qëllim mundësimin e raportimit nga operatorët e tregut të fondeve të investimeve dhe pensioneve private vullnetare. Aktualisht ka përfunduar ngritja e sistemit, ndërsa po vijon hedhja e raporteve historike me qëllim që gjatë vitit 2020 të realizohet gjenerimi i raporteve inteligjente të detajuara.

Sistemi qendror në dhomën e serverëve

Gjatë vitit 2019 janë përmirësuar kushtet fizike të dhomës së serverave pranë AMF-së, si dhe është rikonceptuar infrastruktura e serverave në AMF, por edhe tek AKSHI pranë infrastrukturës dytësore (*disaster recovery site*). Në përfundim të tij, ky projekt solli përfitime si rritjen e kapaciteteve të *backup*, të përpunimit, rritjen e sigurisë në nivel rrjeti si dhe ambient me parametra të standardeve ndërkombëtare për sa i përket dhomës së serverave.

Regjistri Elektronik *Online* i Sigurimit të detyrueshëm motorik, si dhe të dëmeve

Në korrik 2019 përfundoi zhvillimi dhe raportimi i drejtpërdrejtë i policave të minatorëve, si dhe të sigurimit të pasagjerëve në udhëtim.

Në prill 2019 përfundoi zhvillimi dhe përshtatja e një sistemi të ri raportimi *online* nga operatorët e shoqërive të sigurimit në lidhje me ID të huaja, si dhe me mjetet që nuk figurojnë pranë regjistrit të DPSHTR (si mjete shtetërore të veçanta apo mjete të sapo zhdoganuara). Ky zhvillim mundësoi uljen e kohës së pritjes si dhe ofrimin e një shërbimi cilësor ndaj subjekteve që lidhen me këto raste.

Në tetor 2019 përfundoi zhvillimi i versionit të përmirësuar të regjistrit të raportimit të dëmeve si dhe u kryen zhvillime të mëtejshme për integrimin në kohë reale të këtij sistemi me sistemet e dëmeve pranë shoqërive të sigurimit.


II.4. Auditimi i Brendshëm

Aktiviteti i Njesisë së Auditimit përgjatë vitit 2019, është bazuar në përmbushjen dhe realizimin e objektivave të përcaktuara në Planin Vjetor të miratuar nga Bordi i Autoritetit.

Njësia e Auditimit të Brendshëm ka funksionuar me strukturë të plotë, me një drejtues të njesisë, një auditues të profilit të përgjithshëm financiar, si dhe një auditues të Teknologjisë së Informacionit dhe Vlerësimit të Riskut. Veprimtaria audituese është bazuar në procedurat e auditimit të rregulluara në aktet ligjore në fuqi dhe në standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm.

Me qëllim garantimin e një efikasiteti sa më të lartë, i është kushtuar vëmendje procesit të vlerësimit paraprak të riskut, në përputhje me fushën për auditim. Nga analiza e treguesve më specifikë të auditimit rezulton se ato kanë ndryshuar në vite, të ndikuara si nga numri i auditimeve, ashtu dhe nga specifikat e objekteve apo fushat e audituara. Niveli i riskut për 11 gjetjet e auditimit është klasifikuar me rrezik të mesëm, ndërsa 24 rekomandimet e lëna kanë synim përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, uljen e nivelit të riskut në këto sisteme dhe dhënien e këshillave për zgjedhje që mundësojnë parandalimin e rasteve të shkeljeve në të ardhmen. Gjetjet dhe rekomandimet janë raportuar te Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe te Bordi i Autoritetit.

Grafik 34: Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga Njësia e Auditit të Brendshëm



Në përmbushjen e funksioneve dhe të kompetencave të tij mbi Kontrollin e Brendshëm të Autoritetit, gjatë vitit 2019, Bordi i AMF-së ka miratuar “Planin strategjik për vitet 2020-2022, dhe planin vjetor të auditimit të brendshëm për vitin 2020”.

Plani strategjik dhe vjetor i Auditimit të Brendshëm, si një nga veprimtaritë më të rëndësishme për shërbimin e kontrollit të brendshëm, është ndërtuar për ti siguruar organeve drejtuese të AMF-së se e gjithë veprimtaria dhe operacionet e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare mbulohen me auditim në kuadër të funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm.

III. STRATEGJI DHE OBJEKTIVA TË AUTORITETIT

Gjatë vitit 2020 drejtimet kryesore të veprimtarisë së Autoritetit do të përqendrohen në çështjet e mëposhtme, duke marrë në konsideratë edhe ndikimet e pandemisë COVID-19 në tregjet nën mbikëqyrje:

- Menaxhimi i situatës dhe ruajtja e qendrueshmërisë së tregjeve të mbikëqyrura;
- Mbikëqyrja efektive dhe zhvillimi i mëtejshëm i tregjeve;
- Digjitalizimi dhe modernizimi i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit;
- Plotësimi dhe përmirësimi i kuadrit ligjor dhe rregullator;
- Mbrojtja e personave të siguar dhe investitorëve.

1. Menaxhimi i situatës dhe ruajtja e qendrueshmërisë së tregjeve të mbikëqyrura

Edhe pse në fazën e parë duket se tregjet i rezistuan efekteve të pandemisë, është ende herët për të parashikuar ndikimin e plotë dhe ndërhyrjet që mund të kërkojnë në planin rregullator. Autoriteti mori disa masa për të garantuar mirëfunksionimin e tregjeve dhe mbrojtjen e personave të siguar dhe investitorëve. Një prej tyre ishte pezullimi i shpërndarjes së dividendit për shoqëritë e sigurimit, për të ruajtur kapitalet brenda sistemit.

Autoriteti do të vijojë të monitorojë zhvillimet në tregjet nën mbikëqyrje, ndërsa mbetet i angazhuar për hartimin e protokolleve të qarta për menaxhimin e krizave, me qëllim amortizimin e pasojave të tyre, shoqëruar me fleksibilitetin e vendimmarrjes në situata emergjence. Gjithashtu, AMF synon të përmirësojë planet e vazhdimësisë së biznesit për subjektet nën mbikëqyrje, duke arritur njëkohësisht një përputhshmëri të lartë me standardet ndërkombëtare të sigurimeve dhe të tregjeve të kapitalit.

2. Mbikëqyrja efektive dhe zhvillimi i mëtejshëm i tregjeve

Autoriteti synon të rrisë efektivitetin në mbikëqyrje nëpërmjet përmirësimit të treguesve sasiorë të vlerësimit të rrezikut ndaj të cilave ekspozohet tregu i sigurimeve, me asistencën teknike të Bankës Botërore në kuadër të projektit SECO II. Gjithashtu, synohet përmirësimi i monitorimit të aspekteve të qeverisjes së shoqërive të sigurimit, për t'u siguruar që ato janë në përputhje me standardet më të mira.

Situata e pandemisë nxori në pah nevojën për zhvillimin dhe diversifikimin e tregjeve për të përballuar më mirë goditjet, veçanërisht në tregun e sigurimeve, përmes produkteve të reja, që do të ulnin varësinë e tregut ndaj sigurimit të detyrueshëm TPL. Zhvillimi i tregjeve do të realizohet nëpërmjet forcimit të bashkëveprimit me industrinë dhe ministritë e linjës. Autoriteti është i gatshëm të avancojë nismën për hartimin e një strategjie kombëtare për zhvillimin e tregjeve të kapitalit, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Bankën e Shqipërisë.

Gjatë vitit 2020 synohet ulja e numrit të mjeteve të pasiguruara nëpërmjet bashkërendimit të masave me të gjitha strukturat përgjegjëse me qëllim kufizimin e rritjes së dëmshpërblimi me objekt Fondin e

Kompensimit. Paralelisht, Autoriteti do të vijojë të ketë në vëmendje Fondin e Kompensimit, për të mos lejuar akumulimin e pagesave të prapambetura.

Në funksion të mbikëqyrjes dhe zhvillimit, për të tre tregjet janë përcaktuar drejtimet kryesore të tyre në lidhje me inspektimet, analizat *off-site*, analizat me bazë rreziku dhe bashkëpunimet me institucione të tjera financiare brenda dhe jashtë vendit.

Gjithashtu, në zbatim të rekomandimeve të Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar, lidhur me forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit, do të vijojë trajnimi i stafit teknik, duke iu përshtatur nevojave për rritjen e ekspertizës profesionale të tyre. Për këtë do të shërbejë edhe projekti “Përmirësimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare”, Banka Botërore/SECO II (2019-2022). Projekti ka dy komponentë, njëri me fokus tregjet e kapitalit dhe tjetri tregun e sigurimeve.

3. Digjitalizimi dhe modernizimi i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit

COVID-19 ka bërë të domosdoshme zhvillimet rrënjësore teknologjike dhe digjitalizimin. Në këtë kuadër, Autoriteti synon të hartojë një strategji në funksion të digjitalizimit të proceseve që lidhen me raportimin e informacioneve në AMF si dhe shërbimet që mund t’i ofrohen qytetarëve në distancë (*online*). Për realizimin e këtij objekti do të punohet ngushtësisht me grupe këshillimore, me ekspertë të fushës nga tregjet nën mbikëqyrje dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI).

AMF do të analizojë të reja teknologjike, sigurinë kibernetike si dhe sistemet e dedikuara për autoritetet mbikëqyrëse (*SuppTech*) si dhe për tregun e sigurimeve (*Insurtech*) duke synuar adoptimin e tyre. Fokus kryesor do të jetë në zhvillimin e mëtejshëm të Qendrës së Informacionit për të marrë në kohë reale të dhënat nga tregu i sigurimeve për të gjitha produktet që ofrohen.

Në kuadër të digjitalizimit të shërbimeve do vijohet puna me AKSHI-n për të ofruar disa shërbime nëpërmjet platformës e-Albania. Kjo do të sjellë uljen e kostove dhe heqjen e barrierave për qytetarët, ndërkohë që do të rrisë efikasitetin e Autoritetit.

4. Plotësimi dhe përmirësimi i kuadrit ligjor dhe rregullator

Miratimi i projektligjit “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” pritet të përmirësojë disa aspekte të funksionimit dhe rregullimit të tregut të sigurimeve. Gjithashtu plotëson një nga rekomandimet e Komisionit Evropian në progres-raportin e tre viteve të fundit për Shqipërinë.

Një tjetër objektiv është edhe hartimi i akteve nënligjore lidhur me tre ligjet e reja të miratuara nga Kuvendi i Shqipërisë në maj 2020. Në bashkëpunim me ekspertët e Bankës Botërore, në kuadër të projektit “Përmirësimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare” BB/SECO - II (2019-2022) do të punohet në hartimin e akteve nënligjore që lidhen me ligjin “Për tregjet e kapitalit” dhe “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”.


Krahas hartimit të ligjeve të reja dhe ndryshimit të atyre ekzistuese përgjatë vitit 2020 do të punohet dhe për përafrimin e kuadrit legjislativ me direktivat e BE-së dhe standardeve ndërkombëtare. Ky është një proces, që shtrihet gjatë gjithë vitit 2020 e në vazhdimësi.

5. Mbrojtja e personave të siguruar dhe investitorëve

Autoriteti do të përmbyllë strategjinë “Për rritjen e besimit të konsumatorit/investitorit në tregjet nën mbikëqyrje” (tetor 2017–tetor 2020) duke ndjekur aktivitetet e parashikuara për rritjen e edukimit financiar të publikut dhe ndërgjegjësimin të konsumatorit.

Do të vijohet me pasurimin e faqes zyrtare të Autoritetit me informacione në funksion të transparencës për tregjet nën mbikëqyrje, por edhe për rritjen e njohurive financiare të publikut. Paralelisht me aktivitetet në zbatim të strategjisë për edukimin financiar, Autoriteti do të zhvillojë disa procedura monitorimi për shoqëritë që veprojnë në tregjet nën mbikëqyrje në lidhje me sjelljen e tyre ndaj qytetarëve, dhënien e informacionit kontraktual, garantimin e transparencës, etj.

Shtojca A: Struktura Organizative e AMF-së, 2019



Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve është përgjegjës për mbikëqyrjen efektive të shoqërive të sigurimit/risigurimit, Byrosë Shqiptare të Sigurimit dhe ndërmjetësve në sigurime, nëpërmjet mbikëqyrjes *off-site*, *on-site* dhe shërbimeve aktuariale.

Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve është përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut të titujve, fondeve të pensioneve vullnetare dhe të fondeve të investimeve, në përputhje me kuadrin ligjor.

Departamenti i Çështjeve Juridike është përgjegjës për përputhshmërinë ligjore të veprimtarisë së Autoritetit, nëpërmjet hartimit të akteve ligjore dhe nënligjore të nevojshme, dhënies së opinioneve juridike dhe mbështetjes ligjore për veprimtarinë e tregjeve nën mbikëqyrje, si dhe veprimtarinë e Autoritetit; kryen mbrojtjen ligjore të Autoritetit, përpara organeve gjyqësore dhe koordinon marrëdhënien e bashkëpunimit me institucionet ligj zbatuese; siguron mbrojtjen e konsumatorit/investitorit, duke u kujdesur që veprimtaria e subjekteve nën mbikëqyrje të kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe në mënyrë transparente e në mirëbesim siguron përmbushjen e proceseve integruese, përafrimin e legjislacionit vendas me atë të BE-së, si dhe përafrimin e parimeve dhe standardeve ndërkombëtare.

Shqyrton kërkesat për licencim të shoqërive apo subjekteve që veprojnë në tregjet që mbikëqyr AMF në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe realizon monitorimin e dokumentacionit ligjor të tyre në vazhdimësi.

Departamenti i Zhvillimeve Strategjike dhe Operacioneve është përgjegjës për zhvillimin e metodologjive dhe strategjive në funksion të mbikëqyrjes dhe edukimit financiar, ndjek zbatimin dhe ecurinë e projekteve të Autoritetit, kryen analiza të ecurisë dhe tendencave në zhvillim të tregjeve nën mbikëqyrje; administron Qendrën e Informacionit të Sigurimeve të Detyrueshme, zhvillon platforma të reja raportimi, si dhe harton dhe zbaton politika efektive të menaxhimit të burimeve financiare dhe njerëzore të Autoritetit në funksion të përmirësimit të veprimtarisë së tij.

Shtojca B: Ngjarjet kryesore të vitit 2019, në renditje kohore

Janar	➤ Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare licençoi shoqërinë “Regjistri Shqiptar i Titujve - ALREG” për të vepruar si regjistrar i obligacioneve dhe aksioneve që do të tregtohen në bursë. ➤ U finalizua dhe u vu në funksionim regjistri <i>online</i> i ankesave, i cili bën të mundur depozitimin <i>online</i> të ankesave të konsumatorëve, si dhe ndjekjen nga ankimesi të procesit të trajtimit të ankesës, nëpërmjet pajisjes me një kod unik të ankesës.
Shkurt	➤ Mundësimi i Bursës Shqiptare të Titujve, ALSE , për të tregtuar edhe tituj të tjerë përveç titujve të Qeverisë.
Mars	➤ Përfundimi i projektit SECO në drejtim të: - Projektligjit “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive; - Projektregulloret mbi strukturat <i>Master/Feeder</i>, komunikimit me investitorin, licencimin, pezullimin e shitjes dhe atë të investimeve dhe huamarrjes; - Raporti mbi menaxhimin e krizave; - Projektmanuali i Mbikëqyrjes me Bazë Rreziku.
Prill	➤ Inspektim në vend në BSHS dhe 8 shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës, lidhur me ndjekjen e ecurisë së pagesave të dëmeve, objekt i Fondit të Kompensimit.
Maj	➤ U miratuan ndryshimet e Rregullores nr. 53 datë 25.09.2009, që hyri në fuqi në 1 korrik 2019, duke saktësuar afatet e trajtimit të kërkesës për dëmshpërblim në funksion të mbrojtjes së konsumatorit, për të siguruar një proces të drejtë dhe trajtim në kohë i kërkesës për dëmshpërblim dhe për të shmangur vonesat në trajtim e pagesë janë parashikuar afatet, brenda të cilave duhet të veprojë shoqëria e sigurimit. ➤ U krijua sistemi i raportimit <i>online</i> për tregun e fondeve të pensioneve dhe të Investimeve. ➤ Konferenca II Kombëtare “Edukimi financiar” me fokus kryesor studentët dhe rritjen e informacionit për tregjet nën mbikëqyrjen e AMF-së.
Qershor	➤ Miratohet me Vendimin e Bordit nr. 119, datë 06.06.2019, rregullorja “Mbi administrimin e Fondit të Kompensimit”. ➤ Inspektive tematike në 2 shoqëri të tjera brokerimi në sigurime, me qëllim mbikëqyrjen e veprimtarisë së ndërmjetësimit në sigurime, të cilat kanë filluar aktivitetin e ndërmjetësimit në vitin 2018.
Korrik	➤ U realizua raportimi në kohë reale për policat e sigurimit të minatorëve dhe të pasagjerëve në udhëtim, në zbatimin të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë. ➤ Udhëzim i ri “Mbi raportimin e shitjeve të policave të sigurimit të punonjësve të punësuar në veprimtarinë minerare nga aksidentet në punë”, i miratuar me Vendim Bordi nr. 156, datë 24.07.2019. ➤ Pjesëmarrje në Kolegjin e Tretë Rajonal të Mbikëqyrjes së grupeve të

	sigurimeve, organizuar në Tiranë, me fokus mbikëqyrjen e grupeve të sigurimeve që operojnë në rajon me përfaqësues të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Maqedonisë së Veriut (ISA).
Gusht	➤ Rishikim i strukturës organizative në shërbim të rritjes së rolit mbikëqyrës dhe rregullator. ➤ Inspektive të përbashkëta me Bankën e Shqipërisë në të gjitha bankat tregtare, lidhur me verifikime të transaksioneve financiare të shoqërive të sigurimit. ➤ Inspektim i plotë sipas metodologjisë së mbikëqyrjes me fokus rrezikun, në një shoqëri sigurimi, i cili konsistoi në vlerësimin e situatës financiare, identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve të pranishme në shoqëri sipas aktiviteteve të biznesit, vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe strategjitë apo kontrollet që ndjek shoqëria për zbutjen e këtyre rreziqeve.
Shtator	➤ Aprovimi nga Banka Botërore dhe SECO i Projektit të Ri me AMF “Rritja e Kapaciteteve Mbikëqyrëse të Autoritetit me fokus Tregun e Sigurimeve dhe Tregjet e Kapitalit”. ➤ Licencimi i një shoqërie të re sigurimesh “Albsig Jetë” sh.a. për ushtrimin e veprimtarisë së sigurimit në klasat e Jetës në territorin e Republikës së Shqipërisë, me Vendim Bordi nr.171, datë 13.09.2019. ➤ U përmirësua Regjistri i dëmeve si dhe integrimi në kohë reale me sistemet e dëmeve pranë shoqërive të sigurimit. ➤ U siguria aksesit në kohë reale për ankesat nga konsumatorët, kërkimet e historikut të aksidenteve me numër shasie dhe përmirësimin e rubrikës së transparencës.
Tetor	➤ AMF organizon aktivitete dhe leksione të hapura në javën Globale të Investitorit (30 shtator – 6 tetor).
Nëntor	➤ Organizimi nga AMF për herë të parë në Shqipëri i Forumit Global mbi Pensionet Private në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Pensioneve, (IOPS) dhe Organizatën për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (ECD) me pjesëmarrjen e mbi 100 vendeve anëtare. ➤ Me Vendim Bordi nr. 207, datë 22.11.2019, u miratuan elementet dhe kushtet e përgjithshme të kontratës së sigurimit të detyrueshëm në ndërtim. ➤ Licencimi i një shoqërie të re administruese për fondet e pensionit dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive”. “Albsig Invest sh.a., me vendim bordi nr.210, datë 22.11.2019. ➤ Miratimi krijimit të “Fondit të Pensionit Vullnetar Albsig, me Vendim Bordi nr.210, datë 22.11.2019. ➤ Kryerja e inspektiveve tematike në të gjitha shoqëritë e sigurimit Jo-Jetë, në lidhje me produktin “Garanci Kontrate” me entet shtetërore.

	➤ U sigurua mbështetje nga Banka Botërore për hartimin e projektit teknik të ligjit për përballimin e situatave nga katastrofat natyrore si tërmeti.
Dhjetor	➤ Shoqëria “Regjistri Shqiptar i Titujve - ALREG” u licencua nga BSH dhe Autoriteti për të kryer funksionin e klerimit dhe shlyerjes për titujt e ndryshëm nga ato të Qeverisë që do të tregtohen në Bursë. ➤ Miratimi i krijimit të Fondit të ri të investimit “Albsig Standard”, me Vendimin e Bordit nr.255, datë 30.12.2019. ➤ Inspektive tematike me fokus “Aktivitetin e Risigurimit” në 3 shoqëritë e sigurimit të Jetës. ➤ Inspektim i përbashkët me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare të Austrisë (FMA) pranë shoqërive të grupeve të sigurimit që operojnë në Shqipëri dhe Austri, me objekt “Mbikëqyrjen dhe shkëmbimin e informacionin brenda grupit të sigurimit. ➤ Miratimi i Rregullores se re “Për Regjistrin Elektronik të Dëmeve të Sigurimeve të Detyrueshme Motorike”, nr. 249, datë 24.12.2019. ➤ Përfundimi i Projektit ndërinstitucional “Përmirësimi i cilësisë së raportimit financiar, (EQ-FINREP).